



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Profili i komunave TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS



Botues: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Të gjitha të drejtat për ribotim i përkasin MAPL-së

Dizajni dhe faqosja: studiomorea@gmail.com
Shtypi: Shtypshkronja “Blendi”, Prishtinë

Përmbajtja

Komuna e Deçanit	5-10
Komuna e Gjakovës	11-16
Komuna e Gllogocit	17-22
Komuna e Gjiçanit	23-28
Komuna e Dragashit	29-34
Komuna e Istogut	35-40
Komuna e Kaçanikut	41-46
Komuna e Klinës	47-52
Komuna e Fushë Kosovës	53-58
Komuna e Kamenicës	59-64
Komuna e Mitrovicës Jugore	65-70
Komuna e Leposaviqit	71-74
Komuna e Lipjanit	75-80
Komuna e Novobërdës	81-86
Komuna e Obiliqit	87-92
Komuna e Rahovecit	93-98
Komuna e Pejës	99-104
Komuna e Podujevës	105-110
Komuna e Prishtinës	111-116
Komuna e Prizrenit	117-122
Komuna e Skënderaj	123-128
Komuna e Shtimes	129-134
Komuna e Shtërpçës	135-138
Komuna e Suharekës	139-144
Komuna e Ferizajt	145-150
Komuna e Vitisë	151-156
Komuna e Vushtrrisë	157-162
Komuna e Zubin Potokut	163-166
Komuna e Zveçanit	167-170
Komuna e Malishevës	171-176
Komuna e Junikut	177-182
Komuna e Mamushës	183-188
Komuna e Hanit të Elezit	189-194
Komuna e Graçanicës	195-200
Komuna e Ranillugut	201-206
Komuna e Parteshit	207-210
Komuna e Klllokotit	211-216
Komuna e Mitrovicës Veriore	217-220



Komuna e Deçanit





Komuna e Deçanit



Sheshi "Mentor Tolaj" p.n.
Deçan



<http://kk.rks-gov.net/decan/>



038 200 44 304



Facebook – Komuna e Deçanit

Misioni: Të gjitha organet e komunës kujdesen që qytetarët e komunës t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë pa dallim race, etnie, ngjyre, gjinie, gjuhe, religjioni, mendimi politik apo mendimi tjetër, prejardhjeje kombëtare apo sociale, pa dallim prone, lindje apo ndonjë statusi tjetër, si dhe të kenë drejta dhe mundësi të barabarta në shërbimet komunale të të gjitha niveleve.



Informata të përgjithshme

Dita e komunës

"16 Qershor"
Dita e Çlirimit

Popullsia

41,119

Shqiptarë	39,402
Boshnjak	60
Boshnjak	60
RAE	468
Të tjerë	25

Grupmoshat

GM: 0-18 (19)	14,652
GM: 20-64	22,399

Sipërfaqja

297 km²

Vendbanime	37
Zona Urbane	1

Përshkrimi i komunës

Deçani apo Ulza e dikurshme është vend i banuar që nga kohërat më të lashta. Territori i sotëm i Deçanit ishte i banuar nga fiset Ilire gjegjësisht fisi Dardan. Gjurmët e autoktonisë dhe të pranisë së Dardanëve edhe në trevën e komunës së Deçanit, sikurse edhe në trevat e tjera të Kosovës, janë etnografike, kulturore, historike toponime, topografike, arkeologjike dhe antropologjike. Këtë e dëshmojnë edhe një varg dokumentesh arkivore austriake dhe turke. Edhe sot e kësaj dite, në Komunën e Deçanit në rrethinë ekzistojnë gjurmët e mbi shtatë kishave katolike ilire dhe të përmendoreve tjera siç është Veku i Kaurreshës (Krajlicës), pastaj gjurmët e Tumave ilire, materialet dekorative nga stolitë deri tek stelat, e tjera. Shënimet e para të shkruara në të cilat përmendët Deçani dhe disa fshatra të tij, janë mjaft të vjetëra. Ato përmendën në krisobulën e njohur të Deçanit të vitit 1330.

Profili



Qyteti i Deçanit është qendra e pjesës më perëndimore të Republikës së Kosovës, që gjendet buzë Bjeshkëve/Alpeve Shqiptare, që ngritën mbi lumin e Lumbardhit të Deçanit. Komuna e Deçanit shtrihet në pjesën veriore të Dukagjinit, ku në pjesën veri-perëndimore të Kosovës kufizohet me Pejën, në veri, veri-lindje dhe lindje me Gjakovën, në jug dhe jug-lindje gjendet Shqipëria dhe me Malin e Zi në perëndim dhe veri-perëndim.

Karakteristikat klimatike – Deçani ka klimë kontinentale me ndikim të klimës mediterane. Gjatë vitit në Deçan ka 1.975 orë me diell. Viset e ulëta të Deçanit karakterizohen me temperaturë relativisht të larta me vlerë mesatare vjetore prej 11°C, në muajt më të nxehtë Gushtin dhe Korrikun 21,7°C dhe 21,68°C dhe me muajin më të ftohtë Janarin - 0,5°C. Sasitë e të reshurave në këtë rajon janë ndër më të mëdhatë në Kosovë.

Brenda komunës gjendet manastiri i famshëm mesjetar i Deçanit i themeluar në shekullin XIV. Manastiri luan rol të rëndësishëm për serbët e Kosovës dhe për komunitetin ortodoks të rajonit, si dhe shërben si vend për pelegrinazh. Në vitin 2006, manastiri u fut në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-së.

Planet dhe Strategjitë Komunale:

1. Plani zhvillimor komunal për Deçanin;
2. Plani rregullativ i komunës së Deçanit;
3. Planet urbane komunale;
4. Plani komunal për efikasitet të energjisë 2015-2020;
5. Planin komunal për menaxhimin e emergjencave;
6. Strategjia e zhvillimit ekonomik Lokal;
7. Strategjia komunale për informim dhe komunikim.



Degët kryesore të ekonomisë lokale

Zhvillimi ekonomik i Komunës së Deçanit konsiston në dy shtylla kryesore si bazë e progresit dhe gjenerimit të jetës në këtë trevë, ato janë Turizmi dhe Bujqësia. Gjithashtu ekzistojnë kushte mjaft të volitshme për zhvillimin e biznesit privat dhe atë përmes një organizimi më të mirë të komunitetit afarist.

Ekonomia e komunës është kryesisht bujqësore, por gjithashtu degë të ekonomisë lokale janë edhe: blegtoria, bletaria dhe pylltaria.





INDEKSI I KOMUNËS

**Ndërmarrja regjionale
"Hidrodrini" Pejë**
Udhëheqës: Nazmi Selmanaj
Tel: 044 134 004
nazmi.selmanaj@hotmail.com

**Ndërmarrje publike
komunale për pastrim
"Higjiena"**
Udhëheqës: Sali Kuçi
Tel: 049 766 358
sali.kuci@outlook.com

Zjarrfikësit
Udhëheqës: Besim Selmanaj
Tel: 049 843 300
besimselmanaj@hotmail.com

Stacioni Policor
Udhëheqës: Komandant Sejdi Dobraj
Tel: 044 235 990
sejdi.dobraj@kosovopoliice.com

Policia
Udhëheqës: Fekë Haklaj
Tel: 044 240 441
feke.haklaj@kosovopoliice.com

Emergjencia
Udhëheqës: Deme Mataj
Tel: 049 766 914
E-mail: dem.mataj@rks-gov.net

**Qendra Kryesore e Mjekësisë
Familjare**
Udhëheqës: Haki Shehaj
Tel: 044 178 963
hakisheshaj@hotmail.com

Punësimi

Komuna e Deçanit ka të punësuar gjithsej 132 staf civil (përfshirë sektorin e zjarrfikëseve(12), pylltarëve(14) si dhe 2 të komunitetit boshnjak dhe 1 të nacionalitetit serb). Në administratën komunale të punësuar janë 27 femra, 14 staf politik dhe 146 të punësuar në sektorin publik.

Buxheti

Buxheti vjetor

Të hyrat vetanake

Buxheti i realizuar 2014
Buxheti aktual 2015
Buxheti i Projektuar 2016
Buxheti i Projektuar 2017
Buxheti i Parashikuar 2018

6,793,451.00
7,313,893.00
7,045,933.00
7,115,029.00
7,189,096.00

630,000.00
636,892.00
642,835.00
655,692.00
662,839.00

Struktura organizative

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

Kryetari i Komunës

Nënkryetari

Kontakti: 0390 361 100

0390 361 029

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit

Shërbimi i Kuvendit
044 207 129

Anëtarët e Kuvendit: 27 anëtarë

DREJTORITË KOMUNALE

1. Drejtoria e Administratës
2. Drejtoria për Buxhet dhe Financa
3. Drejtoria për Arsim
4. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
5. Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit
6. Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
7. Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim
8. Drejtoria për Mbrojtje Shpëtim dhe Shërbime Publike
9. Drejtoria për Inspektion
10. Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport
11. Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër

SEKTORËT DHE NJËSITË

Njësia për Komunitete dhe Kthim
Udhëheqës: Shaban Pejçinoviç
Tel: 049 766 983
E-mail: shaban.pejcinoviç@rks-gov.net

Zyra për qasje në dokumente publike
Udhëheqës: Ibish GERVALLA / Shef i Arkivit të Komunës
Tel: 049 766 947
E-mail: Ibish.Gervalla@rks-gov.net

Njësia e Inspektoratit
Udhëheqës: Jashar Hulaj
Tel: 049 766 892
E-mail: jashar.hulaj@rks-gov.net

Zyra për Marrëdhënie me Publikun
Udhëheqës: Yllarta Thaqi
Tel: 049 844 900
E-mail: yllarta.thaqi@gmail.com

Zyra për Barazi Gjinore
Udhëheqës: Zoje Sejfiçaj
Tel: 044 815 721
E-mail: zoje.sejficaj@gmail.com

Zyra për Diasporë
Udhëheqës: Sutki HULAJ
Tel: 049 843 200
E-mail: sutki_hulaj@hotmail.com

Qendra për Punë Sociale
Udhëheqës: Islam Mustafaj
Tel: 049 766 961
E-mail: qps@gmail.com

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
Koordinator: Ismet Kukleci
Tel: 049 766 918
ismet.kukleci@rks-gov.net

Shënime me rëndësi



Arsim

Rrjeti shkollor është i organizuar në shkolla kryesore dhe paralele të ndara fizike. Mësimi mbahet në dy gjuhë: në gjuhën shqipe dhe gjuhën boshnjake në shkollën fillore në Prapaqan. Arsimi në këtë komunë zhvillohet në katër nivele: Arsimi parashkollor, Arsimi fillor, Arsimi i mesëm i ultë dhe Arsimi i mesëm i lartë. Në Komunën e Deçanit ekzistojnë 18 shkolla fillore,

1 në qytet dhe 17 në fshatra, 2 shkolla të mesme dhe 1 çerdhe. Numri i nxënësve në shkolla fillore është 5,158, prej tyre vetëm në shkollën e qytetit vijojnë mësimin 924 nxënës. Ndërsa, numri i mësimdhënësve në shkolla fillore është 359. Në të gjitha shkollat ka edhe paralele të parashkolloreve. Numri i nxënësve në shkollat e mesme është 1,508 nxënës kurse numri i mësimdhënësve është 99.

Kulturë

Deçani veçohet me një trashëgimi kulturore që e karakterizojnë kullat. Ndër kullat më të njohura në këtë pjesë janë:

- Kulla e Osdautëve (fshati Isniq shekulli 19);
- Kulla e Kuklecëve (fshati Isniq shekulli 17-19);
- Mulliri i Tahir Sadrisë (fshati Isniq shekulli 19);
- Mulliri i Shabanajve;
- Mulliri i Demukajve;
- Mulliri i Mushkolajve;
- Mulliri i Binakajve;
- Mulliri i Mazrekajve dhe Manastiri i Deçanit;
- Kompleksi i kullave në fshatin Dranoc;
- Kompleksi i kullave në Glllogjan;
- Kulla në Gramaqel;
- Kulla e Demukajve si dhe
- Kulla e Mushkolajve në Deçan.

Pallati i kulturës në qytet, mundëson zhvillimin optimal për të gjitha krijimtaritë kulturore - artistike.

Në komunë funksionon edhe teatri i qytetit në të cilin zhvillohen aktivitetet kulturore. Janë edhe 2 shoqata kulturo-artistike të cilat veprojnë në komunën e Deçanit: Shoqata Kulturore Artistike "Isuf Gervalla" dhe Trupa e Rapsodëve "Dervish Shaqaj".

Një ndër aktivitetet kryesore kulturore që organizohet në komunën e Deçanit është: Festivali gjithëkombëtar i folklorit "Eshkë e ndezur mbi Shkelzen", festivali i fëmijëve "Arthemëria", turniri në shah "24 Marsi", turniri në futboll të vogël "Luan Haradinaj".

Sporti dhe Rinia

Sportet më të zhvilluara në Deçan janë: futboli, hendbolli, atletika etj. Aktualisht ekipet sportive më të njohura janë:

- Klubi Hendbollistik për femra "Deçani" liga II-të e Kosovës,
- Klubi Hendbollistik për meshkuj "Deçani" liga I-rë e Kosovës,
- K.F. "Deçani" liga e II-të,
- K.V. për femra "Deçani" liga II-të.
- Gjithashtu Klubi i Atletikës "Deçani" liga e I-rë,
- K.F. "Besa" Irzniq liga e III-të,
- Klubi i Kick Boxit "Shkelzen Haradinaj" Deçan,
- Klubi i shahut "Zeq Hasaj" liga e I-rë superiore,
- Shoqata e gjahtarëve "Agim Selmanaj".

Në Deçan kemi shoqërinë Bjeshkatore Alpiniste "Shkëlzen Haradinaj" që përfaqëson Deçanin në sportin e Bjeshkatarisë-Alpinizmit. Gjithashtu, janë edhe klubet nëpër shkolla që janë zakonisht ekipet e shkollës të cilat i selekcionojnë arsimtarët e kulturës fizike nëpër shkollat e tyre, aty formohen klube në të gjitha disiplinat sportive, si në: Hendboll, Volejbol, Futboll, Basketboll, Pingpong, Atletikë, etj. Këto ekipe janë të gjinisë femërore dhe mashkullore dhe marrin pjesë në gara në mes shkollave qofshin gara komunale apo me karakter më të gjerë.

Prona Komunale

Në komunën e Deçanit numri i parcelave komunale është 716, sipërfaqja tokësore e parcelave komunale është 32.78.907 Ha.



Shëndetësia

Në Komunën e Deçanit shërbimi publik primar shëndetësor ofrohet në Qendrën Komonale të Mjekësisë Familjare (QKMF), në 3 qendra të mjekësisë (QMF), si dhe në 6 ambulanca (punte shëndetësore). QKMF gjendet në qendër të qytetit. Ndërsa, QMF-të janë të shpërndara nëpër fshatra (Isniq, Strellc i Epërm dhe Irzniq). Po ashtu, njësitë shëndetësore janë të shpërndara në fshatrat e kësaj ane dhe gjenden në fshatrat Prejlep, Gramaqel, Ratish, Praraqan, Lumbardh dhe Pobërgj. Shërbimi shëndetësor sekondar (rastet e infarktut, urgjencat, operacionet) ofrohet në Spitalin e Pejës.

Turizmi

Deçani i ka përparësitë e veta për zhvillimin e turizmit të mirëfillt duke u bazuar në shtrirjen gjeografike dhe elementet tjera që i posedon nga natyra, me vendet e përshtatshme për zhvillim të turizmit veror dhe atij dimëror, si dhe duke shfrytëzuar klimën e mirë, ajrin dhe ujin e pastër. Objektet turistike në komunën e Deçanit janë: Maja e Gjeravicës (Maja më e larta në Kosovë) Kompleksi memorial "Dëshmorët e Kombit" në Glogjan, Bjeshkët e Nemuna, posaçërisht bjeshka e Belegut ku mund të



vizitohet poligoni për skijim, Kompleksi i hoteleve Iliria, Pushimorja e fëmijëve, Pishat e Deçanit, Kampi (Garibaldi), Manastiri i Deçanit i cili është nën përkujdesjen e UNESCO-së, Mullinjtë dhe Kullat.



Transporti

Autostradat, %-ja e rrugëve të asfaltuara, Hekurudhat, Stacionet Kryesore, Aeroportet, etj. Deçani gjendet pothuajse në qendër të Ballkanit me distancë të theksuara të pikave të rëndësishme të transportit. Deçani ka lidhje me qytetin e Gjakovës me gjatësi 15km, si dhe me qytetin e Pejës me gjatësi 14km. Me komunën e Junikut lidhet përmes



rrugës së Vokshit me gjatësi 10km dhe përmes rrugës Deçan-Gjakovë nëpërmes

Rastavices prej 12km. Aeroporti i Prishtinës gjendet 90km larg Deçanit. Është aeroporti i vetëm në afërsi i cili ofron të gjitha shërbimet për pasagjerë dhe transportit të mallit. Në komunën e Deçanit rreth 75–80% e transportit kryhet me automjete private. Deçani gjendet në mes të dy qendrave kryesore Pejë dhe Gjakovë, andaj rrugët ndërlidhëse dhe hekurudhat janë mundësi e mirë që zhvillojnë lëvizjen e shpejtë të qytetarëve dhe mallrave.



Komuna e Gjakovës





Komuna e Gjakovës



Rr. "Nëna Terezë" nr. 469.
50000 Gjakovë



<http://kk.rks-gov.net/gjakove>



0390/321-100



Komuna.Gjakove@rks-gov.net



Misioni i Komunës së Gjakovës është të krijoj qeverisje lokale efikase të qëndrueshme dhe demokratike përmes përpjekjeve të përbashkëta të institucioneve komunale.



Informata të përgjithshme

Dita e komunës
14 Qershori -
Dita e Çlirimit

Popullsia

88,499

Shqiptarë	87,672
Boshnjak	73
RAE	6468
Të tjerë	209

Grupmoshat

GM: 0-19	35,753
GM: 18-65	51,744

Sipërfaqja

586 km²

Vendbanime	88
Zona Urbane	1

Përshkrimi i komunës

Për herë të parë në mesjetë, Gjakova përmendet si fshat, vend pazari më 1485. Më 1594/1595 Sylejman Hadim Aga ndërtoi Xhaminë e Hadumit, shkollën, bibliotekën, hanin, hamamin dhe muvakit hanën, objekt për matjen e kohës dhe për caktimin e kalendarit me ndihmën e kuadrateve astrolabikë, që ishin bërthama rreth së cilës u ndërtua Çarshia e Madhe.

Emërtimi Jakovë figuron në të gjitha burimet deri më 1912, pas pushtimit serb, kur ia lëshoi përfundimisht vendin emrit Gjakovë për shqiptarët dhe Gjakovica për serbët. Qyteti u shndërrua shumë shpejt në qendër të rëndësishme zejtare, tregtare, arsimore, politike dhe kulturore, e cila lidhej me Shkodrën, Kosovën, Sanxhakun dhe me vende të tjera të Ballkanit dhe të Evropës falë pozitës gjeografike, rëndësisë strategjike dhe banorëve shumë të zhdërvjellët e arsimdashës.

Profil



Shtrihet në pjesën jug-lindore të Rrafshit të Dukagjinit, në pjesën jug-perëndimore të Kosovës. Është pjesë përbërëse e regjionit qendror të Gadishullit Ballkanik dhe pjesës jug-lindore të Evropës. Shtrihet në një sipërfaqe prej 586km² dhe në lartësi mbidetare prej 365m. Ka tokën pjellore, fushat, malet si dhe bjeshkët e larta që e rrethojnë në jug-perëndim. Është e pasur me lumenjtë si "Ereniku", "Krena", "Llukaci", "Drini i Bardhë" dhe ca lumenj të vegjël por të rëndësishëm.

Komuna e Gjakovës kufizohet me Republikën e Shqipërisë me të cilën ka dy pika kufitare, atë të Qafës së Prushit në jug ku lidhet me Regjionin e Hasit (Letaj, Krum, Kukës, etj.) dhe atë të Qafës së Morinës në perëndim që lidhë Malësinë e Gjakovës (Tropojë, Bajram Curr, etj.). Komuna e Gjakovës kufizohet edhe me Komunat si: Prizrenin, Rahovecin, Malishevën, Klinën, Pejë dhe Deçanin.

Zona të veçanta në komunë janë:

- Zona e Qendrës së Vjetër në qytetin e Gjakovës (Çarshia e Vjetër)
- Zona Piktorese - Ana e Drinit në Komunën e Gjakovës
- Zona e Ansamblit të Kullave Shqiptare në Nivokaz dhe Skivjan.

Planet dhe Strategjitë Komunale:

1. Plani për emergjencë
2. Planin Zhvillimor Komunal
3. Plane Rregulluese Urbane
4. Planin e veprimit lokal në mjedis
5. Plani për menaxhimin e mbeturinave
6. Planin lokal për barazi gjinore



Degët kryesore të ekonomisë lokale

Gjakova gjithmonë ka pasur të zhvilluar ekonominë dhe mund të thuhet se gjithnjë ka qenë qytet me karakter ekonomik. Është e njohur për traditë pune në industri dhe bujqësi si dhe për punonjës të zellshëm në zëjtari, tregti dhe shërbime. Ka një strukturë të re të popullsisë dhe me vullnet të spikatur e të përkushtuar në punë. Të gjitha këto përfaqësojnë potencial të madh për të ardhmen.

Bizneset e vogla dhe mikro ndërmarrjet sot dominojnë në ekonominë e Gjakovës. Biznesi privat është në ekspansion dhe treguesit e cilësojnë si strukturën kryesore përbërëse të ekonomisë së Gjakovës. Gjakova ka potencial, traditë prodhuese dhe menaxhuese në këto sektor: industria metalike, industria e tekstilit, industria kimike, industria ushqimore, industria e materialit ndërtimorë, industria e drurit, industria teknologjisë informative, turizmit kulturor dhe agroturizmit.

Gjakova është rajon strategjik dhe gjeografik që lidh rajone dhe qytete, posedon kapacitete njerëzore të aftësuar profesionalisht, dhe si zonë e lirë ekonomike ofron edhe mundësi dhe kapacitete infrastrukturore për të zhvilluar një qendër të fuqishme prodhuese dhe biznesore.



Prona Komunale

Komuna e Gjakovës ka **374.85.50** ha sipërfaqe të pronës komunale.



Punësimi

Në vitin 2014 për 12 muaj ka pasur 4,667 të punësuar, shkalla e punësimit është 5.6 %. Sektori publik me 1776, ndërsa sektori privat me 2891.

Zyra për informim

Tel: 0390 321 312

Zyra komunale për komunitete dhe kthim

Tel: 0390/321-100;

Zyra përgjegjëse për qasje në dokumentet zyrtare

Buxheti

Buxheti vjetor

Të hyrat vetanake

Buxheti i realizuar 2014	18,629,039.5	3,045,000.00
Buxheti aktual 2015	20,268,994.00	3,026,311.00
Buxheti i Projektuar 2016	19,895,982.00	3,030,300.00
Buxheti i Projektuar 2017	20,036,697.00	3,035,911.00
Buxheti i Parashikuar 2018	20,202,051.00	3,040,500.00

Struktura organizative

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

Kryetari i Komunës

Kontakti: Tel: 0390/330-183

Nënkryetari

Kontakti: Tel: 0390/322 - 104

DREJTORITË KOMUNALE

1. Drejtoria për Administratë
2. Drejtoria e Arsimit
3. Drejtoria e Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
4. Drejtoria për Punë Inspektuese
5. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale
6. Drejtoria për Buxhet dhe Financa
7. Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
8. Drejtoria e kulturës Rinisë dhe sportit
9. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim
10. Drejtoria për Shërbime Publike

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit

Tel: 0390-327-259

Shërbimi i Kuvendit

Tel: 0390-325-32

Anëtarët e Kuvendit: 27 anëtarë

INDEKSI I KOMUNËS

Kompania Rajonale e Mbeturinave Çabrat Sh.A, Gjakovë

Ujësjiellësi rajonal "Radoniq"

Tel: 0390/320-503

Brigada e Zjarrfikësve

Tel:93

Ndërmarrja publike banesore

Tel:0390/322-452

Mjekësia Familjare 1

Tel:0390/324-234

Ngrohtorja e Qytetit Gjakova Sh.A, Gjakovë

Spitali Rajonal "ISA Grezda"

Tel: 0390/321-144 - Centrala

0390/322-445 – Emergjencia

Enti i Mjekësisë Urgjente

Tel: 94

"Radio Gjakova"

Email: Plotësohet nga komuna

Tel:0390/322-383

PTK-informata

Tel: 988

Enti i Mjekësisë Urgjente

Tel: 94

Punësimi

Në vitin 2014 për 12 muaj ka pasur 4,667 të punësuar, shkalla e punësimit është 5.6%.
Në sektori publik 1,776 punëtorë, ndërsa sektori privat me 2,891 punëtorë.

Shënime me rëndësi

Arsim

Komuna e Gjakovës prej vitit 2013 është qytet universitar, ku studiohet në disa degë. Sot në Komunën e Gjakovës, po ashtu ekzistojnë një numër i madh i shkollave fillore dhe të mesme, si në sektorin publik, po ashtu edhe në atë privat.

Rrjeti shkollor është i organizuar në shkolla kryesore dhe paralele të ndara fizike. Numri i institucioneve sipas niveleve dhe formës së organizimit është si vijon: Numri i institucioneve parashkollore në komunën e Gjakovës është 1 konvikt me kopsht të fëmijëve



me paralele të ndara në fshatra në katër pika, shkolla fillore dhe të mesme të ulëta 41 dhe të mesme të larta 4.

Institucione e arsimit

Parafillor	- 1 institucion i ndarë në 4 paralele në fshatra
Shkolla të mesme të ulëta	41
Shkolla të mesme të larta	4

Shëndetësia

Instituti i Mjekësisë së punës ofron shërbime të nivelit terciar për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe ka punësuar 15 specialist, dhe ka kabinete të pulmologjisë, kardiologjisë, gjinekologjisë, neurologjisë dhe diagnostikues. Në Gjakovë funksionon qendra për Shëndet Mental dhe Shtëpia Mbrojtëse për rastet psikiatrike, e po ashtu edhe dega e Institutit Kombëtarë për Shëndet Publik si autoritet që ka

përgjegjësinë e analizës dhe monitorimit të situatës higjenik-epidemiologjike të qytetit. Kemi dy nivele të tjera të shërbimit shëndetësorë si: Spitali Rajonal "Isa Grezda", me 59 specialist, 312 infermiere dhe 486 shtretër, me shërbime shëndetësore nga fusha e kirurgjisë, gjinekologjisë, urologjisë, mjekësisë interne, ortopedisë, oftamologjisë, ORL, infektives, pulmologjisë, pediatriisë, neuropsikiatriisë. Qendra e Mjekësisë Familjare ka punësuar: 28 specialistë të mjekësisë familjare, 5 specialist, 8 mjek të praktikës së përgjithshme, 14 infermier, 4 teknik të farmacisë, 8 laborante, 10 specialist të stomatologjisë, 33 stomatolog, 21 teknik të dhëmbëve dhe 39 asistente.

Institucionet shëndetësore

Qendra Kryesore e Mjeksisë Familjare	1
Qendra të Mjeksisë Familjare	12
Ambulanca të Mjeksisë Familjare	14



Transporti

Trafiku vjen nga katër drejtime kryesore për në Gjakovë: Prishtina, Peja, Prizreni dhe Tropoja në Shqipëri. Rruga më e afërt nga Peja, Deçani dhe porti i luginës së Krenës për në Tropojë është përmes rrugës R109. Të gjitha trafiqet tjera ndërmjet këtyre relacioneve duhet të kalojnë përmes qytetit të Gjakovës. Një rrugë anësore jashtë qytetit, orienton trafikun ndërmjet Tropojës dhe Prishtinës / Prizrenit. Trafiku ndërmjet Prizrenit dhe Pejës kalon përmes qytetit të Gjakovës. Ekziston një linjë kryesore hekurudhore që kalon nga Peja për në Prishtinë. Një pjesë e linjës kalon nga Klina për në Prizren. Komuna e Gjakovës ka aeroportin të rregulluar me infrastrukturë përkatëse në të cilin për momentin nuk mbahen linja të rregullta të fluturimit, ky aeroport është i lokalizuar në veri 7 km larg zonës urbane, ndërsa lidhet përmes rrugës së asfaltuar me rrugën Magjistrale M 9.1.

...

Sporti dhe Rinia

Për nga struktura e aktiviteteve dhe resurset njerëzore që janë aktive, sporti gjakovar dallohet me: klube sportive ku janë gjithsej 34 në të cilat 29 janë meshkuj, 5 të femrave, shoqata sportive janë 5; trajnerë 29 prej tyre 28 meshkuj, dhe 1 femër, referë sportivë 49, 1 stadium të futbollit, pallati i sporteve me sipërfaqe 5.373 m², 6 salla të mbyllura me sipërfaqe prej 1509 m² (0.12 m² për nxënëse), 3 salla të mbyllura me sipërfaqe prej 512 m² (0.04 m² për nxënëse).

Aktivitetet sportive zhvillohen në Pallatin e Sporteve "Shani Nushi", i cili është i hapur çdo ditë nga ora 08:00 deri në 24:00. Pallati i sporteve është ndërtuar dhe hapur në vitin 1979, kur është mbajtur Botërori Femëror i juniorëve në Hendboll. Është objekt sportiv i tipit të mbyllur në qytet të cilin e shfrytëzojnë afro 30 klube sportive në të dy konkurrencat. Objekti ka një kapacitet prej afro 5.373 m², me 1800 ulëse, sallën kryesore ku zhvillohen trajnimet dhe ndeshjet sportive si në hendboll, basketboll, voleyboll, futboll të vogël, karate, boks, bodibilding, pingpong, etj.



Turizmi

Peizazhi atraktiv, malet, lumenjtë dhe kodrinat së bashku me trashëgimin e ruajtur kulturore mund t'i tërheqin turistët. Një parakusht për zhvillimin e bujqësisë dhe turizmit është edhe periferia me infrastrukturë të zhvilluar. Në komunën e Gjakovës veprojnë edhe shumë objekte hoteliere dhe restorante të cilat ofrojnë shërbime të fjetjes, ushqimit dhe rekreacionit individual e familjar. Në qendër të qytetit është hoteli "PASHTRIKU", me kapacitete për fjetje, ushqim me salla përmbledhje dhe konferenca. Po ashtu edhe objektet tjera hoteliere që janë të sektorit privat. Ndër më të njohurit janë: "Jakova", "Europa", "Amsterdam", Oita 3, President, Çarshia e Jupave, Niki – s, Metropol etj.

Kultura

Qyteti i Gjakovës është i njohur si qendër kulturore, jo vetëm në suazat komunale por edhe si regionale e besa edhe gjithë kombëtare. Bartës kryesorë të kulturës së qytetit të Gjakovës janë: Muzeu, Arkivi, Instituti për mbrojtjen e monumenteve, Biblioteka, Pallati i kulturës dhe Teatri Kombëtar i Gjakovës. Objektet e trashëgimisë kulturore në komunë janë: Tërësia urbanistike* Çarshia e Madhe, Lapidari i Lidhjes së Prizrenit, Varri i Maxharr Pashës, Xhamia e Hadumit (Mejtepi, Biblioteka, Varrezat, Shatërvani), Kulla e "Avdullah Pashë Drenit" Muzeu Etnografik, Kulla e Hysni Koshit, Kulla e Sylejman Vokshit etj. Ura e Tabakëve, Ura e Taliqit, Ura e Terzive, Kompleksi i Sukës së Çërmjanit, Teqja e Sheh Danjollit, Teqja e Sheh Eminit, Shtëpia e Selim Bakijës, Xhamia e Hasan Agës (Rugovë), Xhamia e Fshatit Smolicë, Mbeturinat e objektit në vendin e quajtur "Kisha katolike" (shek.II-IV) etj.





Komuna e Glogovcit





Komuna e Glogocit



Rr. "Fehmi dhe
Xhevë Lladrovi", Glogoc.



<http://kk.rks-gov.net/glogoc>



038 584 074;
038 584 353



xheme.binaku@ks-gov.net



Misioni: Komuna e Drenasit përmes aplikimit të një qeverisje gjithëpërfshirëse, të përgjegjshme dhe transparente si dhe koncentrimit të vlerave të larta të qytetarisë dhe demokracisë ka për qëllim të ofroj një ambient të përshtatshëm për realizimin e projekteve dhe programeve zhvillimore për Sektorin Privat kryesisht nëpërmjet promovimit të potencialeve zhvillimore ekonomike dhe investimeve vendore dhe të huaja, ku fokus kryesor është ngritja e punësimit dhe përmirësimi i mirëqenies së qytetarëve.



Informata të përgjithshme

Dita e komunës

14 Qershori
Dita e Çlirimit

Popullsia

58,531

Shqiptarë
Boshnjak
Të tjerë

58,445
14
34

Grupmoshat

GM: 0-18 (19)
GM: 20-64

23,181
32,054

Sipërfaqja

276 km²

Vendbanime
Zona Urbane

42
4

Përshkrimi i komunës

Komuna është themeluar para Luftës së Dytë Botërore si njësi social, politike dhe administrative. Gjatë tetëdhjetë vjetëve të fundit zhvillimi ekonomik ka qenë tepër i ulët, sepse pushtetet e kaluar antipopullore të dirigjuara nga qendra ndoqën një politikë specifike diskriminuese sidomos ekonomike. Përkundër kësaj kjo komunë ka hedhur disa hapa drejt transformimit gradualisht (ndonëse të ngadalshëm) të strukturave të saj ekonomike, bujqësore, arsimore, shëndetësore dhe industriale.

Profili



Komuna e Drenasit shtrihet në Qendër të Kosovës, me një pozitë shumë të mirë gjeografike, gjë që i mundëson asaj të jetë më afër çdo qendre të madhe industriale dhe tregtare që operon në qytetet e tjera të Kosovës, si Prishtinë, Pejë, Mitrovicë, Prizren etj. Nëpër territorin e Komunës kalon Hekurudha Fushë Kosovë – Pejë – Prizren, Autostrada Vërmicë-Merdare si dhe Rruga Regjionale Caralevë – Bushat – Drenas - Skenderaj. Rrugët ndërlidhëse dhe hekurudhat janë mundësi e mirë për lëvizjen e shpejtë të qytetarëve dhe mallrave. Aeroporti ndërkombëtar "Adem Jashari", gjendet 17km larg Drenasit. Kjo afërsi i mundëson bizneseve të kësaj komune të ofrojnë shërbime për pasagjerë, si dhe transport të mallrave. Komuna e Drenasit kufizohet me këto komuna: në jug-lindje kufizohet me terrenin e komunës së Lipjanit, në lindje me territorin e komunës së Fushë Kosovës dhe Obiliqit, në veri-lindje me territorin e komunës së Vushtrrisë, në veri me komunën e Skenderajt, në Perëndim me territorin e komunës së Klinës dhe në jug-perëndim me komunën e Malishevës.

Planet dhe Strategjitë Komunale:

- Plan i zhvillimor komunal
- Plan i rregullativ i komunës
- Planet urbane komunale
- Strategjia e Zhvillimit Ekonomik - Lokal
- Plan i Komunal për Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (PKVMSA)
- Plan i Veprimit për Transparencë në Komunën e Drenasit
- Plan i Lokal i Veprimit për Riintegrim në Komunën e Drenasit



Degët kryesore të ekonomisë lokale

Gjithë ekonomia e Drenasit, kryesisht, bazohet në bujqësi dhe industri. Në këtë komunë bujqësia është e zhvilluar në masë të madhe që përkrahet nga 0,60 hektarë tokës bujqësore dhe 0,49 hektarë të tokës së punueshme për një qytetar



Prona komunale

Komuna e Drenasit ka në pronësi të saj komunale 1870.97.57 Ha tokë në total.

Komuna ka shpallur Zonat Industriale për investorët eventual në këto zona: Korroticë e Epërme, Komoran, Gllobar në një sipërfaqe të përgjithshme prej 23.67.76 Ha.



Punësimi

Numri i të punësuarve në komunën e Drenasit gjithsejtë është 6,618, ku në sektorin publik të punësuar janë 1,335 punëtorë, ndërsa në sektorin privat 5,283 punëtorë.

Buxheti

Buxheti vjetor

Të hyrat vetanake

Buxheti i realizuar 2014	10,982,419.0	
Buxheti aktual 2015	12,050,000.0	1,200,874.0
Buxheti i Projektuar 2016	12,710,648.0	1,500,000.0
Buxheti i Projektuar 2017	12,810,106.0	1,520,000.0
Buxheti i Parashikuar 2018	12,974,654.0	1,590,000.0

SEKTORËT DHE NJËSITË

Sektori Emergjencave

Udhëheqës: Ragip Nishori

Tel: 049 744 793

Zyra për Marrëdhënie me Publikun

Udhëheqës: Rinore Zymeri

Tel: 044 411 413

Njësia për Komunitete dhe Kthim

Udhëheqës: Afije Veseli

Tel: 044 896 460

Zyra Komunale për Integrime Evropiane

Udhëheqës i zyrës: Ibrahim Hajdari

Tel: 044 175 597

E-mail: ibrahim.hajdari@rks-gov.net

Zyra për Barazi Gjinore

Udhëheqës: Zahrije Podrimqaku - Subashi

Tel: 044 193 439

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

Kordinatorë: Rinore Zymeri
Kontakt: 044 411 413

E-mail: rinore.zymeri@rks-gov.net

Struktura organizative

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

Kryetari i Komunës

Nënkryetari

DREJTORITË KOMUNALE

1. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
2. Drejtoria për Buxhet dhe Financa
3. Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë
4. Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit
5. Drejtoria për Arsimit

6. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
7. Drejtoria e Inspektimit Komunal
8. Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë
9. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
10. Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Ekonomik

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit

Shërbimi i Kuvendit

Anëtarët e Kuvendit: 31 anëtarë



INDEKSI I KOMUNËS

Shërbimi i Zjarrfikësve

Shef i shërbimit: Afrim Gjeli
Tel: 049 744 792

Ndërmarrja Publike e Ujit

Drejtör: Ismet Baliu
Tel: 044 170 647

Stacioni policor

Drejtör: Driton Morina
Tel: 045 701 702

Ndërmarrja Publike e Mbeturinave

Drejtör: Muhamet Qela
Tel: 044 170 648

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

Drejtoreshë: Xhevahire Sejdiu
Tel: 044 291 110

Shënime me rëndësi



Arsim

Organizimi i arsimit në Drenas realizohet në tri nivele: Edukimi parashkollor, arsimi fillor dhe i mesëm i ulët, si dhe i mesëm i lartë. Arsimi parashkollor organizohet në paralele parashkollore (fëmijët e moshës 5-6 vjeç) në kuadër të objekteve të shkollave fillore, me qëllim të përgatitjes së fëmijëve për fillimin e shkollës fillore.

Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët paraqet arsimin e obliguar 9-vjeçar dhe përfshinë nivelet 1: shkolla fillore (klasat 1-5) dhe nivelin 2: shkolla e mesme e ulët (klasat 6-9) duke i përfshirë grup-moshat 6 deri në 15 vjeç. Arsimi i mesëm i lartë paraqet arsimin e obliguar 4-vjeçar dhe përfshinë shkollat e mesme nga 10-13 për grup moshat 15-18.

Sporti dhe Rinia

Në komunën e Drenasit janë të themeluar shumë klube sportive si: Klubi i Basketbollit, Futbollit, Shahut, Pingpongut, Futbollit, Karates, Hendbollit, Shenjëtarisë, Boksit, Volejbollit (femra).

...

Shëndetësia

Në komunën e Drenasit ekziston një Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare, e cila përkujdeset për banorët e kësaj komune. Kjo qendër ka të punësuar rreth 186 punëtor. Në përbërjen e kësaj qendre funksionojnë: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) e cila ofron shërbime shëndetësore 24 orë.

Kulturë

Drenasi njihet për aktivitetet të ndryshme kulturore-artistike, që organizohen nga të rinjtë dhe të reja të kësaj komune. Kulturën e Drenasit e përfaqësojnë dhe fuqizojnë fuqishëm: Shoqëria Kulturore Artistike „Shotë Galica“ Drenas, Revista e Folklorit Burimor Shqiptar (RFBK) që mbahet çdo katër vite, Revista Komunale e Recitatorëve, etj.





Turizmi

Pikat referuese për vizitë turistike:
Vargmalet e Drenicës, Bjeshkët e
Qyqavicës, Kalaja e Verbovcit, Liqeni i
Vasilevës, Lumenjtë Drenica dhe Verbica,
Gryka e "Gurit të Plakës" etj.



Transporti

Kjo komunë, në pikëpamje të
ndërlidhjes tokësore lidhet më
pjesët tjera të Kosovës më anë të
hekurudhës Fushë Kosovë-Pejë
dhe rrugës magjistrale Prishtinë-
Bushat(Komoran)-Pejë dhe rrugët
ndër komunale Shalë-Lipjan dhe
Bushat-Drenas-Skenderaj. Të
asfaltuar janë gjithsejtë 68.29km,
prej të cilave prej tyre rrugë
magjistrale dhe regjionale që

kalojnë nëpër këtë komunë janë
35km. Ndërsa, pjesa tjetër e
rrugëve janë rrugë lokale që janë
të asfaltuara viteve të fundit. Të
planifikuar për asfaltim janë edhe
30km rrugë. Transporti publik i
përfshinë të gjitha vendbanimet
komunale, ndërsa autotransporti si
pikë kryesore ka Stacionin e
Autobusëve në Drenas. Autostrada
përfshinë rreth 20km nëpër
territorin e Komunës, Hekurudha
po ashtu rreth 20 hektar dhe janë
5 stacione hekurudhore.





Komuna e Gjilanit





Komuna e Gjilanit



Rruga "Bulevardi i Pavarësisë"
p.n, Gjilan



<http://kk.rks-gov.net/gjilan>



0800 11 555



<http://kk.rks-gov.net/gjilan>



Misioni i komunës të Gjilanit, është që të kujdeset që të gjithë qytetarët t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë, pa dallim race, etnie, ngjyre, gjinie, gjuhe, religjioni, mendimi politik, apo mendimi tjetër, pavarësisht prejardhjes kombëtare apo sociaie, pa dallim prone, lindje apo ndonjë statusi tjetër



Informata të përgjithshme

Dita e komunës

15 Qershori
Dita e Çlirimit

Popullsia

90,178

Shqiptarë	87,814
Turq	978
Serb	624
RAE	377
Të tjerë	320

Grupmoshat

GM: 0-18 (19)	33,288
GM: 18-65	50,336

Sipërfaqja

385 km²

Vendbanime	49
Zona Urbane	1

Përshkrimi i komunës

Në shekullin XVII Evlia Çelebija e përmend Gjilanin, por me emrin Moravë, si kadillëk në kuadër të Sanxhakut të Vushtrrisë. Gjilani gjendet në pjesën lindore të Kosovës dhe është njëra nga shtatë komunat e mëdha të Kosovës. Pas luftës është edhe qendër e rajonit. Sipas disa të dhënave, Gjilani si vendbanim është formuar rreth vitit 1750, ndërsa si qendër urbane - në vitin 1772. Gjilani si qytet është zhvilluar krahas shuarjes së Novobërdës (Artanës), e cila në mesjetë ka qenë njëri nga qytetet dhe qendrat më të mëdha tregtare, ekonomike dhe xehtare në Ballkan. Dihet mirëfilli se Gjilani është krijuar nga familja shqiptare, si themelues i Gjilanit njihet Bahti Beg Gjinolli.

Profili



Komuna e Gjilanit gjendet në pjesën juglindore të Kosovës, rajoni i Anamoravës. Është njëra nga komunat e mëdha të vendit. Pozita gjeografike që ka, i mundëson asaj lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit. Rrethi i qytetit të Gjilanit shtrihet në bregoret Kodra e Dëshmorëve (Popovica), Gllama, Dheu i Bardhë, fusha e Malishevës, Zabeli i Sahit Agës dhe Bregu i Thatë. Nëpër qytet kalojnë tre lumenj të vegjël, Mirusha, Banja dhe Stanishori, të cilët bashkohen dhe derdhen në Moravë, në perëndim të fshatit Uglar. Gjilani kufizohet, në juglindje me Preshevën (33 km) dhe Kumanovën (53), ndërsa në lindje – me Bujanocin (40 km). Gjilani ka klimë të mesme kontinentale. Rrethinën e Gjilanit e përcakton lumi Morava e Binçës, i cili mbledhë gjithë lumenjtë e vegjël, me një prurje mesatare mujore prej 6.7 metra kub /sekondë/. Në juglindje rrethohet nga malet e Karadakut. Koordinatat e shtrirjes së qytetit të Gjilanit janë 42 shkallë në veri dhe 21.20 shkallë në lindje dhe në një lartësi mbidetare qyteti prej 501 dhe 590 m ndërsa regjioni prej 475 m në Budrikë deri në 1000 m lartësi mbidetare në zonën kufitare me Maqedoninë (Stanqiq).

Planet dhe Strategjitë Komunale:

1. Plani Rregullues Urban për tri zona të qytetit
2. Plani Rregullues Urban "Qendra (Zona 1)" - Gjilan;
3. Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2005 - 2007;

Degët kryesore të ekonomisë lokale

Në komunën e Gjilanit, industria ka qenë një faktorë i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik. Industria ka qenë e përfaqësuar nga shumë degë të prodhimit, si industria e përpunimit të çelikut, industria përpunuese e duhanit, prodhimi i radiatorëve të çeliktë, prodhimi baterive industriale, ndërtimtaria etj. Komuna e Gjilanit, njihet si komunë agro-industriale dhe është e përshtatëshme për bujqësi, pylltari, përpunim të lehtë industrial, ndërtimtari dhe industri të shërbimeve.





Prona Komunale

Komuna e Gjilanit posedon 17.638.004 m² pronë komunale, 24.230 hektarë është tokë bujqësore. Kjo komunë shtrihet në 40 zona kadastrale, ndërsa dhënia e pronës komunale në shfrytëzim për nevoja të investitorëve, është simbolike.

Punësimi

Komuna e Gjilanit, ka rreth 15 mijë të punësuar në të dy sektorët. Mbi 3 mijë punëtorë janë të sektorit publik (administratë, shëndetësi, arsim), ndërsa të tjerët në sektorin privat. Në periudhën janar-tetor 2015 janë punësuar 1229 persona (68 në sektorin publik, 1161 në sektorin privat).

INDEKSI I KOMUNËS

Stacioni Autobusave

Tel: 0280/ 324 307

Email: avnos@hotmail.com

Shërbimi i Zjarrëfikësve

Tel: 0280/320 999

Kompania Rajonale e Ujësjellësit Hidromorava sh.A, Gjilan

Tel: 0280 / 325 658

Email: <http://www.hidromorava.com>

Kompania Rajonale e Mbeturinave "Ecohigjiena" (PPP) Gjilan

Tel: 0280/ 320 040

Email: krm_higjiena@yahoo.com
contact@krm-higjiena.com

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

Tel: 0280/ 323 006

Buxheti

Buxheti vjetor

Të hyrat vetanake

Buxheti i realizuar 2014	20,125,842	3,780,000
Buxheti aktual 2015	21,839,767	3,859,953
Buxheti i Projektuar 2016	21,354,701	4,000,000
Buxheti i Projektuar 2017	21,578,222	4,100,000
Buxheti i Parashikuar 2018	21,825,203	4,200,000

Struktura organizative

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

Kryetari i Komunës

Kontakti: Tel: 0390/330-183

Nënkryetari

DREJTORITË KOMUNALE

1. Drejtoria për Administratë
2. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
3. Drejtoria për Buxhet dhe Financa
4. Drejtoria për Shërbime Publike
5. Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë
6. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik
7. Drejtoria e Arsimit
8. Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
9. Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë
10. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim

SEKTORËT DHE NJËSITË

Njësia për Kulturë, Rini e Sport

Tel: 0280/321 725

Njësia e Kuvendit

Tel: 044/177 146

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

Tel: 030/200/47004

Zyra për Preshehtë, Bujanoc e Medvegjë

Tel: 044/176 807

Njësia për Personel

Tel: 0280/321 902

Zyra për Informim

Tel: 030-200-47002 (0280/321 486)

Zyra Ligjore

Tel: 044 308 077

Njësia për të Drejtat e Njeriut

Tel: 044 161 694

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit

Tel: 038 200 470 14

Shërbimi i Kuvendit

Anëtarët e Kuvendit: 35 anëtarë



Shënime me rëndësi

Arsim



Sistemi shkollor në komunë e Gjilanit është i ndarë në: Arsimi parafillor i cili zhvillohet në dy çerdhe, kurse arsimi fillor zhvillohet në 29 shkolla fillore, prej të cilave 25 janë të organizuara në gjuhën shqipe, 2 në gjuhën serbe dhe 2 në atë turke. Numri i nxënësve në

Institucione e arsimit

Parafillor	4
Shkolla të mesme të ulëta	29
Shkolla të mesme të larta	10

shkollat fillore është 18,559 me 1,023 mësues; 1,873 nxënës ndjekin mësimin në gjuhët e minoriteteve (në gjuhën serbe dhe turke) me 188 mësues. Sa i përket arsimit special, Gjilani nuk ka shkollë speciale për nxënësit me nevoja speciale, por shkollat fillore "Rexhep Elmazi", "Abaz Ajeti" dhe "Thimi Mitko" kanë klasë speciale me nxënës të hendikepuar dhe të sëmurë mentalisht.



Transporti

Në Gjilan të gjitha rrugët kryesore që lidhin fshatrat e mëdha me qendrën urbane janë të asfaltuara



Turizmi

Në komunën e Gjilanit ekzistojnë kushte të mira për turizëm malor, por tani për tani nuk është bërë diçka në këtë drejtim. Sidoqoftë pritjet që në të ardhmen të punohet me shumë në këtë drejtim dhe kështu komuna e Gjilanit të këtë një turizëm më të zhvilluar.



Shëndetësia

Në komunën e Gjilanit kryhen shërbimet primare dhe sekondare mjekësore. Komuna e Gjilanit ka një spital regional me 17 reparte. Në komunën e Gjilanit ekzistojnë

gjithsej 33 ente shëndetësore të gjitha këto janë në kuadër të kujdesit primar shëndetësor. Numri i punëtorëve shëndetësor është 320. Po ashtu në këtë komunë ekzistojnë edhe 2 qendra për trajtime mentale: Qendra për Shërim dhe Qendra për Rehabilitim Mental.





Sporti dhe Rinia

Sportet më të zhvilluara në Gjiçan janë: futboli, hendbolli, basketbolli, voljebolli, karateja, boks. Aktualisht janë të regjistruara dhe zhvillojnë aktivitet këto klube: KF Gjiçani, KF Drita, KF Bashkimi, KV Drita (M), KV Drita (F), KH Drita (M), KH Drita (F), KB Drita (M), KB Drita (F), KK Drita, KK Dardania, KT Drita, KP Drita (M), KP Drita (F), KB Drita, K.Kik. Box. Drita, KJ Drita, KK Gjiçani, Kfutsall. Bresalci, Kfutsall Përlepница, KH Zhegra, KA Gjiçani, KN Drita, KS Gjiçani, KSH Drita, KB në Karroca. Të gjitha këto ekipe, aktivitetin sportiv e zhvillojnë në palestrën "Bashkim Selishta - Petriti" dhe në stadiumin e qytetit.



Kultura

Gjiçani është i pasur me objekte të ndryshme kulturore e fetare. Objektet më të rëndësishme kulturore në Komunën e Gjiçanit janë: Teatri, Biblioteka e Qytetit, Galeria e Arteve, Kinemaja, si dhe tri Shtëpi të Kulturës në fshatrat Prelepnice, Zheger dhe Llashtice. Sa i përket objekteve fetare, në komunën e Gjiçanit janë 31 xhami, 9 kisha ortodokse, një kishë katolike si dhe një teqe. Gjiçani është i njohur për kulturën dhe tolerancën e vet ndëretnike e ndërfaqetare.





Komuna e Dragashit





Komuna e Dragashit



Rr. "Deshmorët e Kombit"



<http://kk.rks-gov.net/dragash/Home.aspx>



029 /281- 543



avni.nebiu@rks-gov.net



Misioni: Krijimi i një zone me bujqësi efkase, turizëm të zhvilluar, mjedis të pastër duke u bazuar në shfrytëzimin e drejtë të resurseve natyrore dhe tradicionale. Të gjitha grupet e shoqërisë të jetojnë së bashku në kushte më të mira të jetesës.



Informata të përgjithshme

Dita e komunës

"15 Qershor"
Dita e Çlirimit

Popullsia

33,997

Shqiptarë	20,287
Goran	8,957
Boshnjak	4,100
RAE	10
Të tjerë	621

Grupmoshat

GM: 0-18 (19)	11,705
GM: 20-64	19,153

Sipërfaqja

430 km²

Vendbanime	36
Zona Urbane	1

Përshkrimi i komunës

Historiku i komunës së Dragashit, daton nga periudha e lashtë. Në këtë trevë historikisht jetoi popullata iliro-dardane, duke u pushtuar gradualisht nga Perandoria Romake, pastaj nën Perandorinë Bizantine e më vonë edhe nga perandoria Turke-Osmane e cila me monumente historiko-fetare la gjurmët e konfesionit islam të dy trevave - Opojës shqiptare dhe Gores me të folmen e saj karakteristike.

Në strukturat e pushtetit lokal janë të inkuorporuar, bashkërisht e reciprokisht, përfaqësuesit e zgjedhur nga të dy trevat - Opoja dhe Gora, që do të thotë se kjo popullatë është e lidhur historikisht në mes veti dhe se tani është prezentë liria e lëvizjes dhe marrëdhëniet e mira ndër fqinjësore në mes pjesës dërmuese të popullatës së këtushme.

Profili



Komuna e Dragashit përfshinë skajin jugor të rrafshit të Dukagjinit. Në veri kufizohet me komunën e Prizrenit, në pjesën jug-lindore dhe lindore përmes majave të larta të maleve të Sharrit kufizohet me Maqedoninë. Ndërsa nga perëndimi dhe jug-perëndimi me Shqipërinë. Territori i komunës së Dragashit shtrihet në një sipërfaqe prej 430km² dhe zë afro 4% të territorit të Kosovës. Komuna e Dragashit ka reliev kodrinore-malor dhe në pjesët kufitare me Shqipërinë dhe Maqedoninë e ndajnë kurora të larta malore. Ndërsa në drejtim të Shqipërisë gryka të thella lumore, të pa përshtatshme për kalim. Në anën tjetër pjesa kodrinore me rrënjë më të butë, në drejtim të Prizrenit ofron kushte më të mira dhe ky territor lidhet përmes Prizrenit me Kosovën dhe më gjerë. Karakteristikat klimatike - Klima prezente në komunën e Dragashit është klimë malore-kontinentale e ashpër, ku stina e dimrit është mjaftë e gjatë ndërsa ajo e verës e shkurtër. Klimë subalpine me temperaturë mesatare vjetore prej 8.6°C. Vera të shkurta dhe të freskëta me temperaturë mesatare prej 18.1°C, me dimra të gjatë dhe relativisht të ftohtë (temperaturë mesatare -0.4°C). Një pjesë e konsiderueshme e Komunës së Dragashit (24,206.52 Ha) është shpallur pjesë e Parkut Nacional Sharri. Zona të mbrojtura në komunën e Dragashit janë: Namaz gjahu, Mullinjtë dhe Tyrbet.

Planet dhe Strategjitë Komunale:

Plani zhvillimor komunal



Degët kryesore të ekonomisë lokale

Zhvillimi ekonomik i Komunës së Deçanit konsiston në dy shtylla kryesore si bazë e progresit dhe gjenerimit të jetës në këtë trevë, ato janë Turizmi dhe Bujqësia. Gjithashtu ekzistojnë kushte mjaft të volitshme për zhvillimin e biznesit privat dhe atë përmes një organizimi më të mirë të komunitetit afarist.

Ekonomia e komunës është kryesisht bujqësore, por gjithashtu degë të ekonomisë lokale janë edhe: blegtoria, bletaria dhe pylltaria.

Punësimi

Vlerësohet se janë të punësuar rreth 3,500 punëtor. Prej tyre 870 shërbyes civil dhe në ndërmarrje publike, ndërsa pjesa tjetër në sektorin privat, ku pjesa më e madhe e këtij sektori është në ndërmarrje shërbyese (tregti, hotelieri dhe shërbime tjera). Sa i përket prodhimit në industrinë e tekstilit janë të punësuar 320 punëtor.



INDEKSI I KOMUNËS

Shërbimi i Zjarrfikësve
Udhëheqës: Fari Piraj
E-mail: fari.piraj@rks-gov.net

"Njësia Punuese Dragash" e kompanisë "Hidroregjioni Jugor"
Udhëheqës: Qakidgji Tershajaku

"Njësia Punuese Dragash" e "Eko Kompanisë"
Udhëheqës: Sali Shala

Prona Komunale

NSa i përket pronës komunale, komuna disponon 13.84.216 ha. Nga kjo sipërfaqe 36 ha janë ndarë për çështje biznesore me Vendim të Kuvendit Komunal.

SEKTORËT DHE NJËSITË

Zyra e informacionit
Udhëheqës: Avni Nebiu
Tel: 029/281005
E-mail: avni.nebiu@rks-gov.net

Zyra për Kthim
 Vezaip Kajkush – Zyrtar Komunal për kthim
E-mail: vkajkus@yahoo.com

Zyra për Komunitete
Drejtor: Mehmet Hamza
Tel: 029/281-729
E-mail: mehmed.hamza@ks-gov.net

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
Koordinator: Azbi Halili
E-mail: azbi.halili@rks-gov.net

Buxheti

Buxheti i realizuar 2014
 Buxheti aktual 2015
 Buxheti i Projektuar 2016
 Buxheti i Projektuar 2017
 Buxheti i Parashikuar 2018

Buxheti vjetor

6,452,646.00
 7,164,026.00
 6,896,598.00
 6,971,286.00
 7,057,311.00

Të hyrat vetanake

441,000.00
 487,030.00
 400,000.00
 415,000.00
 430,000.00

Struktura organizative

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

Kryetari i Komunës

Kontakti: 029/ 281-543

Nënkryetari

Nënkryetari për komunitete

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit

Shërbimi i Kuvendit

Anëtarët e Kuvendit: 27 anëtarë

DREJTORITË KOMUNALE

1. Drejtoria e Administratës
2. Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik
3. Drejtoria e Arsimit
4. Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike
5. Drejtoria e Bujqësisë, Inspeksion, Turizëm dhe

- Zhvillimi Rural
6. Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Ambientit
7. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
8. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Shëndetësia

Në komunën e Dragashit gjendet një Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare, po ashtu janë 5 Qendra të Mjekësisë Familjare dhe 8 Ambulanca. Dragashi ka 14 mjeke (të gjithë meshkuj), 31 infermiere, 5 mami, 1 pediatër, 1 gjinekolog, 1 radiolog, 5 dentiste, 4 teknik dhembesh dhe 6 teknik laborator, 4 farmacist dhe popullsi prej 33,997 banorësh. Pra, në përputhje me politiken shëndetësore të Kosovës, Dragashi plotëson standardet e kujdesit shëndetësor.



Sporti dhe Rinia

Klubet dhe asociacionet sportive në komunë përfshijnë:

- Klubin e futbollit "Pllava" në Pllavë,
- Klubin e futbollit "Liqeni" në Breznë,
- Klubin e futbollit "Opoja" nga një pjesë e Opojës,
- Asociacionin e ecjes "Guri i Zi" në Dragash,

- Klubi i Skijimit "Arxhena",
 - Klubi i skijimit "Sharri",
 - Klubi i mundjes "Sharri", Shkolla e futbollit nga Gllloboçicë për talent të rinj.
- Komuna e Dragashit është shumë e përshtatshme për zhvillimin e sportit dimëror. Ajo mbështetë projekte të vogla të garave sportive sikurse: turnirët në futboll të vogël, garat e pehlivanëve, vrapimi i kuajve, etj.

Shënime me rëndësi



Arsim

Numri i institucioneve shkollore në komunën e Dragashit është: 21 shkolla parashkollor, 35 fillore të mesme të ulëta dhe 1 shkollë e mesme e lartë.

Disa fshatra kanë dy sisteme arsimore: sistem kosovar dhe sistemi paralel të mbështetur nga

Serbia. Të gjitha shkollat kanë nevojë për investime për përmirësimin e infrastrukturës dhe për materiale arsimore si: libra, video-projektorë, harta dhe pajisje tjera për shkollë në veçanti për kabinete të biologjisë, muzikës, fizikës, shkencave shoqërore dhe informatikës.

Transporti

Qyteti i Dragashit është shënuar si një qendër e vogël me zonë ekonomike, e lidhur me atë të Prizrenit. Rrjetet rrugore dhe hekurudhore janë: aksi Prizren-Durrës që është pjesë e një korridorit të rëndësishëm ndërkombëtar të trafikut Serbi-Kosovë-Shqipëri, që i lidhë Merdaren, Prishtinën, Prizrenin dhe Durrësin. Dragashi lidhet me aksin dhe me Prizrenin përmes rrugës regjionale Dragash-Zhur. Komuna e Dragashit është e lidhur me pjesën tjetër të Kosovës përmes dy rrugëve: njëra është e asfaltuar, e cila është e lidhur drejtpërsëdrejti me autostradën e re ndërmjet Shqipërisë dhe Prishtinës, fillon në Zhur dhe futet afër fshatit Brezne/Brezna dhe një rrugë tjetër e paasfaltuar që futet afër fshatit Zaplluxhe. Një rrugë e vetme e pashtuar nga Restelicë shpie tek kufiri në jug dhe e ndërlidhë Dragashin me rajonin Gorna Reka në IRJ të Maqedonisë tek kalimi malor në



Lukovo Pole (1500). Sa i përket asfaltimit të rrugëve në mbarë territorin e komunës llogaritet të janë të asfaltuara afro 120km rrugë, reciprokisht, në të dy trevat – Opojë dhe Gores, ku janë përfunduar lidhjet e të gjitha fshatrave me rrugë rajonale, kurse ka nevojë asfaltimi edhe afro 70km rrugë te reja, në të ardhmen.



Kulturë

Dragashi është i pasur me trashëgimi kulturore. Traditat dhe vlerat kulturore janë të thella në shoqëri dhe manifestohen në mënyra të ndryshme. Disa shembuj janë si: dita e Shën Gjergjit (festë pagane), kremtimet e fejesave dhe martesave. Këto ngjarje janë të rëndësishme në jetën e Dragashit dhe gjatë festave të tilla bartën veshje unike tradicionale të kësaj pjese të vendit. Dragashi gjithashtu ka tradita të pasura me muzikë, folklor, gara sportive (kuaj, mundje), këngë, lojëra, vallëzim dhe ushqim, për të përmendur vetëm disa aspekte të jetës, ku trashëgimia kulturore shfaqet në vetvete. Institucionet kryesore kulturore ndodhen në qytetin e Dragashit dhe përfshijnë: shtëpinë e kulturës dhe bibliotekën, shtëpi të kulturës gjithashtu ka edhe në Brran dhe Bellobrat, njëherit biblioteka më të vogla ka në Bresanë, Brezne, Bellobrat, Brod dhe Krusheve. Janë edhe disa shoqëri kulturore-artistike në disa fshatra. Kultura tradicionale e Dragashit manifestohet gjithashtu edhe me një numër të artizanaleve kryesisht në qepje dhe qëndisje të veshjeve tradicionale dhe dekorime të ndryshme për shtëpi.



Turizmi

Pjesa më e madhe e territorit të Dragashit është pjesë e Parkut Nacional Sharri. Sharri për nga numri liqejeve, pas Bullgarisë (malit Rilla) zë vendin e dytë në Evropë (edhe pse Opoja ka një dhe Gora ka dy liqeje). Bjeshkët e këtushme në tërësi mund të kenë epitelin e parkut nacional dhe mund të janë atraktive për turistët dimëror dhe veror, sidomos pjesët në fshatrat: Restelicë, Brod, Radeshë, Zaplluxhe, Liqeni Breznes, Shpella e Zgatarit, Namazgjahu, HC. Dikancë, etj. Tri shtyllat e turizmit në Dragash janë: Bukuria natyrore (malet, biodiversiteti), Kultura dhe trashëgimia (kultura Opojane dhe Gorane, mënyra e jetës tradicionale), Mikpritja dhe kuzhina e pasur (ushqimi i prodhuar aty, mikpritja fshatare).





Komuna e Istogut





Komuna e Istogut



Rr. Fadil Ferati "nr.121



<http://kk.rks-gov.net>



038/ 200 43 814;
038/200 43 881



Komuna.Istog@rks-gov.net



Misioni: *Institucione funksionale, me staf profesional që respekton parimet e ndershmërisë, vetëdijes dhe përgjegjësisë, ofron shërbime cilësore për qytetarët në pajtim me standardet më të larta të qeverisjes së mirë të bazuara në parimet e transparencës dhe kulturës demokratike.*



Informata të përgjithshme

Dita e komunës

20 Qershori
Dita e Çlirimit

Popullsia

39,289

Shqiptarë	36,154
Boshnjak	1,142
RAE	1,694
Të tjerë	268

Grupmoshat

GM: 0-18 (19)	14,960
GM: 20-64	21,353

Sipërfaqja

454 km²

Vendbanime	90
Zona Urbane	1

Përshkrimi i komunës

Në territorin e komunës së Istogut janë gjetur gjurmë vendbanimesh që datojnë edhe nga parahistoria. Të dhënat tregojnë se Istogu si vendbanim në vendin e sotëm, është formuar në shekullin e mesëm.

Gjatë kohës së sundimit të Turqisë, kazaja (komuna) e Istogut i ka takuar Sanxhakut të Pejës e pos tij edhe kazatë e Gjakovës, Beranës (Ivangradi) dhe Gucisë. Më 29 dhjetor të vitit 1978, Istogu shpallet qytet me sipërfaqe të caktuar. Bashkësia lokale si tërësi territoriale administrative, formohet nga disa vendbanime apo njësi kadastrale. Komuna e Istogut aktualisht udhëhiqet nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

Profili



Komuna e Istogut ka pozitë të mirë gjeografike dhe ka një lidhje të mirë me qendrat e mëdha tregtare. Shtrihet në pjesën veriore të rrafshit të Dukagjinit, në veri perëndim kufizohet me Malin e Zi dhe Serbinë, në verilindje me komunën e Zubin Potokut, në lindje me komunën e Skenderajt, në jug me komunën e Klinës dhe në jugperëndim me komunën e Pejës.

Territori i Komunës së Istogut karakterizohet me klimë kontinentale të butë, në të cilën ndikim të madh ka afërsia e kurorës malore të Bjeshkës së Moknës nga pjesa veriore, e që ka ndikim të madh në ndryshimin e shpeshtë të temperaturës gjatë ditës. Është karakteristike se në territorin e Komunës fryn një nga erërat më të forta të veriut në Ballkan.

Objektet e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të veçantë është: Manastiri i Gorioqit, ndërsa zona të mbrojtura janë Burimi i Istogut, Burimi i Vrellës dhe Uji Termal – Banjë.

Planet dhe Strategjitë Komunale:

1. Strategjinë për identifikimin e Objekteve të Trashëgimisë kulturore.
2. Strategjia anti- korrupsion
3. Plani zhvillimor komunal
4. Plani zhvillimor urban
5. Plani i veprimt në mjedis
6. Plani për menaxhimin e mbeturinave
7. Planin komunal për emergjencë



Degët kryesore të ekonomisë lokale

Segmentet ekonomike më të zhvilluara në Komunën e Istogut janë bujqësia dhe blegtoria. Në zhvillimin ekonomik komunal, rol dominant ka qyteti i Istogut, sepse shumica e kapaciteteve ekonomike janë të koncentruara në këtë qendër.

Rol të rëndësishëm kanë edhe Banja me kapacitetet e veta turistike, pastaj Gjurakoci dhe Vrella. Ndërsa, lokalitetet tjera janë të shpërndara në fshatrat tjera.





INDEKSI I KOMUNËS

Brigada e Zjarrfikësve

Komandanti: Sadik Kovaqeviq
Tel: (039) 451 055
E-mail: szhs1999@gmail.com

Ndërmarrja e Pastrimit Ambienti

Drejtor: Xhevat Ferataj
Tel: 044223963
E-mail: ambienti_istog@hotmail.com

Ndërmarrjen Publike Hidrodrini

Drejtor: Naim Ferataj
Tel: 049445222
E-mail: n.ferati@hotmail.com

Stacioni Policor në Istog

Komandanti: Enver Gashi
Tel: (039) 451 374
E-mail: foks3baza@kosovopolic.net

Buxheti

Buxheti vjetor

Të hyrat vetanake

Buxheti i realizuar 2014	7,789,708.00	945,000.00
Buxheti aktual 2015	8,578,024.00	1,014,149.00
Buxheti i Projektuar 2016	8,644,622.00	1,020,000.00
Buxheti i Projektuar 2017	8,706,967.00	1,023,000.00
Buxheti i Parashikuar 2018	8,779,233.00	1,024,651.00

Struktura organizative

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

Kryetari i Komunës

Kontakti: 039 / 451 220

Nënkryetari

DREJTORITË KOMUNALE

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit
Tel: 038 / 200 43 813

Shërbimi i Kuvendit
Tel: 45-850

Anëtarët e Kuvendit: 27 anëtarë

SEKTORËT DHE NJËSITË

Zyra për Informim Publik

Udhëheqëse: Jeta Balaj
Tel: (038)20043881
E-mail: jeta.balaj@rks-gov.net

Zyra e Inspeksionit

Udhëheqës: Xhavit Blakaj
Tel: (038)20043832
E-mail: xhavit.blakaj@rks-gov.net

Zyra e Personelit

Udhëheqës: Fatmir Bytyçi
Tel: (038)20043824
E-mail: fatmir.bytyqi@rks-gov.net

Zyra komunale për komunitet dhe kthim

Udhëheqës: Rasim Mahmutovic
Tel: (038)20043811
E-mail: rasim0805@hotmail.com

Zyra Ligjore

Udhëheqëse: Zekije Sutaj
Tel: (038)20043821
E-mail: zekije.sutaj@rks-gov.net

Këshilli Komunal për siguri në Bashkësi

Koordinator: Skender Hasangjekaj
Tel: (038)20043903
E-mail: skender.hasangjekaj@rks-gov.net



1. Drejtoria e Administratës
2. Drejtoria e Buxhetit dhe Financave
3. Drejtoria për Arsim dhe Kulturë
4. Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje Të Mjedisit
5. Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim
6. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
7. Drejtoria Për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi
8. Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim

Shënime me rëndësi



Arsim

Arsimi është i organizuar në tri nivele: Parashkollor i cili zhvillohet në objektet e shkollave fillore, fillor (klasa 1-5) dhe i mesëm i ulët (klasa 6-9), Arsimi jo i obliguar i mesëm i lartë, i cili zhvillohet në objektet e shkollave të mesme dhe gjimnaz (klasa 10-13). Në komunë gjenden 5 institucione parashkolllore publike (çerdhe dhe kopshte). Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët është i organizuar në 13 shkolla fillore amë dhe 15 paralele të ndara. Prej tyre, 2 shkolla janë serbe, 1 është shkollë mikse (shqipe -boshnjake) dhe 10 shkolla shqipe, ndërsa paralelet e ndara janë 1 mikse dhe 14 shqipe.



Sporti dhe Rinia

Në qytetin e Istogut është një fushë e sportit me tribuna (përballë stacionit të autobusëve), si dhe një fushë e mbuluar, afër shkollës fillore. Në pjesën lindore të qytetit, në afërsi me varrezat e reja është pishina, e cila është prone private. Meqenëse është e hapur, ajo shfrytëzohet

vetëm në sezonin e verës. Në tërë qytetin është e vetmja pishinë.

Prona Komunale

Komuna e Ika 1540 parcela (pronë komunale), në sipërfaqe prej 56,819,776 m².

Punësimi

Numri i të punësuarve në sektorin publik është 163.

...

Kultura

Objektet e kulturës (objektet e rinisë apo qendrat e komunitetit) ndodhen në 7 vendbanime: në Istog, Vrellë, Banjë, Gjurakoc, Cerrcë, Rakosh dhe Bellopojë. Janë gjithsej 9 Institucione kulturore si: Shtëpia e Kulturës, 6 Qendra rinore dhe 2 biblioteka. Atraksione natyrore që vlen për t'u vizituar janë: burimi i Istogut, burimi i Vrellës, burimi i ujit termomineral në Banjë, Bjeshkët e Istogut etj.

...

Shëndetësia

Shërbimet shëndetësore janë të shpërndara në gjithë territorin duke respektuar dendësinë e banimit, me qëllim të ofrimit të mundësisë së njëjtë të qasjes në shërbimin primar shëndetësor. Shërbimi publik shëndetësor në komunën e Istogut është i organizuar në tri nivele: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) e cila gjendet në Istog (1), Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) në Banjë, Vrellë, Rakosh, Gjurakoc (4), dhe Ambulancat në Kaliçan, Dobrushë, Saradran, Veriq, Cërkolez, Osojan, Zallq, Shushicë, Dubravë (9). Në komunë gjenden gjithsej 14 objekte në të cilat ofrohen shërbime shëndetësore.

...

Transporti

Rrugë të asfaltuara në komunë janë 130km, rreth 75% të territorit janë rrugë të asfaltuara.



Turizmi

Istogu ka një ambient të pastër ekologjik, male të larta, ujëra të pijshëm, ujëra të nxehta minerale dhe klimë të këndshme që e bëjnë Istogun si destinacion të përshtatshëm për turist. Janë disa atraksione natyrore të cilat janë bazë e mirë për zhvillimin dhe avancimin e turizmit në komunën tonë. Rajonet më të njohura të këtij masivi në territorin e Istogut janë: Mokna, Bjeshka e Thatë, Gurrat e Bardha, Lugu i Butë, Koreniku, Corrovoda, Bajshet, Jerebia, Radusha, etj. Pika të rëndësishme për ti vizituar janë: Qendra termale në Banjë, bjeshkët mbi Kaliqan, Studenicë, Vrellë dhe Lubozhdë si dhe Mokna, territor me vlera natyrore dhe estetike siç janë: peizazhi natyror, relievi, përbërja gjeologjike, klimatike dhe karakteristikat hidrografike, si dhe flora dhe fauna që paraqesin potencial për zhvillimin e turizmit. Territorin e Moknës e karakterizojnë liqenet malore glaciale (ku jeton kërmilli i maleve), burimet e shumta të ujit natyral (më i

njohuri është ai që njihet si "kroni i shenjtë", në rrjedhën e të cilit jeton trofta e përroit), stanet e verës, flora dhe fauna e pasur, frutat e malit dhe bimët mjekuese, kullosat, kushtet e mira

për gjueti, shpella e Gollostënës, Maja e Madhe, etj. Kanë lartësi mbidetare mbi 1,300m, ndërsa disa maje ngritën edhe mbi 1,800m.





Komuna e Kaçanikut





Komuna e Kaçanikut



Rr. "Qamil Ilazi" p.n. 71000



<http://kk.rks-gov.net/kacanik/Home.aspx>



0290/ 380-005
0290/ 380-047



<http://kk.rks-gov.net/kacanik/Municipality/Kontakto->



Informata të përgjithshme

Dita e komunës

11 Qershori
Dita e Çlirimit

Popullsia

33,409

Shqiptarë 33,362
Boshnjak 20
Romë 5
Të tjerë 12

Grupmoshat

GM: 0-18 (19) 12,995
GM: 20-64 18,514

Sipërfaqja 21 km²

Vendbanime 31
Zona Urbane 1

Përshkrimi i komunës

Kaçaniku si qendër administrative – qytezë daton që nga fundi i shekullit XVI, i cili deri në vitin 1891 ishte nahije e Sanxhakut të Shkupit, në Vilajetin e Kosovës. Themelues i parë i kësaj qyteze është Koxha Sinan Pasha i cili ndërtoi xhaminë e cila edhe sot ekziston, një kuzhinë publike (imaret) , një shkollë në afërsi të xhamisë, dy hane, një hamam, kalanë dhe disa mullinj në lumin Lepec.

Deri në vitin 2007 Komuna e Kaçanikut përshinte nën administrimin e saj edhe territorin e Komunës së sotme të Hanit Elezit, e cila fitoj statusin e Komunës në procesin e decentralizimit. Që nga viti 2000 deri në zgjedhjen e fundit lokale 2013, me Komunën e Kaçanikut udhëheq Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

Profili



Komuna e Kaçanikut përfshinë pjesën jug-lindore të Kosovës me sipërfaqe prej 1,94% të sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës. Komuna e Kaçanikut kufizohet me komunat e Vitisë, Ferizajt, Shtërpçës dhe në jug me Hani Elezit dhe IRJ të Maqedonisë. Kaçaniku dallohet me kushte të volitshme topografike dhe klimatike. Përmes grykës së Kaçanikut depërton klima mesdhetare; nga lindja dhe perëndimi depërton klima tipike malore, ndërsa nga ana veriore ndihet ndikimi i klimës kontinentale. Nëpër Kaçanik kalojnë dy lumenj, lumi Lepenc dhe Nerodime, nga buzët e të cilëve ngrihen malet e Sharrit dhe Rodopet. Nëpër Kaçanik kalojnë magjistratja Prishtinë-Shkup dhe hekurudha Fushë Kosovë-Selanik, e ndërtuar në vitin 1879, ndërsa fakti tjerët se komuna e ka edhe vendkalimin kufitar në Gllaboçicë e bënë Kaçanikun vend të rëndësishëm dhe strategjik në rrafshin ekonomik, turistik, të bashkëpunimit ndërkufitar etj.

Planet dhe Strategjitë Komunale:

- Plani Zhvillimor Komunal;
- Planit Zhvillimor Urban të Qytetit të Kaçanikut;
- Plani për Vlerësimin e Rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në komunën e Kaçanikut;
- Plani Rregullues Urban për zonën e parë dhe një pjesë të zonës së dytë të Kaçanikut;
- Planit Rregullues për Zonën Turistike “Malet e Sharrit”;
- Plani Investiv në Infrastruktura të Ujësjellësit dhe Kanalizimeve në komunën e Kaçanikut;



Degët kryesore të ekonomisë lokale

Kaçaniku kryesisht është vend industrial, mirëpo ekzistojnë kushte të volitshme për zhvillimin e blegtorisë, bletarisë, pemëtarisë, zejtarisë e në veçanti kushte të mira për zhvillimin e turizmit dimëror-sportiv, veror, malor dhe transit. Kaçaniku ka resurse të mëdha natyrore e sidomos mineraleve të ndryshme si gurë gëlqeror, argjilë por edhe minerale tjera të cilat deri më tani nuk janë hulumtuar. Janë konstatuar rezerva të gurit gëlqeror në kepin e Kaçanikut prej 127 milion tonë dhe po ashtu 25 milion tonë rezerva të gurit gëlqeror në Ivajë, ndërsa ka edhe sasi tjera ende të pa hulumtuara.





Prona komunale

Komuna e Kaçanikut ka në pronësi të saj komunale 516.52.99 Ha tokë në total, të ndarë në 29 parcela të ndryshme nëpër vendbanime dhe zona të veçanta. Nga kjo, 24.39.02 Ha janë në zonën urbane ndërsa pjesa tjetër në zonat rurale. Parcelat me sipërfaqen më të madhe të pronës komunale gjendet në ZK Kotlinë me 142.20.02 Ha, ndërsa parcela me sipërfaqen më të vogël gjendet në ZK Nikocë me 0.16.49 Ha. Komuna ka shpallur Zonat Industriale për investitorët eventuale dhe atë në këto zona: Doganaj, Gërllicë e Epërme dhe Kaçanik i Vjetër dhe Begracë, në një sipërfaqe të përgjithshme prej 17 Ha.

INDEKSI I KOMUNËS

Shërbimi i Zjarrfikësve
Udhëheqës: Ylber Shehu
Tel: 038 200 46 443; 044/224 812; 044-228-228

Ndërmarrja Publike e Ujit K.R.U. "Bifurkacioni" NJO Kaçanik

Drejtor: Fevzi Dogani
Tel: 0290/ 380 - 113

N.P.L. Stacioni Autobusëve Drejtor Ekzekutiv: Naim Baftiu

Tel: 044/898 133

Ndërmarrja Publike e Mbeturinave K.R.M. "Pastërtia" NJO Kaçanik

Udhëheqës: Ferat Malsiu
Tel: 044/609 190

Stacioni i Trenit Shef i Stacionit: Raif Dema

Tel: 049/407 726

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

Drejtor: Dr.Nijazi Ilazi
Tel: 0290/ 380 344

Buxheti

Buxheti vjetor

Të hyrat vetanake

Buxheti i realizuar 2014	6,215,408.00	630,000.00
Buxheti aktual 2015	6,858,434.00	695,757.00
Buxheti i Projektuar 2016	6,631,386.00	709,772.00
Buxheti i Projektuar 2017	6,691,700.00	723,865.00
Buxheti i Parashikuar 2018	6,761.065.00	738,342.00

Struktura organizative

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

Kryetari i Komunës

**Kontakti: 0290/ 380 005;
 038 200 46 400;**

Nënkryetari

DREJTORITË KOMUNALE

1. Drejtoria e Administratës
2. Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik
3. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
4. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit
Tel: 038 200 46 422;

Shërbimi i Kuvendit

Anëtarët e Kuvendit: 27 anëtarë

Emergjencave

5. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
6. Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
7. Drejtoria Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë

SEKTORËT DHE NJËSITË

Sektori Emergjencave

Udhëheqës: Bujar Bajra
Tel: 038-200-46-442; 044/183 217

Zyra për Marrëdhënie me Publikun

Udhëheqës: Hajrush Dullovi
Tel: 038-200-46-444
 0290-380-047; 044/225-315
 E-mail: hajrush.dullovi@rks-gov.net;

Njësia për Komunitete dhe Kthim

Udhëheqës: Fadil Guri
Tel: 038 200 46 440; 044/228 115
 E-mail: Fadil.guri@rks-gov.net

Zyra për Barazi Gjinore

Udhëheqës: Vedat Dema
E-mail: Vedat.dema@rks-gov.net
Tel: 044/ 279 386

Qendra për Punë Sociale

Udhëheqës: Ramadan Luzha
Tel: 0290/ 380 545; 038 200 46 416; 044/224 919

Punësimi

Numri i të punësuarve në Komunën e Kaçanikut është rreth 5,860, ku rol të rëndësishëm ka luajtur sektori privat me rreth 4,875 të punësuar apo 83% dhe sektori publik me 985 nëpunës apo 17% të të punësuarve.



Shënime me rëndësi



Arsim

Komuna e Kaçanikut ka 2 shkolla të mesme nga këto 1 është e përgjithshme dhe 1 profesionale. Gjithashtu janë edhe 12 shkolla fillore me 23 paralele të ndara fizike, 1 qendër e edukimit dhe arsimit parashkollor si dhe 2 paralele për fëmijët me nevoja të veçanta, ndërkq arsimi zhvillohet në 4 nivele:

parashkollor, fillor, i mesëm i ulët dhe i mesëm i lartë. Institucioni parashkollor ka rreth 562 fëmijë; 12 shkollat fillore kanë diku 6,000 nxënës dhe mbi 500 mësimdhënës dhe 2 shkolla të mesme me afër 2,000 nxënës. Shumica e shkollave janë rindërtuar pas luftës së vitit 1999.

Kulturë

Zhvillimi i kulturës në Kaçanik është i orientuar në disa drejtime apo aktivitete. Aktivitetin e tyre të vazhdueshëm e ushtrojnë dy shoqëri kulturore dhe artistike të cilat prezantojnë folklorin lokal dhe kosovar brenda dhe jashtë vendit. Përveç këtyre në

këtë komunë është funksionale edhe biblioteka komunale e vendosur në shtëpinë e kulturës. Ngjarje të rëndësishme: Festivali Tradicional i Këngëve dhe Valleve Folklorike "Kaçaniku" i cili mbahet për çdo vit në muajin Qershor.



Sporti dhe Rinia

Sportet më të zhvilluara në Kaçanik janë: futboli, hendbolli, aeronautika, taekwondo, karateja, pingpongu etj. Aktualisht janë të regjistruara dhe zhvillojnë aktivitetet këto klube:

- Klubi i Futbollit "Lepenci";
- Klubi i Hendbollit "Lepenci";
- Klubi i Aeronautikës "Kaçaniku";
- Klubi i Futbollit për Femra "Kaçanikasja";
- Klubi i Taekwondos "Shqiponja";
- Klubi i Pingpongut "Kaçaniku".

...



Shëndetësia

Në komunën e Kaçanikut kujdesi primar shëndetësor realizohet përmes konceptit të mjekësisë familjare. Mjekësia familjare në Kaçanik është e organizuar në 13 institucione shëndetësore të mjekësisë familjare: 1 QKMF (Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare), 4 QMF (Qendra e Mjekësisë Familjare), 8 AMF (Ambulance e Mjekësisë Familjare).



Turizmi

Pikat më të vizituara dhe turistike në Kaçanik janë: Zona Turistike në "Shtrazë", Kalaja e Qytetit, Gryka e Kaçanikut, shpatijet e Sharrit, maja e Lybetenit etj.



Transporti

Kaçaniku shtrihet përgjatë rrugës kryesore mes Prishtinës dhe Shkupit. Gjithashtu, nëpër këtë qytezë kalon edhe linja hekurudhore Prishtinë-Selanik. Është portë kryesore për në Kosovë me lidhje të mira rrugore dhe hekurudhore: 70% e të gjitha mallrave të importuara për territorin e Kosovës kalon nëpër këtë kufi.





Komuna e Klinës





Komuna e Klinës



Sheshi "Mujë Krasniqi"
në Klinë.



<http://kk.rks-gov.net/kline/Home.aspx>



039/471-306;
039/471-310



komuna.kline.587@facebook.com



Informata të përgjithshme

Dita e komunës

18 Qershori
Dita e Çlirimit

Popullsia

38,496

Shqiptarë	37,216
Serb	400
RAE	1,097
Të tjerë	151

Grupmoshat

GM: 0-18 (19)	15,663
GM: 20-64	20,226

Sipërfaqja

309 km²

Vendbanime	34
Zona Urbane	1

Përshkrimi i komunës

Klina identifikohet si vendbanim i hershëm Ilir, me emër Chinna, të cilën e hasim te Ptolomeu që në vitet 87-150 (në hartën e Ptolomeut). Chinna në kuptimin Cin shpjegohet si kin në mes të Drinit të Bardhë dhe lumit Klina. Ky lokalitet i lashtë ilir shtrihej në bregun e majtë të rrjedhës së epërme të Drinit të Bardhë, që i përgjigjet realitetit të sotëm gjeografik. Kjo datë si dhe Ujvara e Mirushës u bënë edhe simbol i emblemës së qytetit të Klinës. Në zgjedhjen e fundit lokale 2013, me komunën e Klinës udhëheq Partia Demokratike e Kosovës (PDK).



Profili

Komuna e Klinës shtrihet në pjesën perëndimore të Kosovës. Qyteti i Klinës, gjendet në pikën ku lumi Klina derdhet në pellgun e lumit Drini i Bardhë. Në pjesën veri-perëndimore kufizohet me Istogun në pjesën perëndimore me Pejën, në jug-perëndim me Deçanin, në pjesën lindore me Skenderajn dhe pjesën jugore me Malishevën. Është komunë e cila kufizohet me pesë komuna të tjera.

Një nga destinacionet më atraktive turistike në komunën e Klinës është ujëvara e Mirushës, një zinxhir i ujëvarave në jug të maleve të Gremnikut, që formojnë 12 ujëvara të 13 liqeneve lumore brenda grykës 10km. Kjo grykë është caktuar si park rajonal nacional. Ujëvarat, me pejsazhin e shkëmbinjve dhe të shpellave, japin një pamje të mrekullueshme. Njëra nga shpellat është e njohur për stalaktitet, stalagmitet dhe shtyllat e formave dhe madhësive të ndryshme. Kjo është shpella e Dushit që gjendet në afërsi të fshatit Sferkë. Në mesin e lokacioneve të trashëgimisë kulturore në komunë është edhe kështjella e Mark Rrustem Jakajt në fshatin Ranoc.

Planet dhe Strategjitë Komunale:

1. Plani zhvillimor komunal
2. Plani rregullativ i komunës
3. Planet urbane komunale
4. Plani i veprimit për komunitetin RAE në komunën e Klinës 2014 – 2016
5. Plani lokal i veprimit për Rini 2015 -2016
6. Strategjia e zhvillimit ekonomik Lokal



Degët kryesore të ekonomisë lokale

Sikurse në shumicën e komunave të Kosovës edhe në Klinë për momentin zhvillimi ekonomik varet kryesisht nga bujqësia dhe blegtoria. Sektori më vital në ekonominë e Klinës tani është sektori i bizneseve private, shumica e tyre janë mikro-biznese dhe i adresohen veprimtarisë tregtare, ndërtimtarisë, transportit, shërbimeve hoteliere, zejtarit dhe riparime, shërbime shëndetësore dhe sociale dhe shumë pak në sferën e prodhimit.





Prona komunale

Prona Komunale të Komunës së Klinës janë 717.07.07 ha. Kjo komunë ka 43 zona Kadastrale. Nga komuna e Klinës janë dhanë në shfrytëzim 1.69.54 ha.

Indeksi i komunës

Stacioni Policor

Udhëheqës: Rexhë Berisha

Tel: 039 471 428

E-mail: rexhe_berisha@hotmail.com

Zjarrfikësit

Udhëheqës: Elmi Zenunaj

Tel: 039 471 053

E-mail: elmi.zenunaj@rks-gov.net

Qendra Komunale e

Mjekësisë Familjare

Udhëheqës: Ali Ahmetxhekaj

Tel: 039 471 102

Kompania e ujësjellësit

"Hidrodrini"

Udhëheqës: Halil Berisha

Tel: 049 445 300

E-mail: halil-be@hotmail.com

Kompania e mbeturinave

"Ambienti"

Udhëheqës: Tahir Morina

Tel: 044 223 089

E-mail: ambienti_kline@hotmail.com

Zyra e Mbrojtjes së Mjedisit

Udhëheqës: Dardan Bashota

Tel: 049920568

E-mail: dardan.Bashota@rks-gov.net

Buxheti

Buxheti vjetor

Të hyrat vetanake

Buxheti i realizuar 2014	7,680,201.00	840,000.00
Buxheti aktual 2015	8,346,381.00	857,767.00
Buxheti i Projektuar 2016	8,211,368.00	869,767.00
Buxheti i Projektuar 2017	8,310,752.00	881,767.00
Buxheti i Parashikuar 2018	8,476,199.00	

Struktura organizative

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

Kryetari i Komunës

Kontakti: 039/ 471 303;
038 /200 43700

Nënkryetari

DREJTORITË KOMUNALE

- | | |
|--|--|
| 1. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale | së Ambientit |
| 2. Drejtoria e Administratës | 7. Drejtoria për Shërbime Publike dhe |
| 3. Drejtoria e Arsimit | Emergjencia |
| 4. Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit | 8. Drejtoria e Inspektoratit |
| 5. Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural | 9. Drejtoria e Kulturës |
| 6. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes | 10. Drejtoria e Kadastrit dhe Gjeodezisë |

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit
039 / 471 - 335

Shërbimi i Kuvendit

Anëtarët e Kuvendit: 27 anëtarë



SEKTORËT DHE NJËSITË

Sektori Emergjencave

Emergjencia - QKMF 24 Orë
039/ 471 791

Zyra për Marrëdhënie me Publikun

Sektori i Zjarrfikësve

Tel: 039 471 598

Zyra e Alarmimit

Udhëheqës: Jak Dedaj

Tel: 039 471 544

Stacioni i policisë

Kapiten - Rexhë Berisha

Tel: 039 471 428

Tel: kujdestar 039/ 471 199

Qendra Komunale e Mjekësisë

Familjare

Udhëheqës: Ali Ahmetxhekaj

039 471 102

Punësimi

Në Arsim të punësuar janë gjithsej 660, në shëndetësi janë gjithsej 140 të punësuar dhe në administratë janë 136 të punësuar dhe 12 poste politike.

Qendra Për Punë Sociale

Udhëheqës: Elbasan Hoti

039/ 471 476

Zyra e Prokurimit

Udhëheqës: Abaz Foniqi

038 200 43 715

Zyra për Informim

Udhëheqës: Samije Gjergji

038 /200 43 716

Zyra e Teknologjisë Informative

Udhëheqës: Halil BEKAJ

038/ 200 43 777

Shënime me rëndësi



Arsim

Në komunën e Klinës funksionon arsimi parashkollor, fillor dhe arsimi i mesëm. Shkollimin fillor e vazhdojnë 9,006 nxënës të shpërndarë në 15 shkolla dhe 17 paralele të ndara; Shkollimin e mesëm e vazhdojnë 1,661 nxënës të shpërndarë në 2 shkolla të mesme. Gjimnazi ka këto drejtime: shoqëror-gjuhësor, i

përgjithshëm, shkenca natyrore, drejtimi pedagogjik, dhe shkolla e mesme teknike, me drejtimet; Makineri, xehetari, bujqësi, komunikacion dhe automekanik. Numri i të punësuarve në të dy nivelet e arsimit në komunën e Klinës është 643 mësimdhënës, duke përfshirë këtu edhe stafin administrativ.

Transporti

Pozita natyrore dhe topografia mundëson që Klina të ketë lidhje të mira rrugore dhe hekurudhore. Nëpër Klinë kalon magjistralja Prishtinë•Pejë e cila ka rëndësi të veçantë në nivel të Kosovës. Në Klinë gjithashtu gjendet njëja hekurudhore e cila rangohet si e dyta me rëndësi për territorin e Kosovës, pas njëjës hekurudhore në Fushë Kosovë. Rrjeti rrugor përbëhet prej rrugëve që kategorizohen në magjistrale, regjionale dhe

lokale. Magjistralja Prishtinë•Pejë paraqet arterien kryesore të qarkullimit rrugor, që në territorin e komunës shtrihet kryesisht në drejtimin lindje•perëndim, duke e ndarë atë në dy tërësi. Kjo magjistrale mundëson lidhje me pjesët qendrore dhe lindorë të Kosovës, duke e përfshirë edhe kryeqytetin, ndërsa përmes degëzimeve të mëtutjeshme mundëson lidhje me shtetet fqinje, Maqedoninë dhe Serbinë.



Sporti dhe Rinia

Komuna e Klinës karakterizohet me jetën sportive e rinore. Dallohet klubi futbollistik "Dukagjini". Komuna organizon edhe ditën rinore ku organizohen aktivitete të ndryshme sportive nga rinia e Klinës si: turniri në futboll (meshkuj), volejbol (femrat), ping pong dhe stop mation (forma më e re e të shprehurit të ideve përmes pikturave-vizatim).

...



Shëndetësia

Në komunën e Klinës funksionon 1 QKMF (Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare), 3 QMF (Qendra e Mjekësisë Familjare), si dhe 10 AMF (Ambulanca të Mjekësisë Familjare). Numri i përgjithshëm i të punësuarve në sektorin shëndetësor është 138.

...

Kulturë

Në komunën e Klinës funksionon shtëpia e Kulturës. Veç kësaj ka edhe dy biblioteka publike njëra në qytet dhe tjetra në fshatin Drenoc. Ndryshe trashëgimia kulturore në Klinë përfshin: Kishat e Petrovicës dhe Dollcit, Kullat, Ekspozitat, Mulli, Lapidare të luftës së fundit, enë, stoli, artizanale, vegla muzikore, lojëra tradicionale, tyrbe etj.



Turizmi

Komuna e Klinës është njëra ndër komunat në të cilat mund të zhvillohet turizmi dhe kjo fal bukurive të shumta natyrore të cilat i disponon. Këtu vlen të cekim rrjedha e lumit Mirusha, në anën jugore dhe jug-perëndimore janë ujëvarat e Mirushës të cilat janë një bukuri e rrallë natyrore duke pasur parasysh florën dhe faunën shumë të pasur. Ky kompleks përfshin një sipërfaqe prej 200 hektarësh me resurse të shumta natyrore dhe me një potencial të mirë për zhvillimin e turizmit. Po ashtu, vlen të theksohet si vend shumë i mirë për zhvillimin e turizmit malor duke filluar nga pusi i Jerinës duke vazhduar në lindje deri në fshatin Pogragjë, kjo zonë është e pasur me pyje halore gjethembajtëse dhe gjetherënëse dhe do të ishte një vend shumë atraktiv për turizëm.



Komuna e Fushë Kosovës





Komuna e Fushë Kosovës



Rruga "Nënë Tereza" Pn,
Fushë Kosovë,



[http://kk.rks-gov.net/
fushekosove/](http://kk.rks-gov.net/fushekosove/)



038/ 536/006



<http://kk.rks-gov.net/>



Informata të përgjithshme

Dita e komunës

12 Qershori
Dita e Çlirimit

Popullsia

34,827

Shqiptarë	30,275
RAE	3,948
Boshnjak	83
Serb	321
Të tjerë	521

Grupmoshat

GM: 0-18 (19)	13,203
GM: 20-65	19,481

Sipërfaqja

84 km²

Vendbanime	16
Zona Urbane	2

Përshkrimi i komunës

Fushë Kosova është qytezë e cila gjendet në pjesën qendrore të Kosovës. Komuna i takon Regjionit të Prishtinës, ajo është formuar në vitin 1989 nga një pjesë e komunës së atëhershme të Prishtinës. Sot është një nga komunat më dinamike e cila po përjeton ndryshime të mëdha urbanistike. Qyteti ndodhet përafërsisht 8km në jug-perëndim të qendrës së Prishtinës. Demografia e kësaj komune ka ndryshuar në dekadat e fundit. Komuna e Fushë Kosovës karakterizohet me një klimë të mesme kontinentale, me temperaturë mesatare vjetore 9.8oC dhe me reshje atmosferike mesatare prej 628mm në vit. Periudha e thatësisë përfshin kryesisht tre muajt e verës (korrik, gusht dhe shtator). Posedon me ujëra nëntokësor dhe sipërfaqësor, siç janë: Lumi "Sitnicë", "Drenicë", "Graçankë" dhe "Prishtina". Ndërsa sa i përket ujërave nëntokësor ekzistojnë disa burime në: Sllatinë të Madhe (Kroi i Malit), Harilaç (Kroi i Spahisë), dhe në fshatin Kroj-Ish Kuzmini.



Degët kryesore të ekonomisë lokale

Sektori i bujqësisë me degët e saj në komunën e Fushë Kosovës është një ndër burimet e rëndësishme të aktivitetit ekonomik të Komunës, ku pjesa më e madhe e territorit të Komunës është tokë bujqësore (60%). Po ashtu komuna ka të zhvilluar edhe sektorin e xehetarisë e cila përbëhet nga mihja sipërfaqësore në Bardh të Madh.

Degë tjetër e ekonomisë në komunë është gjithashtu industria.



Profil

Komuna e Fushë Kosovës shtrihet në qendër të "Rrafshit të Kosovës", me një sipërfaqe prej rreth 83km2 dhe me një lartësi mbidetare prej 550m. Territori i Komunës së Fushë Kosovës përfshin 14 zona kadastrale dhe është e përbërë prej këtyre fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane: Qyteti i Fushë Kosovës me lagjet: Bresje, Nakaradë dhe fshatrat: Lismir dhe Kuzmin; Bardh i Madh, Bardh i Vogël, Pomozotin, Graboc i Poshtëm, Sllatinë e Madhe, Sllatinë e Vogël, Harilaç, Henc, Vragoli, Miradi e Epërme, dhe Miradi e Poshtme. Komuna e Fushë Kosovës, në lindje kufizohet me Komunën e Prishtinës, në veri me Komunën e Obiliqit, në jug me Komunën e Lipjanit, ndërsa në perëndim kufizohet me Komunën e Drenasit.

Planet dhe Strategjitë Komunale

1. Plani Zhvillimor Urban Fushë Kosova 2021+ REVIDIMI;
2. Plani Zhvillimor Komunal Fushë Kosova 2013-2023;
3. Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2011-2014;
4. Plani zhvillimor urban 2010.



INDEKSI I KOMUNËS

Shërbimi i Zjarrfikësve

Lloji i shërbimit: Është njësi e vetme e zjarrfikësve dhe ndërhyrjes emergjente në komunë.

Ndërmarrja Publike Trafiku**Urban**

Tel: 038 540-574/038 553-107

E-mail:

Trafikuurban.prokurimi@gmail.com

Stacioni Autobusëve

Lloji i shërbimit: Është kompani publike lokale e cila është përgjegjëse për organizimin dhe mbarëvajtjen e vijave publike të transportit publik të autobusëve dhe kombi-busëve.

Ndërmarrja Publike Banesore

Tel: 038 55 33 11/038 52 30 01

E-mail: b_beqa2002@hotmail.com
ariquehaja@hotmail.com

Stacioni i Trenit

Lloji i shërbimit: Është stacion i udhëtarëve të transportit hekurudhor që lidh vijat kryesore Fushë Kosovë/Shkup në anën tjetër.

TERMOKOS" JSC"

Tel: 038 541-166/038 541-780

E-mail:

Fellanze.pulatermokos.org;
besa@termokos.org

Ndërmarrja Publike "Hortikultura"

Tel: 038 248-071/038 229-171

E-mail: hortikultura@hotmail.com

Kompania Publike Komunale "Sport-marketing"

Tel: 038 767-105

Kpk_sportmarketing@yahoo.com

Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi"

Tel: 038 525-191

Email: Krm_pastrimi@yahoo.com

Buxheti**Buxheti vjetor****Të hyrat vetanake**

Buxheti i realizuar 2014	7,335,046.01,729,040.0
Buxheti aktual 2015	8,011,258.01,822,756.0
Buxheti i Projektuar 2016	7,959,378.01,878,756.0
Buxheti i Projektuar 2017	7,948,435.01,791,756
Buxheti i Parashikuar 2018	8,706,672 2,370,000

Struktura organizative

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

Kryetari i Komunës

Tel: 038/200/40500;

038/ 536/006

Nënkryetari

DREJTORITË KOMUNALE

1. Drejtoria e Administratës
2. Drejtoria për Buxhet dhe Financa
3. Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
4. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
5. Drejtoria e Arsimit
6. Drejtoria për Inspektoriat

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit

Shërbimi i Kuvendit

Anëtarët e Kuvendit: 27 anëtarë

7. Drejtoria për Planifikim Urban
8. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedis
9. Drejtoria për Zhvillim Ekonomik
10. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
11. Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë



SEKTORËT DHE NJËSITË

Sektori Emergjencave

Njësi për të drejtat e njeriut
Zyra Ligjore
Zyra e regjistrimit të biznesit

Zyra e personelit
Mursel Morina

Tel: 044 117-785

Email: murselmorin@hotmail.com

Zyra për informim

E-mail: ali.sh.topalli@rks-gov.net

Tel: 038-536-067 Zyra e statusit civil

Shënime me rëndësi



Arsim

Në Komunën e Fushë Kosovës sistemi i arsimit zhvillohet në katër nivele: në arsimin parashkollor, fillor, i mesëm i ulët dhe i mesëm i lartë. Mësimi zhvillohet në dy gjuhë, në atë shqipe dhe serbe. Në kuadër të komunës së Fushë Kosovës funksionojnë 8 shkolla fillore me 6 paralele të ndara me mësim në gjuhën shqipe dhe një shkolle fillore të komunitetit serb. Po ashtu funksionon një shkolle e mesme dhe një institucion parashkollor (çerdhe). Gjithashtu funksionon edhe klasa speciale për nxënësit me nevoja të



veçanta në kuadër të shkollës fillore "Mihal Grameno" në Fushë Kosovë.

Kultura

Në Komunën e Fushë Kosovës ekziston një teatër amator dhe dy shtëpi të kulturës. Ekzistojnë shoqëri amatore kulturore të cilat zhvillojnë aktivitete kulturo-artistike me ndihmën financiare të Komunës. Në kuadër të aktiviteteve për rini dhe sport në komunën e Fushë Kosovës organizohet edhe dita Ndërkombëtare për Rini, ku mbahet aktivitetet të ndryshme. Komuna e Fushë Kosovës ka të themeluar edhe Këshillin e Veprimit në nivel Lokal. Jeta sportive në komunë është e organizuar dhe zhvillohet në



kuadër të 7 klubeve sportive: Klube të Futbollit (3), Klube të Atletikës (2), Klub i Boksit (1), Klub i Basketbollit (1).



Sporti dhe Rinia

Ferizaj tradicionalisht ka qenë qytet i sportit. Ekipet e tij, sidomos në hendboll, kanë garuar me sukses në Kosovë dhe jashtë saj. Në këtë komunë është e zhvilluar gjithashtu edhe futboli, volejboli, basketbolli, ping pongu, karateja, boksi, çiklizmi etj. Në Ferizaj e rrethinë janë rreth 1,400 sportistë aktivë, të cilët i zhvillojnë garat në 45 klube në rang lokal, rajonal dhe nacional. Shumica e aktiviteteve sportive zhvillohen në pallatin e sporteve "Bill Clinton", (rreth 1.2km nga qendra e qytetit përgjatë rrugës Ferizaj-Shtime, i cili ka vend për 1,832 shikues dhe në stadiumin e qytetit "Ismet Shabani". Objektet sportive janë të hapura çdo ditë pune për veprimtari sportive.

Shëndetësia

QKMF (Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare), në komunën e Fushë Kosovës ka rifilluar punën pas periudhës së luftës në Tetor të vitit 2000. Komuna e Fushë Kosovës, përveç Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare që gjendet në qytet, ka të funksionalizuara edhe ambulantat në Miradi të Epërme, Miradi të Poshtme, Vragoli, Kuzmin (fshat i banuar me komunitetin serb-malazet), Sllatinë e Madhe, Bardh i Madh, (të gjitha kanë ngrohje qendrore, ujë, kanalizim dhe infrastrukturën përcjellëse).



Turizmi

Vend interesant për t'u vizituar në komunën e Fushë Kosovës është Kompleksi Arkeologjik në fshatin Harilaq.



Transporti

Fushë Kosova gjendet në zonën e kryqëzimit të rrugëve me rëndësi për transport siç është rruga hekurudhore Fushë Kosovë/Shkup e cila



lidhet me rrugët ndërkombëtare, po ashtu ndodhet në kryqëzim të magjistrave të rëndësishme. Në territorin e saj gjendet edhe Aeroporti Ndërkombëtar Civil i Prishtinës. Ekzistojnë терминаlet hekurudhore në

Miradi të Epërme të cilat ndihmojnë zhvillimin ekonomik dhe pranim-dorëzimin e mallrave të bizneseve të ndryshme që paraqet një shtyllë të rëndësishme për zhvillim të ekonomisë në komunë.



Komuna e Kamenicës





Komuna e Kamenicës



Rruga "Skënderbeu" P.n.



<http://kk.rks-gov.net/kamenice/>



0280/ 372 204



<http://kk.rks-gov.net/kamenice/Home.aspx>

Misioni i komunës është sigurimi i një administratë me një performancë të lartë, një administratë efektive në kryerjen e shërbimeve, krijimin e kushteve për një zhvillim të shpejtë ekonomik, transparencë të lartë krijimin e kushteve të mira jetësore për qytetarët e komunës, menaxhimin e parasë publike me vigjilencë duke i ofruar informacione të bollshme qytetarëve për shpenzimet e tyre



Informata të përgjithshme

Dita e komunës

18 Qershori
Dita e Çlirimit

Popullsia

36,085

Shqiptarë	34,186
Serb	1,554
Rom	240
Të tjerë	74

Grupmoshat

GM: 0-19	12,652
GM: 20-64	20,516

Sipërfaqja

424 km²

Vendbanime	58
Zona Urbane	1

Përshkrimi i komunës

Në vitin 1952 nga Qarku i Gjilanit, formohen tri rrethe: Gjilani, Kamenica dhe Vitia. Në vitin 1959 kur transformohen rrethet, Kamenica shndërrohet në komunë të pavarur, si njësi e barabartë me komunat tjera në vend. Më procesin e decentralizimit të Komunës së Kamenicës i'u ka shkëputur një pjesë e territorit me 18 fshatra. Nga 13 fshatrat është krijuar komuna e re e Ranillugut në vitin 2010, si dhe 5 fshatra i bashkëngjiten komunës Novobërdës.



Degët kryesore të ekonomisë lokale

Kamenica ka një relief dhe kushte klimatike të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë. Bujqësia në komunën e Kamenicës ka resurse për zhvillimin e pemëtarisë, perimtarisë, blegtorisë, bletarisë, për prodhimin e mishit, shpeztarisë. Gjuetia gjithashtu është mjaftë e zhvilluar në komunë. Komuna e Kamenicës ka një sipërfaqe prej 417km² tokë, prej së cilës 39199.8308 ha është tokë bujqësore dhe male. Degë tjetër e ekonomisë në komunë është edhe industria e cila është bazuar në eksploitim dhe përpunim të pasurive ekzistuese minerale. Në Komunën e Kamenicës tregtia në sektorin privat kryesisht zhvillohet në dy fusha, tregti dhe shërbime. Zejtaria vazhdon të mbetet një fushë e rëndësishme për zhvillim ekonomik edhe në qytetin e Kamenicës.



Profili

Komuna e Kamenicës shtrihet në anën lindore të Kosovës. Kufizohet me komunën e Ranillugut, Gjilanit, Prishtinës, Novobërdës si dhe komunat e Republikës të Serbisë (Bujanocit, Medvegjës dhe Vrajës). Si tërësi, ka një sipërfaqe prej 414km². Përmes saj kalon lumi Krivareka. Kamenica gjendet 10km larg magjistrales Bujanoc – Gjilan, me të cilën lidhet me qendrat tjera të Kosovës. Gjilani ndodhet në largësi prej 30km, ndërsa Prishtina afër 80km. Në Prishtinë mund të shkohet edhe rrugës më të shkurtër, nëpër Novobërdë dhe Llabjan, ku në të dy drejtimet rruga shkurtohet për 55km. Transportin ajror në vend, Kamenica e realizon nga aeroporti i Prishtinës (90km largësi) dhe më rrallë nga ai i Petrovecit të Shkupit (100km largësi). Territori i Komunës së Kamenicës është kodrinoro-malorë (70%) dhe rrafshinor (30%), me disa lugina rreth lumenjve Krivarekë, Desivojcë dhe Hogosht që shtrihen në veri. Toka është kryesisht pjellore, e pasur edhe me kullosa, e përshtatshme për zhvillim të pemëtarisë, perimtarisë, lavëtarisë dhe blegtorisë. Kamenica ka klimë të mesme kontinentale.

Planet dhe Strategjitë Komunale

1. Plan i Zhvillimor i Komunës 2012-2022
2. Plan i Zhvillimor Urban i Kamenicës 2013-2018
3. Plan i Zhvillimor i Komunës 2013-2023.



INDEKSI I KOMUNËS

Shërbimi i Zjarrfikësve

Udhëheqës: Riza Bunkau

Tel: 044-231-040

Ndërmarrja e Postës dhe

Telekomit të Kosovës, Njësia
në Kamenicë,

Udhëheqës: Mehmet Latifaj

Tel: 0280-371-210

Ndërmarrja e KES/CO (

Kompani kosovare për
furnizim më energji elektrike
Sh.A)

Udhëheqës: Nexhat Xhelili

Tel: 038-501-101-4019.

**Ndërmarrja publike "ECO
HIGJENA" njësia punese në
Kamenicë**

Udhëheqës: Isuf Rudhani

Tel: 0280-372-438.

Ndërmarrja "Hidromorava"

Gjilan, njësia punuese në
Kamenice

Udhëheqës: Afrim Mujaj

Tel: 044-231-767

Buxheti

Buxheti vjetor

Të hyrat vetanake

Buxheti i realizuar 2014	7,257,486	934,500
Buxheti aktual 2015	7,731,552	986,433
Buxheti i Projektuar 2016	7,141,901	850,000
Buxheti i Projektuar 2017	7,220,810	875,000
Buxheti i Parashikuar 2018	7,294,959	885,000

Struktura organizative

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

Kryetari i Komunës

Kontakti: 0280 371 969

1. Nënkyetari

2. Nënkyetari për
Komunitete

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit

Tel: 0280 372 007

Anëtarët e Kuvendit: 27 anëtarë

DREJTORITË KOMUNALE

- | | |
|--|---|
| 1. Drejtoria e Administratës dhe Personelit | Hapësinor |
| 2. Drejtoria e Ekonomisë, Buxhetit dhe Financave | 8. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Ambientit dhe Inspektorat |
| 3. Drejtoria e Arsimit | 9. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim |
| 4. Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural | 10. Drejtoria e Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronësisë |
| 5. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport | 11. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale |
| 6. Drejtoria e Zhvillimit e Zhvillimit Ekonomik dhe Diasporë | |
| 7. Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit | |

SEKTORËT DHE NJËSITË



Spektori Emergjencave

Udhëheqës: Shëfik Beqiri

Tel: 044 125 638

Njësia për të drejtat e njeriut

Nazmije Demolli-Kastrati

nazmije.demolli@hotmail.com

Tel: 044 290 352

Zyra Komonale për komunitete dhe kthim

Teuta Kastrati

teutasvera@hotmail.com

Tel: 044 678 046

Zyra për informim

Sylejman Morina

sylejmanmorina@hotmail.com

Tel: 044 866 506

Zyra e Personelit

Udhëheqës: Faton Biqkaj

faton.biqkaj@rks-gov.net

Tel: 0280 372 507

Zyra për Marrëdhënie me publikun

Udhëheqës: Sylejman Morina

sylejmanmorina@hotmail.com

Tel: 044 866 506

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

Koordinatori: Fisnik Kastrati,

suhejb-2010@hotmail.com

Tel: 044 405 062

Shënime me rëndësi



Arsim

Procesi mësimor dhe edukativ në Komunën e Kamenicës zhvillohet në këto nivele: parashkollor (qerdhe), fillor, i mesëm i ulët dhe i mesëm i lartë. Mësimi zhvillohet në dy gjuhë, shqipe dhe serbe. Në komunën e

Kamenicës janë 20 shkolla fillore me 4,452 nxënës dhe 460 mësimdhënës, katër shkolla të mesme me 1,558 nxënës dhe 162 mësimdhënës dhe dy parashkollore me 55 fëmijë dhe 9 mësues.

Kulturë

Në komunën e Kamenicës ekziston një qendër kryesore e kulturës ku zhvillohen aktivitetet e ndryshme kulturore dhe OJQ të ndryshme të cilat merren me organizime të ndryshme kulturore. Organizimet dhe manifestimet e ndryshme kulturore në këtë komunë bëhen përmes drejtorisë komunale përkatëse.

Prona komunale

Komuna e Kamenicës ka në pronësi të saj komunale 416,63.24 Ha tokë në total, të ndarë në 58 zona kadastrale. Komuna ka shpallur Zonat Industriale: zonën kadastrale të fshatit Topanicë, dhe Hodonoc, në një sipërfaqe të përgjithshme prej 60 Ha.

Punësimi

Në komunën e Kamenicës në administratën komunale janë të punësuar 121 punëtor, në arsim janë 787 punëtorë, në shëndetësi 145 të punësuar, 5 në zyrën e punësimit, në PTK janë gjithsej 22 punëtorë, në KES/Co 39 të punësuar, në gjykatën komunale 33 punëtor. Ndërsa në ndërmarrjen publike të pastrimit dhe mbledhjes së mbeturinave "Ekohigjiena" janë të punësuar 23, në ndërmarrjen për furnizim me ujë "Hidromorava" janë 20 punëtorë.

Sporti dhe Rinia

Basketbolli në vitet pas luftës 2000 - 2005 është njëri ndër sportet më të popullarizuara në kryeqendër. Në këtë sport në elitën e klubeve Kosovare, Prishtina është e prezantuar nga dy skuadra. Futboli Prishtinas ka një traditë të gjatë sportive. Prirës i kësaj tradite është skuadra që mbanë emrin e qyteti KF Prishtina e cila ndeshjet vendase i zhvillon në Stadiumin e Qytetit. Taekëondo-ja është gjithashtu sport i zhvilluar në qytetin e Prishtinës, ku dallohen Klubet e TAEKËONDO-se Prishtina dhe Akademia e Arteve Marciale Prishtina.

...



Shëndetësia

Sistemi i kujdesit shëndetësor parësor në komunën e Kamenicës përfshin 1 qendra kryesore komunale shëndetësore të familjes, 3 qendra të kujdesit shëndetësor të familjes, dhe 17 shtëpi shëndetësore në dy fshatrat e banuara me shqiptarë dhe serbë të Kosovës. Sektori i shëndetësisë ka 146 të punësuar, 87 femra dhe 59 meshkuj, duke përfshirë edhe mjekë, infermierë dhe personel mbështetës.



Turizmi

Vendet interesante për t'u vizituar në Kamenicë janë: Kitka legjendare; Poliçka; Memoriali i Kadri Zekës; Manastiri në Moqar, Kalaja e Kopernicës, Tyrbja e Dazhnicës.



Transporti

Sot në komunën e Kamenicës operojnë disa kompani të transportit privat, të cilat e mbulojnë të gjithë territorin e komunës së Kamenicës. Operatoret transportues privat, respektojnë linjat e caktuara duke respektuar edhe orarin i cili paraprakisht është i publikuar. Linjat brenda territorit të komunës janë: Kamenice-Hogosht, Kamenice-Karaqevë,

Kamenicë-Strezoc-Krilevë. Linjat jashtë territorit të komunës janë: Kamenicë-Gjilan-Prishtinë, Hogosht-Gjilan-Prishtinë, Shipashnice-Gjilan, Karaqevë-Gjilan.

Transporti me autobus, organizohet në disa forma dhe atë: transport ndërkombëtar, transport ndër urban dhe transport urbano-periferik. Këto kategori janë të ndara edhe sipas menaxhmentit, ku transporti ndërkombëtar dhe ndër-urban menaxhohet

nga Ministria e Infrastrukturës, kurse transporti urbano-periferik menaxhohet nga komuna. Përveç vijave të rregullta gjatë sezonës verore kemi vijat për shumicën e qyteteve bregdetare të Shqipërisë dhe për Ulqin. Vijë e rregullt ditore është edhe linja Kamenicë-Tiranë. Në mungesë të autobusëve nëpër disa fshatra ku ka lëvizshmëri më të vogël, linjat janë të mbuluara me kombi-bus privat, të cilët pajisen me leje nga DSHPAI.



Komuna e Mitrovicës Jugore





Komuna e Mitrovicës Jugore



Rruga "Bedri Gjinaj"
p.n - 40000



<http://kk.rks-gov.net/mitrovica>



+381 (28) 532-104 -
+381 (28) 532-925



komuna.mitrovices@rks-gov.net



Informata të përgjithshme

Dita e komunës

6 Qershori

Dita e Dëshmorëve

Popullsia

71,909

Shqiptarë
RAE
Turk
Boshnjak

69,497
1181
518
416

Grupmoshat

GM: 0-18 (19) 27,092
GM: 20-64 39,743

Sipërfaqja 331 km²

Vendbanime 46
Zona Urbane 3

Përshkrimi i komunës

Pozita strategjike dhe sidomos ajo gjeografike në mes dy lumenjve të rëndësishëm, Ibrit e Sitnicës, ka bërë që territori i Mitrovicës të popullohet qysh në parahistori. Motiv ekonomike për themelimin e vendbanimeve dhe për përqendrimin e popullsisë në këtë trevë, para së gjithash, kanë qenë blegtoria, bujqësia, gjuetia e më pas edhe xehetaria në fillim e zhvilluar në masë modeste për t'u bërë më vonë një ndër shkaqet kryesore të depërtimit romak dhe pushtuesve sllavë, osmanë etj, në këtë anë. Kjo trevë, sikurse pjesët tjera të Gadishullit Ilir, në lashtësi kanë qenë e banuar me banorë ilirë, përkatësisht fisin dardan.

Profil



Shtrihet në fushën aluviale të lumenjve: Ibër, Sitnicë, Lushtë dhe Trepça, si dhe në shpatet e kodrave që e rrethojnë. Pozita gjeografike është e volitshme për shkak të relievit. Qyteti kufizohet nga shpatet e Kreshbardhës (Kopaonikut), Rogoznës, Moknës dhe Qyqavicës. Territori i kësaj komune kufizohet me komunën e Zveçanit (në pjesën veriore), me komunën e Besianës (në pjesën lindore), me komunën e Vushtrisë (në pjesën jugore), komunën e Skenderajit (në pjesën perëndimore) dhe me komunën e Zubin Potokut (në pjesën veriperëndimore). Në drejtim të Sitnicës lidhet me Rrafshin e Kosovës. Qytetin, nga ana jugore e ndanë prej bazenit të Kos-ovës kodrina tufoide e Bajrit (520 m). I tërë territori i rrethinës së Mitrovicës ka një pozitë të rëndësishme, sidomos për komunikacionin transitor. Mitrovica shtrihet në shkallën 42,53° të gjerësisë gjeografike veriore dhe në atë 25, 52° të gjerësisë gjeografike lindore si dhe në lartësinë mbidetare 508-510 m.

Prona Komunale

Sipërfaqja e pronës komunale në qytet, jashtë qytetit dhe në fshatra përfshinë sipërfaqen e tërësishme prej 11624,71.13 ha. Ku prej tyre 258,38.47 ha janë sipërfaqe e pronës komunale në qytete kurse sipërfaqja e pronës komunale në fshatra është 9192,82.66 ha



Degët kryesore të ekonomisë lokale

Në Kosovë dhe rajon Mitrovica është e njohur për pasuritë e begatshme natyrore, kryesisht me metalet e Plumbit dhe Zinkut. Ekonomia e tërë në Mitrovicë është zhvilluar përreth industrisë së minierave dhe nxjerrjes dhe përpunimit të metaleve. Të dhënat e shfrytëzimit të tokës në Komunën e Mitrovicës, tregon që toka për bujqësi dhe livadhe përfaqëson 50.29% të sipërfaqes së përgjithshme.

Prona Komunale

Komuna e Ika 1540 parcela (pronë komunale), në sipërfaqe prej 56,819,776 m2.

PUNËSIMI

Sipas të dhënave të QKB-së dhe ARBK-së në ndërmarrjet publike duke e përfshirë Trepçën, Ujësjellësin Rajonal –Mitrovicë, Kompaninë rajonale të mbeturinave, Tregu SH.A dhe ndërmarrjet private janë të punësuar 17.441 punëtorë, 10235 në ndërmarrjet publike kurse që i bie 58.6 % në ndërmarrjet publike, dhe 7206 në sektorin privat apo 41.4 % .



SEKTORËT DHE NJËSITË

Zyra e Personelit
Udhëheqës: Rrahman Beqiri
Tel: 028/532-104 049/269-49

Zyra për Informim
Tel: 028/530-366

Zyra për Komunitete
Udhëheqës: Snezana Nesterovic
Tel: 028/532-104

Zyra ligjore
Udhëheqës: Lulzim Hajra
Tel: 028/532-104

Zyra e auditorëve
Udhëheqës: Nexhat Berani
Tel: 028/532-104

Zyra e regjistrimit të bizneseve
Udhëheqës: Florije Ibishi – Rudniku
Tel: 028/532-104

Kabineti i Kryetarit
Udhëheqës: Selviye Kurti
Tel: 028/530-201/202

Qendra për punë Sociale
Udhëheqës: Miran Salihu
Tel: 049/734-665

INDEKSI I KOMUNËS

Shërbimi i Zjarrëfikësve
Drejtor: Tahir Mikullovc
Tel: 044/978-748

Ndërmarrja Publike e Ujit
Drejtori: Faruk Hajrizi
Tel: 044/540-770

N.P.L. Stacioni Autobusave

**Ndërmarrja Publike e
Mbeturinave**
Drejtor: Skender Tahiraj
Tel: 044/668-782

Stacioni Policor
Drejtor: komandant Ahmet
Gjoshaj
Tel: 049/235-385

**Qendra Kryesore e Mjekësisë
Familjare**
Drejtor: Fevzi Sylejmani
Tel: 049/627-213

Buxheti

Buxheti vjetor

Të hyrat vetanake

Buxheti i realizuar 2014	14,625,427.00	2,312,436.00
Buxheti aktual 2015	15,733,116.00	2,117,292.00
Buxheti i Projektuar 2016	15,948,321.00	2,267,582.00
Buxheti i Projektuar 2017	16,138,553.00	2,358,772.00
Buxheti i Parashikuar 2018	16,272,915.00	2,375,283.00

Struktura organizative

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

Kryetari i Komunës

Nënkryetari

Nënkryetari për
komunitete

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit
049-734713

Shërbimi i Kuvendit

Anëtarët e Kuvendit: 35 anëtarë

DREJTORITË KOMUNALE



1. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
2. Drejtoria e Shëndetësi
3. Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit
4. Drejtoria e Arsimit
5. Drejtoria e Planifikimit dhe Urbanizmit
6. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturë
7. Drejtoria e Inspeksionit

8. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
9. Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
10. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim
11. Drejtoria e Prokurimit
12. Drejtoria e Mbrojtjes së mjedisit
13. Drejtoria e Integritimit Evropian dhe Mirëqenie Sociale
14. Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

Shënime me rëndësi



Arsim

Mitrovica ka 39 shkolla fillore me 12,466 nxënës dhe 5 shkolla të mesme me 5,125 nxënës. Në Mitrovicë është zhvilluar edhe shkollimi i lartë, ku në qytet operojnë katër universitete: 1) Universiteti Publik i Mitrovicës "Isa Boletini", 2) Universiteti i Shkencave të Aplikuara, 3) Kolegji privat "Fama", dhe 4) Kolegji privat "International Business College Mitrovica".

Shëndetësia



Në komunën e Mitrovicës ekziston një qendër kryesore e mjekësisë familjare, 8 qendra të mjekësisë familjare dhe 14 ambulanca. Në Mitrovicë punojnë 273 punëtor shëndetësor. Përndryshe komuna e Mitrovicës e ka edhe spitalin e qytetit por spitali gjendet në pjesën veriore të qytetit dhe nuk mund të shfrytëzohet nga banorët shqiptarë për arsye politike që tashmë dihen.

Kultura

Aktivitetet më të rëndësishme kulturore, që tashmë janë tradicionale (të përvitshme) në komunën e Mitrovicës janë: Garat Komunale të Recituesve të Rinj, Festivali i Grupeve Teatrore të Shkollave Fillore, Festivali i Komedisë, Revista e Folklorit, Takimet me mërgimtarët tanë, Revista letrare "Fjalë e valë", Kolonia e artistëve "Mitrovica Art Colony", Bridge Film Fest – Festival Ndërkombëtar i Filmit, Kinemaja e hapur, Ditët e Muzikës Klasike, Festivali i këngës për fëmijë "Cicërimat buzë Ibrit", Festa e ushqimeve tradicionale, Festivali i muzikës GREEN, Ekspozita e Nëntorit dhe dhënia e Çmimit "Kadri Kadriu", Manifestimi letrar ndërkombëtar "Drita e Minatorit", etj.

...

Sporti

Përfshirja e popullsisë së Mitrovicës dhe pjesëmarrja e tyre në aktivitetet sportive është realizuar dhe realizohet kryesisht përmes pjesëmarrjes së tyre në aktivitetet e klubeve sportive, në rrafshet e ndryshme, në kuadër të federatave përgjegjëse. Në kuadër të të gjitha këtyre klubeve veprojnë të gjitha kategoritë si fatosat, pionierët, kadetët, juniorët, seniorët e në disa raste dhe në disa klube edhe veteranët që në përgjithësi arrijnë shifrën prej afro 2.200 pjesëmarrës të cilët defilojnë dhe marrin pjesë në aktivitetet sportive, përmes klubeve sportive dhe në federatat përgjegjëse.

Në kuadër të objekteve sportive bëjnë pjesë edhe poligonet sportive, sallat sportive të shkollave fillore dhe atyre të mesme, të cilat në rast nevojë mund të përdoren edhe për zhvillimin e sportit.



Turizmi

Sa i përket turizmit në rajonin e Mitrovicës vlen për t'u veçuar Shala e Bajgorës. Llojet e turizmit që mund të zhvillohen në regjionin e komunës së Mitrovicës janë: Turizmi malor, Turizmi kulturor, Eko-turizmi, Turizmi rural.



Transporti

Infrastruktura e Komunës së Mitrovicës është e ngjashme me atë të komunave tjera në Kosovë. Mitrovica është e lidhur me të gjitha qytetet e mëdha të rajonit dhe përgjatë Mitrovicës kalon rruga që lidhë Prishtinën me Beogradin. Përveç kësaj, përgjatë Mitrovicës kalon hekurudha që përfundon në Shkup në




jug, dhe në Beograd në veri, edhe pse hekurudha nuk operon me rregull. Sipas raportit të publikuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe USAID-it, në Komunë të Mitrovicës janë 241.5 km rrugë lokale, nga e cila 70% është rrugë e shtruar. Gjithashtu, Komuna e Mitrovicës ofron transport publik në 34 fshatra, që mundëson lëvizje më të lehtë nga fshati në qytet.



KOMUNA E LEPOSAVIQIT





Komuna e Leposaviqit



Komuna e Leposaviqit ndodhet në veri të Kosovës. Ajo ka një sipërfaqe prej rreth 750 km² duke përfshirë qytetin e Leposaviqit dhe 72 fshatra. Sipas administratës komunale popullsia e përgjithshme vlerësohet të jetë 18,600 banorë.

Informata të përgjithshme

1. Serbët e Kosovës: përafërsisht 18,000 jetojnë në qytetin e Leposaviqit dhe në fshatrat përreth;
2. Shqiptarët e Kosovës: përafërsisht 270 jetojnë në fshatrat Koshtovë, Bistricë e Shalës dhe Cerajë;
3. Boshnjakët e Kosovës: 350, nga të cilat rreth 120 banojnë në qytet dhe 230 në fshatra;
4. Romët dhe Ashkalinjtë e Kosovës: 24 jetojnë në kampin e Leposaviqit, ndërsa 41 (Romë ortodoks) jetojnë në fshatin Kamen



EKONOMIA

Ekonomia e komunës së Leposaviqit mbështetet kryesisht në bujqësi dhe biznese të vogla tregtare. Nuk ka të dhëna të besueshme për numrin e bizneseve të regjistruara dhe numrin e të punësuarve në sektorin privat në Leposaviq (Burimi: Departamenti komunal për financa, ekonomi dhe mbrojtje të mjedisit).

INFRASTRUKTURA

Gjendja e përgjithshme e infrastrukturës në komunën e Leposaviqit është vlerësuar si e pazhvilluar. Rrugët, energjia elektrike dhe furnizimi me ujë janë në përgjithësi të pazhvilluara, edhe pse janë bërë disa renovime me ndihmën ndërkombëtare dhe të qeverisë serbe. Furnizimi me energji elektrike është mjaft i qëndrueshëm.





Shënim:

144 zyrtarë policor
284 mësues
4 shkolla fillore dhe 2 të mesme



SHËNDETËSIA

Shërbimi primar shëndetësor përfshinë: 1 shtëpi të shëndetit dhe 8 njësi. Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 147 persona, prej të cilëve 113 femra dhe 34 meshkuj, duke përfshirë doktor, infermiere dhe stafi tjetër mështetës. Po ashtu është edhe një njësi shëndetësore në fshatin Bistricë me stafin mjekësor prej 2 personave.

Struktura organizative

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

Kryetari i komunës

Nënkryetari i komunës

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi

Anëtarët e Kuvendit: 19



ARSIMI

Ekzistojnë 3 shkolla fillore me 1.294 nxënës dhe 181 mësimdhënëse; 2 shkolla të mesme me 405 nxënës dhe 93 mësimdhënëse; dhe 3 kopshte me 661 fëmijë dhe personel me 175 të punësuar. Është edhe 1 shkollë fillore që ndodhet në fshatin Bistricë të populluar me Shqiptarë të Kosovës dhe ka 29 nxënës dhe 16 të punësuar, nga të cilët 10 janë mësimdhënëse. Komuna gjithashtu ka tri fakultete – të pedagogjisë, të sportit dhe për agronomi, si dhe 1 kolegji - të ekonomisë. Këto fakultete janë degë e universitetit publik në Mitrovicën veriore.

OBJEKTET FETARE DHE KULTURORE

Leposaviqi ka 16 kisha ortodokse serbe dhe 3 manastire. Disa kisha ortodokse serbe janë rinovuar pas konfliktit të vitit 1999. 1 xhami është ndërtuar pas vitit 1999 në fshatin Rëvatskë, e banuar nga boshnjakët e Kosovës, e cila aktualisht ka nevojë për riparim (burimi: prifti lokal i Kishës Ortodokse Serbe, zyrtari komunal për komunitete dhe administrata komunale).





Komuna e Lipjanit





Komuna e Lipjanit



Rr. "Shqipëria" p.n.



<http://kk.rks-gov.net/lipjan/>



038 200 41 508



infokomuna.lipjan@rks-gov.net
<https://www.facebook.com/Komuna-e-Lipjanit-Faqja-Zyrtare>



Misioni: Të rritet autonomia lokale dhe të forcohet aftësia e Komunës, që nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të qytetarëve dhe përfaqësimit demokratik, të ofrohen shërbime me kosto efektive dhe të përgjegjshme për të rritur cilësinë e jetës, sigurinë dhe ekonominë lokale.



Informata të përgjithshme

Dita e komunës

12 Qershori
Dita e Çlirimit

Popullsia

57,605

Shqiptarë 54,467
Serbë 513
RAE 2,158
Të tjerë 440

Grupmoshat

GM: 0-18 (19) 22,899
GM: 18-65 31,234

Sipërfaqja

338 km²

Vendbanime 61
Zona Urbane 1

Përshkrimi i komunës

Lipjani është pjesë e Rrafshit të Fushë Kosovës, dikur ishte pjesë e qytetit Ulpiana të kohës së Ilirëve e më vonë Romakëve. Zgjerimet e mëtutjeshme të qytetit u zhvilluan përgjatë rrugës Prishtinë-Shtime-Ferizaj dhe përgjatë rrugës për në Suhadoll. Lipjani ka mundësi të volitshme të shfrytëzimit të trafikut rrugor – hekurudhor, si dhe trafikut ajror, për arsye se aeroporti i vetëm ndërkombëtar i Kosovës, gjendet në territorin e Komunës së Lipjanit. Përmes territorit të Komunës së Lipjanit kalon hekurudha e cila lidh këtë territor në të gjitha drejtimet me rajonin në tërësi. Tani së fundmi nëpër territorin e Komunës kalon edhe autostrada “Arbër Xhaferi” që lidh Prishtinën me Shkupin.



Profili

Komuna e Lipjanit ka pozitë të përshtatshme gjeografike, sepse gjendet në pjesën qendrore të Republikës së Kosovës dhe në udhëkryqin e rrugëve më të rëndësishme të rajonit. Kufizohet me komunat: Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë, Drenas, Suharekë, Malishevë, Shtime, Ferizaj, Gjilan dhe Artanë.

Komuna e Lipjanit ka 62 vendbanime, ku numëri më i madh i tyre janë të koncentruar në fushëgropën e Kosovës që paraqet pjesën qendrore të Komunës së Lipjanit. Ndërsa vendbanimet e tjera shtrihen në pjesën lindore dhe perëndimore të kufijve morfologjik pjesëve kodrinoro-malore të Komunës së Lipjanit.

Rajoni i Komunës së Lipjanit ka klimë të mesme kontinentale me dimra relativisht të butë dhe verëra mesatarisht të nxehta. Muaji më i ftohtë është Janari me -0.90°C ndërsa muaji më i ngrohtë është Korriku me 20.40°C .

Planet dhe strategjitë

1. Plan i Zhvillimor i komunës;
2. Plan i Zhvillimor Urban;
3. Planet Rregullative të komunës;
4. Strategjia e zhvillimit ekonomik Lokal



Degët kryesore të ekonomisë lokale

Territorin e komunës së Lipjanit e karakterizojnë pasuritë e begatshme tokësore dhe nëntokësore, pozita mjaft e volitshme gjeografike dhe fuqia e re punëtore, të cilat kanë qenë dhe janë bazë e fortë për një zhvillim të suksesshëm ekonomik. Ekonomia e Lipjanit deri në vitet e 70-ta karakterizohet kryesisht me eksploatimin e lëndëve të para si dhe me kultivimin e prodhimeve primare bujqësore. Komuna e Lipjanit është trevë kryesisht bujqësore. Është e pasur me resurse natyrore, të cilat paraqesin bazë të volitshme për zhvillim. Minerale të cilat posedon Komuna e Lipjanit janë: Magneziti, nikeli, thëngjilli, zinku, kromi, duniti, rëra, kuarci, zhavorr. Komuna e Lipjanit posedon rreth 25.867 ha, sipërfaqe bujqësore prej së cilës 19.385 ha, janë tokë e punueshme – pjellore.



DREJTORITË KOMUNALE

1. Drejtoria për Administratë
2. Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim
3. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
4. Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër
5. Drejtoria e Arsimit
6. Drejtoria për Buxhet dhe Financa
7. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim
8. Drejtoria e Urbanizmit
9. Drejtoria e Inspektoriatit
10. Drejtoria për Shërbime Publike
11. Drejtoria e Prokurimit
12. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
13. Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Buxheti

Buxheti vjetor

Të hyrat vetanake

Buxheti i realizuar 2014	11,333,444.0	1,166,927.0
Buxheti aktual 2015	12,399,253.0	1,342,336.0
Buxheti i Projektuar 2016	12,943,839.0	1,650,000.0
Buxheti i Projektuar 2017	13,245,178.0	1,870,000.0
Buxheti i Parashikuar 2018	13,361,966.0	1,890,000.0

Struktura organizative

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

Kryetari i Komunës

Kontakti: 038-200-415-22

Nënkryetari

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit
Tel: 038 200 41 523

Shërbimi i Kuvendit

Anëtarët e Kuvendit: 31 anëtarë

SEKTORËT DHE NJËSITË

Njësia e Zjarrfikësve
Udhëheqës: Haqif Rustemi.
Tel: 038 200 41 548.

Zyra për Marrëdhënie me Publikun
Udhëheqëse: Bukurije Zejnullahu.
Tel: 03820041508

Zyra Lokale për Komunitete dhe Kthim
Udhëheqëse: Radmilla Simijanoviq
Tel: 038 200 41 559 .

Spektori për përfaqësim dhe çështje ligjor
Udhëheqëse: Vlora Krasniqi
Tel: 038 200 41 506

Zyra për Barazi Gjinore dhe të drejta të njeriut
Udhëheqëse: Gjyste Debaj .
Tel: 038 200 41 513 .

Njësia e Auditimit të Brendshëm
Udhëheqës: Safet Krasniqi .
Tel: 038 200 41 505 .

Spektori për protokolll
Udhëheqës: Hasan Zeqiri
Tel: 038 200 41 544

Spektori për Menaxhimin e Projekteve
Udhëheqës: Xhelil Murati
Tel: 038 200 41 521

Spektori pronësor – juridik
Udhëheqëse: Lumnije Ejupi
Tel: 038 200 41 507

Zyrtari Komunal për Integritet Evropian
Mimoza Karameta
Tel: 038 200 41 509

Spektori për Administratë të përgjithshme
Udhëheqës: Burim Gashi
Tel: 038 200 41 512

Spektori për punë të Kuvendit dhe Komiteteteve
Udhëheqës: Haqif Shillova
Tel: 038 200 41 517

Spektori për gjendjen civile
Udhëheqës: Murat Haziri
Tel: 038 200 41 518

Spektori për Mirëmbajtje dhe Sigurim të Objekteve
Udhëheqës: Ramadan Banulla
Tel: 038 200 41 529

Spektori për Shëndetësi
Udhëheqëse: Sevdije Vishesella
Tel: 038 200 41 547

Spektori për përkujdesje sociale
Udhëheqëse: Makfirete Shamolli
Tel: 038 200 41 540

Spektori për Kulturë
Udhëheqës: Selman Jashanica
Tel: 038 200 41 536

Spektori për Rini dhe Sport
Udhëheqës: Agim Bylykbashi
Tel: 038 200 41 533

Spektori për Buxhet dhe Financa
Udhëheqës: Shaban Sylja
Tel: 038 200 41 541

Spektori për Tatim në Pronë
Udhëheqës: Shemzi Azemi
Tel: 038 200 41 545

Spektori i Thesarit
Udhëheqës: Bashkim Sadiku
Tel: 038 200 41 543

Spektori për Urbanizëm
Udhëheqës: Hasim Vishesella
Tel: 038 200 41 550

Spektori për Gjeodezi
Udhëheqës: Ilir Shala
Tel: 038 200 41 554

Spektori për Kadaster
Udhëheqës: Ramush Asllani
Tel: 038 200 41 553

Spektori i Bujqësisë:
Udhëheqës: Afrim Sadiku
Tel: 038 200 41 537

Spektori i Pylltarisë
Udhëheqës: Milazim Miftari
Tel: 038 200 41 558

Spektori për personel
Udhëheqëse: Xhevahire Zeqiri
Tel: 038 200 41 510

KKS
Kordinator: Haqif Rustemi
Tel: 038 580-093.
Email: haqif.rrustemi@gmail.com

Shënime me rëndësi



Arsim

Procesi edukativo arsimor në qytetin e Lipjanit zhvillohet në nivelet, prej atij parashkollor e deri tek ai i mesëm i lartë në gjuhën shqipe dhe serbe.

Institucionet arsimore:
24 Shkolla fillore me 11,212 fëmijë, 3 Shkolla të mesme me 2,893 nxënës, 2 Çerdhe me gjithsej 136 fëmijë.

Kultura

Aktiviteti kryesor dhe tradicional në kuadër të Drejtorisë për Kulturë është Manifestimi Kulturo-Shkencor „Gjurmë të Gjeçovit“ në Janjevë. Po ashtu, si aktivitet tradicional është edhe organizimi i Javës së Kulturës çdo vit nga 01 deri më 14 Qershor. Në kuadër të Sektorit për Kulturë kemi shërbimin Bibliotekar, arkivin historik të qytetit dhe Shtëpinë e Kulturës. Në kuadër të

Shtëpisë së Kulturës zhvillohen një varg aktivitete nga grupet, shoqatat dhe shoqëritë muzikore si: Ansambli i Këngëve dhe Valleve „Lipjani“. Në kuadër të Ansambllit kemi edhe grupin e Instrumentistëve të Vegjël. Gjithashtu është funksional edhe Klubi Letrar “Fazli Grajçevci”. Tani Komuna e Lipjanit, në bashkëpunim publiko – privat ka funksionalizuar Kinemanë e qytetit 3D.



Punësimi

Në bazë të regjistrimit të fundit të popullsisë, në Komunën e Lipjanit janë të punësuar 8,252 persona. Ndërsa nga shënimet e marra nga Enti i punësimit për këto dy vitet e fundit kemi edhe 292 të punësuar në sektorin privat. Prej tyre 1,506 janë shërbyes civil ndërsa në sektorin privat janë të punësuar 7,038 persona.

...

Sporti dhe Rinia

Në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, përkatësisht Sektori për Rini dhe Sport është në funksion edhe Qendra Arsimore e Sportive, ku të gjitha klubet sportive e shfrytëzojnë për zhvillimin e aktiviteteve të veta me kushte mjaft komode. Në Komunën e Lipjanit funksionon Këshilli i Veprimit Rinor Lokal, është e licencuar një Qendër Rinore si dhe veprojnë edhe shumë OJQ të tjera rinore.

...

Shëndetësia

Mjekësia familjare në Lipjan është e organizuar në 12 institucione shëndetësore të mjekësisë familjare: 1 QKMF (Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare), 4 QMF (Qendra e Mjekësisë Familjare), 7 AMF (Ambulance e Mjekësisë Familjare).

INDEKSI I KOMUNËS

Shërbimi i Zjarrfikësve
Udhëheqës: Haqif Rustemi .
Tel: 580-093 ose 580-067

Ndërmarrja Publike e ujit
Udhëheqës: Elmi Bublica.
Tel: 044/ 175 - 960

Stacioni Policor
Drejtor: Imer Kaqara
Tel: 038 581 010

Ndërmarrja Publike e Mbeturinave
Udhëheqës: Xhelal Krasniqi
Tel: 044/ 226 002

Stacioni i Trenit
Drejtor: Burim Bullatovci
Tel: 049/406 - 726

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
Drejtor: Agim Krasniqi.
Tel: 038 582 604



Turizmi

Disa nga pikat ku mund të orientohet zhvillimi i turizmit në komunë janë: Parku nacional Blinaja ,Shpella e Mermerit në Gadime, Parku kulturo-historik në Kleçkë dhe Divjakë, Uji termal në Bincë si dhe Janjeva.



Transporti

Infrastruktura e komunës së Lipjanit është mesatarisht e kënaqshme. Në tërë territorin e Lipjanit janë të shtrëna(asfaltuara) 206km rrugë. Hekurudha kalon

përmes komunës së Lipjanit me gjatësi prej 13km, me 3 stacione. Autostrada Prishtinë-Shkup, kalon nëpër territorin e Komunës së Lipjanit në gjatësi prej 9.7km. Rrugë magjistrale janë 30km, ndërsa rrugë regjionale 27km. Janë 56 stacione ndihmëse për ndalje të Autobusëve. Në territorin e Komunës së Lipjanit gjendet edhe Aeroporti Ndërkombëtar i Republikës së Kosovës "Adem Jashari".





Komuna e Novobërdës





Komuna e Novobërdës



Fshati Bostan p.n
16000, Novobërdë



<http://kk.rks-gov.net/novoberde/Home.aspx>



0280/381-647/
038/576-012



<http://kk.rks-gov.net/novoberde/City-guide/Important-Phone.aspx>



Informata të përgjithshme

Dita e komunës

24 Qershori
Dita e Çlirimit

Popullsia

6,729

Shqiptarë	3,524
Serb	3,122
Rom	63
Të tjerë	17

Grupmoshat

GM: 0-18 (19)	2238
GM: 20-64	3759

Sipërfaqja 204 km²

Vendbanime	26
Zona Urbane	1

Përshkrimi i komunës

Duke u bazuar në burime të shumta historike, territori i komunës së Novobërdës ka qenë një trevë e populluar qysh në zhvillimet e hershme të njerëzimit. Në mesjetë, Novobërda u bë qendër e rëndësishme posaçërisht kur gërmimi i mineraleve u zhvillua shpejt. Në shekullin e XV Novobërda kishte 45,000 banorë, kur kulminacionin e zhvillimit ekonomik dhe politik e arrin me zhvillimin e minierës së Novobërdës, e cila ishte shumë e pasur me minerale të arit, argjendit, plumbit dhe zinkut. Sipas të dhënave historike të vitit 1450, miniera e Novobërdës prodhonte afër 6000 kg argjend në vit. Krahës kësaj, komuniteti ishte i njohur për prodhimin e monedhave të arit dhe argjendit. Në atë kohë Novobërda kishte edhe fabrikën e vet të monedhave dhe të stolive nga ari dhe argjendi. Këto periudha të ekzistencës së qytetit kanë lënë gjurmë të shumta arkeologjike.

Profil



Komuna e Novobërdës gjendet në pjesën lindore të Kosovës, në regjionin e Anamoravës, ka pozitë të volitshme gjeografike me qasje në të gjitha qytetet tjera dhe regjionin përreth Kosovës. Komuna e Novobërdës kufizohet me komunën e Gjilanit, Lipjanit, Kamenicës dhe Prishtinës. Territori i komunës së Novobërdës karakterizohet me një reliev kodrinor-malor. Lartësia varion nga 680 metra e deri në 1,260 metra në majën më të lartë të "Malit të Madh". Me fjalë tjera, dallimi në lartësi është 600 metra. Pjesa më e madhe e relievit përbëhet nga kodra të shumta të cilat shtrihen përgjatë një varg platosh. Novobërda është komunë me popullatë të përzier Shqiptare, Serbe, Turke dhe Rome.

Planet dhe Strategjitë Komunale:

1. Strategjia Zhvillimore Lokale e komunës së Novobërdës;
2. Plani zhvillimore komunal;
3. Plani Zhvillimor Urban fshatit të BOSTANIT (2012–2017).



Degët kryesore të ekonomisë lokale

Në komunën Novobërdës bujqësia dhe blegtoria janë të një rëndësie të veçantë për zhvillim ekonomik. Vlerësohet se bujqësia përfaqëson 80% të bazës ekonomike të komunës. Po ashtu komuna ka edhe degë tjera që ndihmojnë zhvillimin ekonomik lokal si: industrinë, tregtinë, zejtarinë dhe turizmin.

Transporti

Novobërda gjendet afër rrugëve kryesore Prishtinë – Gjilan dhe Prishtinë–Kamenicë. Në territorin e komunës së Novobërdës, nuk ekziston transport hekurudhor. Stacioni më i afërt hekurudhor, është stacioni në Fushe Kosovë.





Prona komunale

Sipërfaqet e tokës komunale në komunën e Novobërdës janë 369,060,069 m² kryesisht janë pyje dhe kullota të cila ipen në shfrytëzim në bazë të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të patundshmërisë si dhe në pajtim me vendimet e Kuvendit sipas procedurës së zbatuar.

INDEKSI I KOMUNËS

Shërbimi i Zjarrëfikësve

Udhëheqës: Ivan Ristić

E-mail: ivan82ristic@gmail.com

Tel: 038/576-035

Posta Novobërde

Drejtori: Seljatin Nuhiu

selatinnuhiu@hotmail.com

Tel: 038-576-000

Policia

Udhëheqës: Shukri Aliu

Tel: 038/576-091; 038/576-092

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

Drejtori: Xhemajl Novoberdalio

Tel: 038/576-038; 038/576-037

xhemajlnovoberdalio@gmail.com



Shëndetësia

Komuna e Novobërdës ka 1 Qendër Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe 11 ambulanca për trajtimin ambulator të pacientëve. Shtëpia e shëndetit gjendet në qytezën e Novobërdës.

Buxheti

Buxheti vjetor

Të hyrat vetanake

Buxheti i realizuar 2014	2,071,067.3	185,328
Buxheti aktual 2015	2,012,379.0	204,672
Buxheti i Projektuar 2016	1,973,476	190,000
Buxheti i Projektuar 2017	1,997,351	200,000
Buxheti i Parashikuar 2018	2,023,861	210,000

Struktura organizative

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

Kryetari i Komunës

Kontakti: + 381 38 576 009

Nënkryetari

DREJTORITË KOMUNALE

1. Drejtoria e Administratës
2. Drejtoria për Financa dhe Buxhetit
3. Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Turizmit Rural
4. Drejtoria e Arsimit, Kulturë, Rini dhe Sport
5. Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje

të Mjedisit

6. Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim
7. Drejtoria e Inspeksionit
8. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit

Shërbimi i Kuvendit

Anëtarët e Kuvendit: 15 anëtarë



SEKTORËT DHE NJËSITË

Zyra për informim

Udhëheqës: Siniša Marković

Tel: 045/379-631

E-mail: sinisa.markovic@rks-gov.net;

Zyra Komunale për Kthim dhe Komunitete

Udhëheqës: Jasmina Deniq

Tel: 038/20047808

E-mail: jasminadenicokpz@gmail.com

Zyra e personelit

Udhëheqës: Sylejman Avdyli

E-mail: Sylejman.Avdyli@rks-gov.net

Tel: 044/279170

Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi

Koordinatori: Siniša Dimić

E-mail: sinisa_976@hotmail.com

Tel: 038 576 011

Shënime me rëndësi

Arsim

Procesi edukativo-arsimor në komunën e Novobërdës, zhvillohet në këto nivele: prej atij parafillor e deri te ai i mesëm në gjuhën shqipe dhe serbe. Në tri shkolla fillore me nga dy klas mësojnë fëmijë të komunitetit Serb dhe Rome. Shkolla në Prekocv ka një klasë për fëmijët para-shkollorë.

Kulturë

Sa i përket aktiviteteve sportive në komunën e Novobërdës, ekziston vetëm një klub sportiv në Futsall. Ndërkaq, manifestimet sportive organizohen në shkolla në orët e edukatës fizike dhe manifestime tjera si, organizimi i turnirëve të ndryshme sportiv në baza vullnetare nga të rinjtë. Aktivitetet kulturore në këtë komunë kryesisht organizohen përmes Drejtorisë për Arsim, Kulturë dhe Sport në kuadër të komunës së Novobërdës. Në këtë komunë ekzistojnë këto institucione kulturore: Një Shtëpi e kulturës me një paralele të ndarë, tri Biblioteka dhe një Shoqëri Kulturore Artistike "Artana".



Turizmi

Vende interesante për t'u vizituar në komunën e Novobërdës janë: Fortifikata "Kalaja"; Katedralja; Kisha e Shën Mërisë - Kisha e Sasëve; Kisha e Shën Jovanit; Xhamia - e cila ende është funksionale; Artefaktet arkeologjike; Tyrbja në pjesën e Nënklasë; Varrezat e Turqve në Novobërdë; Burimi në fshatin Vllasali; Kisha Ortodokse në fshatin Bostan e cila daton që nga shekulli XVIII; Varrezat në fshatin Boljevc; Lokaliteti Gumnishte; Burimi (rrjedha) e manastirit në Kllokoq; Tyrbja në Buqe, Lokaliteti "Rrethi i Nikshës.





Komuna e Obiliqit





Komuna e Obiliqit



Obiliq


<http://kk.rks-gov.net/obiliq/Home.aspx>

 038-561-536/
038/200-41-336

<http://kk.rks-gov.net/obiliq/Forums.aspx>


Informata të përgjithshme

Dita e komunës

 14 Qershori
Dita e Çlirimit

Popullsia

21,549

Shqiptarë	19,854
Serb	276
RAE	1,266
Të tjerë	141

Grupmoshat

GM: 0-18 (19)	8,417
GM: 20-64	24,564.46

Sipërfaqja

105 km²

Vendbanime	20
Zona Urbane	1

Përshkrimi i komunës

Komuna e Obiliqit ka një territor të veçantë, që nga koha e sundimit turk. Nga viti 1873 njihet si qendër gjeostrategjike e Rrafshit të Kosovës. Më parë Obiliqi quhej Globoder, ndërsa në vitin 1912 emërohet Obiliq. Statusin e komunës e ka që pas Luftës së Parë dhe Luftës së Dytë Botërore, deri në vitin 1962, kur përfshihet në kuadër të komunës së Prishtinës. Më 27 nëntor 1989 prapë konstituohet si Komunë. Më datë 20.12.1999, me vendim të Këshillit Komunal, është formuar Komisioni për Emërtimin e Vendbanimeve, me të cilin vendim qyteti i Obiliqit emërohet në Kastriot. Komuna aktualisht udhëhiqet nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

Profili



Komuna e Obiliqit shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, më një pozitë të mirë gjeografike, e cila kufizohet me komunën e Prishtinës, Fushë Kosovës, Drenasit, Vushtrrisë dhe Podujevës. Ka lidhje hekurudhore të rëndësishme me Mitrovicën. Sipërfaqen e komunës së Obiliqit e përbën një reliev i ndryshëm me teren malor, sipërfaqe fushore dhe të rrafshët me tokë pjellore. Pjesa qendrore shtrihet rreth lumit Sitnica, ndërsa pjesët tjera të relievit në lindje shkojnë duke u ngritur në kodra e lugina të malit Qyqavica dhe në perëndim po ashtu në kodra e lugina (male të degëve të maleve të Albanikut (Kopaonikut). Rrjedh se 75% e sipërfaqes së komunës është sipërfaqe e rrafshët dhe kodrinore, ndërsa diku rreth 25% janë terrene malore. Pika më e lartë e territorit të komunës është në fshatin Kozaricë me 740 m lartësi mbidetare, kurse pika më e ulët është tek ura në mes të fshatit Palaj dhe qytetit të Obiliqit me 530 m lartësi mbidetare. Zonat e mbrojtura në komunën e Obiliqit janë: Monumenti memorial i Gazimestanit dhe Tyrbja e Bajraktarëve.

Planet dhe Strategjitë Komunale:

1. Plan i Zhvillimor Urban 2009-2020;
2. Plan i zhvillimor komunale 2009-2020;



Degët kryesore të ekonomisë lokale

Komuna e Obiliqit është një ndër qendrat më të mëdha industriale në tërë Kosovën, duke ju falënderuar rezervave të mëdha të thëngjillit dhe objekteve të KEK-ut, termocentralet Kosova A dhe Kosova B, objekte shumë të rëndësishme industriale për energjetikën e tërë Kosovës. Kurse sa i përket biznesit privat kryesisht zhvillohet në formë të dyqaneve të vogla tregtare dhe zejtare.





Prona komunale

Sipërfaqet e tokës komunale në komunën e Novobërdës janë 369,060,069 m² kryesisht janë pyje dhe kullota të cilat ipen në shfrytëzim në bazë të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të patundshmërisë si dhe në pajtim me vendimet e Kuvendit sipas procedurës së zbatuar.

INDEKSI I KOMUNËS

Shërbimi i Zjarrëfikësve

Lloji i shërbimit: Është njësie e vetme e zjarrfikësve dhe ndërhyrjes emergjente në komunë.

Njësia e Zjarrëfikësve - KEK

Udhëheqës: Muhamet Maxhuni

Tel: 038-561-596 , 045/891-763

Ndërmarrja Publike

Ujësjiellësi Rajonal "Prishtina" në Obiliq

Drejtor: Fidaïm Jashari

Tel: 038-560-013/ 044/453-335

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

Tel: 038-562-533

Kompania "Pastrimi"

Drejtori: Labinot Mirena

Tel: 049/831-147

Posta Obiliq

Tel: 038-561-111; 038-561-602

Stacioni Policor

Komandanti i Stacionit: Bashkim Bytyqi

Tel: 038-560-700 , 044/303-103

Buxheti

Buxheti vjetor

Të hyrat vetanake

Buxheti i realizuar 2014	4,567,669.3	735,000.0
Buxheti aktual 2015	5,046,183.0	811,716.0
Buxheti i Projektuar 2016	5,226,546	900,000
Buxheti i Projektuar 2017	5,277,022	920,000
Buxheti i Parashikuar 2018	5,343,287	950,000

Struktura organizative

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

Kryetari i Komunës

Tel: 038/561322;
038/200-41336

Nënkryetari

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit

Anëtarët e Kuvendit: 21 anëtarë

DREJTORITË KOMUNALE

1. Drejtoria e Administratës
2. Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit
3. Drejtoria për Inspektionin
4. Drejtoria e Arsimit

5. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
6. Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit
7. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave
8. Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Pronë
9. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

SEKTORËT DHE NJËSITË

Sektori Emergjencave

Udhëheqës: /Zyrtar Valon Berisha
Tel: 112; 049/831-204

Zyra lokale e komuniteteve

Udhëheqës: Slavisa Adjançiq
Tel: 049-831-230

Zyra e personelit

Udhëheqës: Antigona Morina
Tel: 049/831-034
Email: Antigona.Morina@rks-gov.net

Zyra për informim

Udhëheqës: Adem Haliti
Tel: 038-561-536
Email: adem.haliti@rks-gov.net

Zyra Ligjore

Udhëheqës: Drita Hashani
Tel: 049-831-249
Email: Drita.Hashani@rks-gov.net



Qendra Komonale për Regji Automjeteve

Udhëheqës: Avdyll Berbatovci
Tel: 038-560-506

Zyra Komonale për Punësim

Tel: 038-560-184

Qendra Komonale për Regjistrim Civil

Udhëheqës: Agron Mjekiqi
Email: agron.mjekiqi@rks-gov.net
Tel: 038-562-077

Qendra për Punë Sociale Obiliq

Udhëheqës: Haki Mjeku
Tel: 038-560-077, 049/831-215

Komiteti Lokal për Siguri Publike

Kordinator: Burim Gërguri
Email: Burim.Gerguri@rks-gov.net

Shënime me rëndësi



Arsim

Sistemi i edukimit në komunën e Obiliqit është i organizuar në tri nivele: edukimi parafillor, fillor dhe i mesëm. Në komunën e Obiliqit funksionojnë gjashtë shkolla fillore në gjuhën shqipe me nëntë paralele, katër shkolla fillore në gjuhën serbe dhe dy shkolla të mesme shqipe dhe një serbe.

Kulturë

Aktivitetet kulturore në komunën e Obiliqit zhvillohen në bashkëpunim me Shtëpinë e Kulturës në Obiliq dhe me Ansamblin e Këngëve dhe Valleve "Rinia", Teatrin e Qytetit të Obiliqit (amator), Klubin Letrar "Fahri Fazliu", Klubin Figurativ "Kolë Idromeno" dhe pesë grupet dramatike.

Sa i përket aktiviteteve sportive në komunën e Obiliqit, në sistem garash veprojnë këto klube: Klubi i futbollit KEK-u, Klubi i futbollit "Bakshia", Klubi i hendbollit KEK-u femrat, Klubi i hendbollit

KEK-u meshkujt, Klubi i atletikës KEK-u, Klubi i shenjtariisë "Katana", Klubi i kikkoksit "Katana", Klubi i skitarisë "Nici".

Punësimi

Në Komunën e Obiliqit në sektorin publik janë rreth 633 të punësuar, në administratë janë 128 të punësuar, në arsim janë 404 të punësuar ndërsa në shëndetësi janë 101 të punësuar.

Shëndetësia

Bartëse kryesore të kujdesit primar shëndetësor në komunën e Obiliqit është Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në qytet me popullsi prej 5000 banorë. Po ashtu komuna e Obiliqit ka dhe 5 qendra të mjekësisë familjare në vendbanime më të mëdha me mbi 2000 banorë, si në Milloshevë, Plemetin, Breznicë, Palaj dhe Siboc dhe dy ambulanca shëndetësore në Shipitullë dhe Babimoc.

...

Transport

Transporti Publik në territorin e Komunës së Obiliqit është i organizuar në dy nivele atë urban, urban periferike dhe lokal.



Turizmi

Vende interesante për t'u vizituar në komunën e Obiliqit janë: Tyrbja e Sulltan Muratit II në Mazgit, Tyrbja e Gazi Pashës, po ashtu në Mazgit të Epërm. Si pasuri tjetër turistike të komunës sonë janë edhe disa druajtë shumë të vjetër disa qindra vjeçar si druri në oborrin e Tyrbes në Mazgit i cili është diku rreth 300 vjeçar; "Guri i Plakës"- Graboc i Epërm; Mulliri i vjetër dhe Mulliri i Behramajve në Graboc të epërm, etj.



Komuna e Rahovecit





Komuna e Rahovecit



Rr. "Xhelal Hajda – Toni", p.n.



<http://kk.rks-gov.net/rahovec>



029/276-037;
029/276-039;
029/276-943



Komuna.Rahovec@rks-gov.net

Misioni i Komunës së Rahovecit, është të krijoj qeverisje lokale efikase, të qëndrueshme dhe demokratike përmes të cilave, do të arrijë një performancë të kualitetit të lartë në shërbimin e nevojave të banorëve të saj. Gjithashtu, mision i komunës është të rregulloj dhe të udhëheq çështjet publike në territorin brenda kufijve të përcaktuar me ligj, për të siguruar kushte për jetë normale dhe të qetë për të gjithë banorët e saj.



Informata të përgjithshme

Dita e komunës

14 Qershori
Dita e Çlirimit

Popullsia

56,208

Shqiptarë
Serb
RAE
Të tjerë

55,166
800
787
38

Grupmoshat

GM: 0-18 (19)
GM: 20-64

22,334
30,522

Sipërfaqja

278 km²

Vendbanime
Zona Urbane

36
1

Përshkrimi i komunës

Rahoveci bënë pjesë në grupin e qyteteve të lashta të Kosovës. Territori i komunës së Rahovecit përfshihet në regjionin e Prizrenit dhe ka një pozitë të mirë gjeografike. Shtrihet në pjesën qendrore të gadishullit Ballkanik dhe i takon Evropës juglindore. Gjatë shekullit XIX me themelimin e Vilajetit të Kosovës, Prizreni ka ngelur si qendër Sanxhaku i cili ka përfshirë pesë kaza, respektivisht rrethe: Prizrenin, Rahovecin, Tetovën, Gostivarin dhe Lumën (M. Kaleshi). Me themelimin e Vilajetit të Kosovës me seli në Shkup duke filluar që nga viti 1888 Prizreni bëhet përsëri njeri nga gjashtë Sanxhaqet e Vilajetit të Kosovës në përbërjen e të cilit krijohen pesë kaza : Prizreni, Rahoveci, Tetova, Gostivari dhe Luma. Rahoveci bëhet si qendër Administrative e Anadrinisë

Profil



Shtrihet në pjesën qendrore të gadishullit Ballkanik dhe i takon Evropës juglindore. Ky territor përfshin pjesën qendrore dhe jugore të rrafshit të Dukagjinit dhe është i ndarë në tri tërësi ose mikro regjione. E këto janë: rrafshi-luginor, kodrinor dhe malor. Në Veri kufizohet me Komunën e Klinës me distance rreth 45 km, në Verilindje me Komunën e Malishevës rreth 16 km, në Juglindje me komunën e Suharekës rreth 17 km dhe atë të Mamushës, në jug me Komunën e Prizrenit 25 km, dhe në perëndim me komunën e Gjakovës 28 km dhe në largësi nga kryeqendra e Kosovës (Prishtina) rreth 60 km. Në Komunën e Rahovecit temperaturat mesatare vjetore janë 11,680C. Mesatarja e reshjeve është 707.7mm. Të reshurat e dëborës janë më të mëdha në Rahovec dhe atë në muajin Janar. Ditë me borë në Rahovec janë mesatarisht 15,7ditë. Rahoveci ka mesataren vjetore me mjegull prej 19. 7 ditë apo 5,4 %. Në këtë komunë janë dy zona që kanë karakter të veçantë të mbrojtjes : 1.Manastiri i Zoqishtës, dhe 2.Fshati Hoqë e Madhe.

Planet dhe Strategjitë Komunale:

1. Plani zhvillimor komunal;
2. Plani rregullativ i Komunës;
3. Planet urbane Komunale;
4. Strategjitë e zhvillimit ekonomik lokal



Degët kryesore të ekonomisë lokale

Komuna e Rahovecit me tërë historinë e pasur në prodhim të verës dhe token pjellore ka potenciale të mëdha për zhvillime në të ardhmen. Zhvillimi ekonomik në komunën e Rahovecit është orientuar me së shumti në bujqësi, vreshtari dhe perime kulturë. Afro 65% e popullatës është vlerësuar se sigurojnë ekzistencën nga aktivitetet bujqësore. Mesatarja vjetore e të ardhurave për një fermer është përafërsisht 2,500 deri 3,000 €. Komuna e Rahovecit disponon me rreth 50 % të sipërfaqeve të vreshtave të Kosovës si dhe kapaciteteve përpunuese.





PUNËSIMI

Në komunën e Rahovecit, sa i përket të punësuarave në sektorin publik janë 1.263 ndërsa në sektorin privat në komunën e Rahovecit janë të punësuar 3500 punëtorë.

SEKTORËT DHE NJËSITË

Zyra për komunitete dhe kthim
U.D Jovan Bojic

INDEKSI I KOMUNËS

Shërbimi i Zjarrfikësve

Samir Boshnjaku
(Shef i Zjarrfikësve)
Tel. 029/277-555
029/277-555 (Kujdestaria)
045/884550

Ndërmarrja Publike e Ujit K.R.U.

"Radoniqi" NJO Rahovec
Udhëheqës Ali Haxhimustafa
Tel: 049/732789

N.P.L. Stacioni Autobusave

Udhëheqës: Ibrahim Qmega

Ndërmarrja Publike e

Mbeturina

Eko. "Regjioni" NJO Rahovec
Udhëheqës Gani Raba
Tel: 049/246248

QKMF- Ambulanca

Tel. 029/276-122

Policia

Tel. 029/277-913

Drejtoria për Inspektim

Tel. 044129784

Buxheti

Buxheti vjetor

Të hyrat vetanake

Buxheti i realizuar 2014	9,774,525	950,000
Buxheti aktual 2015	11,454,255	1,099,014
Buxheti i Projektuar 2016	11,362,254	1,158,014
Buxheti i Projektuar 2017	11,488,388	1,207,014
Buxheti i Parashikuar 2018	11,628,657	1,255,500

Struktura organizative

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

Kryetari i Komunës

Kontakti: 029 / 276 037

Nënkryetari

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit
Tel: 029 276 037

Shërbimi i Kuvendit

Anëtarët e Kuvendit: 31 anëtarë

DREJTORITË KOMUNALE



1. Drejtoria për Administratë të Përgjithshme
2. Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
3. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim
4. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
5. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
6. Drejtorisë për Punë Inspektuese

7. Drejtoria për Arsim
8. Drejtoria për Financa dhe Buxhet
9. Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
10. Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit
11. Drejtoria për Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër
12. Drejtoria për Shërbime Publike Komunale

Shënime me rëndësi



Arsim

Struktura organizative e sistemit arsimor në komunën e Rahovecit është e organizuar në katër nivele: arsimin parashkollor (fëmijët e moshës 5 - 6 vjeçar), arsimin fillor (klasat I – V), arsimin e mesëm të ulët (klasat VI – IX) dhe arsimin e mesëm të lartë (klasat X – XII/XIII).

Numri i objekteve shkollore gjithsejtë është 42, duke përfshirë edhe çerdhet dhe shkollat e mesme. Në procesin edukativo-arsimor në të gjitha nivelet e shkollimit janë të angazhuar rreth 845 punëtorë, prej të cilëve janë 694 mësime dhënë. Numri i nxënësve është gjithsej 14526, që do të thotë se kemi një raport prej 17.06 nxënës /mësime dhënë.

Shëndetësia

Në komunën e Rahovecit shëndetësia është e organizuar në sektorin publik, ku ofrohen shërbime të nivelit parësor, dhe në sektorin privat i cili ofron shërbime parësore të lemave të specializuara mjekësore. Institucionet shëndetësore publike në komunën e Rahovecit janë:

- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (1-QKMF në qytetin e Rahovecit)
- Qendrat e Mjekësisë Familjare (6-QMF) , - Ambulancat e Mjekësisë Familjare (7-AMF)



Prona Komunale

Komuna e lka 1540 parcela (pronë komunale), në sipërfaqe prej 56,819,776 m2.



Kultura

Në Komunën e Rahovecit zhvillohen aktivitete të ndryshme kulturore : Muzikore, Teatrale, Bibliotekare, Ekspozitat e ndryshme, etj. Këto aktivitete zhvillohen në Qendrën Kulturore në Rahovec, Shtëpia e Kulturës në Krushë të Madhe, Shtëpia e Kulturës në Hoçë të Madhe, shtëpinë e kulturës në Ratkoc si dhe në Qendrën Rinore në Rahovec. Aktivitetet kulturore organizohen kryesisht nga drejtoria komunale në bashkëpunim me shoqatat dhe klubet kulturore si "Art-Studio", "Nirvana-Club", Shoqatën e Artistëve të Komunës së Rahovecit, Shoqatën e Enigmatëve Labirinti, Shoqëritë Kulturo Artistike: "Rahoveci", "Bajram Curri", "Heronjëti e Kosovës", "Anadrinia", "Vëllezërit Frashëri", dhe grupet muzikore "Boemat", "Sokolat" etj. Komuna e Rahovecit disponon Galerinë e arteve që i ka kushtet shumë të mira për ekspozim. Gjatë një viti në të ekspozohen minimumi 12 ekspozita; Teatrin, që funksionon në baza amatore dhe vullnetare; Sallën e kinemasë në shtëpinë e Kulturës me 430 ulëse. Biblioteka në Rahovec, me rreth 9000 libra ekzemplarë.

...

Sporti

Në komunën e Rahovecit veprojnë tre ekipe futbolistike, njëri bën pjesë në ligën e parë të Kosovës ndërsa dy të tjera në ligët e dyta, dy shkolla të futbollit, ekipi i basketbollit në të dy gjinjtë po ashtu edhe shkolla e basketbollit, klubi i hendbollit, i shahut si dhe ekipi i garave automobilistike.



Turizmi

Turizmi kulturor kryesisht mund të jetë i bazuar në trashëgimi kulturore/arkitekture: shtëpitë tradicionale, turizëm kulturor arkeologjik, shpella, hamame, trashëgimi arkitekture dhe fetare në Hoçën e Madhe. Në qendër të qytetit janë të vendosura monumentet historike të ndërtuara mbi 400 vite: Teqja e

Madhe –Helvetive, Teqja Rufai; TeqjaMelami; Sahat Kulla e ngritur në vitin 1791; pesë xhamitë si dhe teqet tjera si në qytet ashtu edhe në rrethinë. Në fshatin Hoça e Madhe, në jug të qytetit të Rahovecit, të njohur për vreshtat dhe verërat e saj, objektet e trashëgimisë kulturore dhe fetare. Në vitin 1198 Duka i madh StevanNemanja dhuroi prodhimet e regjionit, manastirit të Hilandarit (Mt.


Zyrtari: Lulzim Fazliu
Telefoni: 028 582 630
Email: lulzim.fazliu@rks-gov.net

Kompleksi Memorial "Adem Jashari

Zyrtari: Rifat Bejta
Telefoni: 028 582 206

Zyra Komunale e Punësimit

Zyrtari: Dibran Jashari
Telefoni: 028 582 210
Email: dibran.jashari@rks-gov.net

Qendra Komunale e Regjistrimit Civil

Zyrtari: Bekim Hajra
Telefoni: 028 582 779
Email: bekim.hajra@rks-gov.net

Këshilli Komunal për siguri në Bashkësi

Kordinator: Shemsi Maksuti
Kontakt: 049 214 876
Email: Shemsi.maksuti@rks-gov.net

Shënime me rëndësi



Arsim

Organizimi i arsimit në komunën e Skenderajt realizohet në tri nivele: Edukimi Parashkollor/parafillor, Arsimi Fillor dhe i Mesëm i Ulët, si dhe i Mesëm i Lartë. Në komunë gjenden 2 shkolla të mesme, 29 Shkolla fillore dhe 1 çerdhe. Arsimi para- fillor organizohet në paralele parafillor (fëmijët e moshës 5-6 vjeç) në kuadër të objekteve të shkollave fillore. Arsimi fillor dhe

i mesëm i ulët paraqet arsimin e obliguar 9 vjeçar dhe përfshin nivelet 1 shkolla fillore (klasat 1 - 5) dhe nivelin 2, shkolla e mesme e ulët (klasat 6 – 9) duke i përfshirë grup-moshat 6 deri në 15 vjeç. Arsimi i Mesëm i lartë paraqet arsimin e obliguar 4 vjeçar dhe përfshinë shkollat e mesme nga 10 - 13 për grup moshat 15 - 18.

Kulturë

Në kuadër të Komunës së Skenderajt janë Biblioteka komunale dhe bibliotekat e lokaliteteve fshatare. Aktualisht në komunën e Skenderajt funksionojnë: Ansambli i Qytetit i Këngëve dhe Valleve, Teatri i Qytetit, Klubi Letrar, Shoqata e Artistëve Figurativë dhe Aplikativë, Shoqata e Muzikantëve, Kori i Qytetit, Teatri për Fëmijë dhe të Rinj dhe Klubi Letrar. Objektet e kulturës në Komunën e Skenderajt janë: Shtëpia e Kulturës në Skenderaj, Shtëpitë e kulturës nëpër fshatra dhe Muzeu i Qytetit. Komunën e Skenderajt e karakterizon edhe trashëgimia kulturore ku ekzistojnë dy vendbanime të lashta: në Tushillë dhe Syrganë. Në Tushillë është "Gjyteti" apo arkeologjia e një kalaje e cila sipas hulumtimeve të kryera vlerësohet të jetë më i vjetër se 3,000 vjet para Erës Sonë. Ky "Gjytet" siç e quan populli është i ngritur në një kodrinë mbi fshatin Tushillë. Gjithashtu, vendbanim i lashtë konsiderohet edhe



regjioni i Syrganës duke përfshirë fshatrat Bajë dhe Runikë. Këto vendbanime sipas hulumtimeve arkeologjike janë më të vjetra se 6,000 vjet dhe në to janë gjetur gurët e varrezave dhe veglat muzikore "Okarina"

Punësimi

Në komunën e Skenderajt numri i punëtorëve publik është afro 2.000 ndërsa numëri i puntorëve privat është mbi 5.000

Sporti dhe Rinia

Njëri ndër potencialet për zhvillim të Komunës së Skenderajt është edhe rinia, që përbën 60-70% të popullsisë në Skenderaj. Komuna ka arritur të ofroj një ambient të favorshëm për sa i përket arsimimit parauniversitar në komunën e tyre. Njëherë në vit organizohet manifestimi i vetëm Muaji i Rinisë me aktivitete të ndryshme kulturore i cili zgjatë një muaj dhe pjesa tjetër e vitit, për të rinjtë e Skenderajt është e përcjellur me aktivitete më të pakta. Në Komunën e Skenderajt zhvillohen shumë aktivitete sportive të nivelit komunal por edhe ndeshjet e ndryshme të niveleve të ndryshme të garave të Kosovës, e që janë ngjarje më vete. Ndër aktivitetet sportive tradicionale të cilat zhvillohen në Komunën e Skenderajt janë: Netët e Zjarrit të Komandant Adem Jasharit, turnir në futboll të vogël, krosi humanitar, turnirë etj.

...

Shëndetësia

Në QKMF (Qendra Klinike e Mjekësisë Familjare) në komunën e Skenderajt funksionojnë departamentet si në vijim: Mjekësia Familjare, Emergjencia, Laboratori, Stomatologjia, Farmacia, Shërbimi Teknik, Shërbimi Administrativ – Financiar dhe transportit të pacientëve. Po, ashtu funksionojnë edhe 5 Qendra të Mjekësisë Familjare në lokalitetet më të mëdha si dhe 14 Ambulanca të shpërndara nëpër lokalitete të ndryshme. Numri i punëtorëve aktualisht të punësuar në QKMF është 176. Në komunën e Skenderajt funksionon edhe Shtëpia për Integrim, që ofron shërbime të shëndetit mendor, shumë të kufizuara për shkak të mungesës së stafit. Këto shërbime janë kompetencë e nivelit qendror – pra Ministrisë së Shëndetësisë.



Turizmi

Komuna e Skenderajt njihet me vlera të turizmit historik dhe kulturor. Kompleksi i Jasharëve në Prekaz është potenciali kryesor i turizmit historik dhe vlerave të veçanta historike. Llojet e aktiviteteve turistike të cilat mund të zhvillohen në zonën malore janë të bazuara në natyrë si: turizmi shëndetësor, turizmi malor - ecja dhe shëtitja, kampimi, kalërimi, skijimi, turizmi fshatar - duke ofruar qëndrim të shkurtër nëpër oda, bujtina, mullinj me ujë, ferma etj.



Transporti

Ekziston vetëm një rrugë regjionale që e lidhë qytetin e Skenderajt me Mitrovicën dhe Drenasin. Rrugët tjera janë rrugë përmbledhëse dhe furnizuese, ndërsa ekzistojnë edhe mjaft rrugë lokale. Të gjitha rrugët kryesore janë të asfaltuara dhe janë të ndriçuara. Trotualet janë kryesisht të punuara me kupëza të betonit. Transporti publik rural në 48 fshatra, transporti publik ndërrurban: Skenderaj - Drenas, Skenderaj - Prishtinë, Skenderaj - Mitrovicë dhe Skenderaj-Klinë. Mbi 80% të rrugëve janë të asfaltuara.





Komuna e Shtimes





Komuna e Shtimes



Rr. "Tahir Sinani" Nr.50.



kk.rks-gov.net /shtime



0290/389-016



info.shtime@rks-gov.net

Misioni: Organet e Komunës së Shtimes kujdesen që qytetarët e saj t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë pa dallim race, etnie, ngjyre, gjinie, gjuhe, religjioni, mendimi politik apo mendimi tjetër, prejardhje kombëtare apo sociale, pa dallim prone, lindje apo ndonjë statusi tjetër me qëllim që ata të gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në shërbimet komunale të të gjitha niveleve



Informata të përgjithshme

Dita e komunës

12 Qershori
Dita e Çlirimit

Popullsia

27,324

Shqiptarë	26,447
Serb	49
Ashkali	750
Të tjerë	59

Grupmoshat

GM: 0-18 (19)	11,552
GM: 18-65	14,174

Sipërfaqja

134 km²

Vendbanime	23
Zona Urbane	1

Përshkrimi i komunës

Komuna e Shtimes është e banuar që nga periudhat më të hershme historike. Treva e Shtimes, sikurse edhe pjesët tjera të Kosovës, banohej nga fisi ilir, dardanët. Vlen të përmendet Kështjella mesjetare e Topillës, e cila gjendet në një ngushticë 10 km në jug të Shtimes, e cila shtrihet nëpër luginën e Topillës. Kështjella në fjalë, gjendet mbi një shkëmb në të djathtë matanë rrugës dhe populli e quan "Guri i Shtrenjtë". Asokohe kjo kështjellë siguronte rrugën dhe shërbente për mbrojtjen e pjesës perëndimore të Fushës së Kosovës dhe të qytetit të Shtimes. Komuna e Shtimes i kishte dhe i ka këto të mira natyrore: lumin Shtimjanja në mes, malet dhe tokën pjellore. Prej kohësh, si pamë kishte edhe rrugën që lidhte Perëndimin me Lindjen dhe anasjelltas. Të gjitha këto bënë që ky vendbanim të ekzistojë që nga kohët më të vjetra. Komuna e Shtimes u çlirua më 12 qershor të vitit 1999.



Profili

Komuna e Shtimes gjendet në skajin perëndimor të Rrafshit të Kosovës dhe përfshin pjesën ndërmjet rrafshit të Kosovës dhe hapësirës malore të Carralevës, që shtrihet deri në Drenicë dhe bashkë me malet e Jezercit dhe të Nerodimes e ndajnë Rrafshin e Kosovës nga Rrafshi i Dukagjinit. Komuna e Shtimes kufizohet në juglindje me komunën e Ferizajt, kurse në verilindje me komunën e Lipjanit dhe në perëndim me komunën e Suharekës (Therandës). Në komunën e Shtimes 13 vendbanime shtrihen në pjesën kodrinore-malore, ndërsa 9 prej tyre në pjesën rrafshinore. Qyteti i Shtimes është 31 km larg nga kryeqyteti i Kosovës (Prishtina). Komuna e Shtimes ka pozitë të përshtatshme gjeografike, ngase gjendet pikërisht në kryqëzimin e rrugëve të rëndësishme dhe efektive në relacionin Prizren – Prishtinë dhe Prizren – Shkup.

- Plan i Afatmesëm Zhvillimor;
- Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2014-2018;
- Plan i Lokal i Veprimit për Zona Rurale;
- Planin Zhvillimor Komunal 2009-2020;
- Planin Zhvillimor Urban 2009-2020;
- Planin Rregullues Urban;
- Strategjia e Zhvillimit të Turizmit Rural në Komunën e Shtimes 2015 – 2019;
- Strategjia Komunale për Kthim;
- Plan i Komunal për Eficiencë të Energjisë 2015 – 2020;

- Plan i Strategjik për Zhvillimin e Arsimit Para universitar 2014 – 2018 në Komunën e Shtimes;
- Plan i veprimit për shfrytëzimin e masës gurore në komunën e Shtimes;
- Plan i Veprimit Rinor Lokal 2011 – 2013;
- Plan i Komunal i Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Ashkali dhe Romë 2013 – 2015;
- Plan i Lokal i Veprimit për Riintegrim;
- Plan i Veprimit për Transparencë në Komunën e Shtimes



Degët kryesore të ekonomisë lokale

Komuna e Shtimes e ka në traditën e saj marrjen me bujqësi, veçanërisht kultivimin e grurit, misrit dhe disa kulturave të pemëve frutore. Bujqësia është njëra nga shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik të komunës së Shtimes. Komuna e Shtimes njihet edhe për rezervat e mëdha të gurit gëlqeror, të cilat sipas matjeve të kryera në vargmalet nga Carraleva në Topillë, janë rreth 2 milionë metra kub rezerva të cilësisë së lartë, ndërkohë që ka pritshmëri edhe për rreth 9 milionë metra kub rezerva të tjera të po kësaj cilësie.





INDEKSI I KOMUNËS

**Njësia Profesionale për
Zjarrfikës dhe Shpëtim**

Përgjegjës: Bajram Gashi
Tel: 0290/389/092

NPRM "Pastërtia" – Shtime

Përgjegjës: Osman Muharremi
Tel: 044/205-838

Policia e Kosovës - Shtime

Udhëheqës: Enver Avdyli
Tel: 0290/389-008

Kompania Ujësjetllësi Rajonal

"Prishtina" – Shtime
Përgjegjës: Ali Ademaj
Tel: 044/201-926

QKMF "Dr. Vezir Bajrami"

Drejtor: Dr. Mirdita Qeriqi – Hajdari
Tel: 0290/389-007

**URGJENCA: 0290/390-
890 Instituti Special**

Drejtor: Xhemajl Dugolli
Tel: 0290/389-030

Qendra për Punë Sociale

Drejtor: Hasan Avdyli
Tel: 0290/389-031

**Qendra Integruese dhe
Rehabilituese e të Sëmurëve
Kronik-Psikiatrik – Shtime**

Drejtor: Dr. Miftar Zenelaj
Tel: 0290/389-034

Zyra e Punësimit – Shtime

Përgjegjës: Selvishahe Bajrami
Tel: 0290/389-040

Zyra Administrative Pensionale

Përgjegjës: Zymer Sahiti
Tel: 0290/390-173

**Qendra Komunale e
Regjistrimit të Automjeteve**

Përgjegjës: Nadim Gashi
Tel: 0290/390-287

**Qendra Komunale e
Regjistrimit Civil - Shtime**

Përgjegjës: Jahja Emini
Tel: 0290/390-317

Buxheti**Buxheti vjetor****Të hyrat vetanake**

Buxheti i realizuar 2014	5,360,257.0	409,500.0
Buxheti aktual 2015	5,871,655.0	445,503.0
Buxheti i Projektuar 2016	5,866,542.0	451,788.0
Buxheti i Projektuar 2017	5,911,745.0	459,224.0
Buxheti i Parashikuar 2018	5,957,960.0	460,500.0

Struktura organizative

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

Kryetari i Komunës

0290/389-009

Nënkryetari

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit

Shërbimi i Kuvendit

Anëtarët e Kuvendit: 21 anëtarë

DREJTORITË KOMUNALE

1. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
2. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik
3. Drejtoria e Arsimit
4. Drejtoria e Planifikimit Urban, Kadastrës dhe

- Gjeodezisë
5. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
6. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
7. Drejtoria e Shërbimeve Publike



SEKTORËT DHE NJËSITË

Sektori Emergjencave

Udhëheqës: Skender Dauti
Tel: 044/172-839

E-mail : skenderdauti@hotmail.com

**Zyra për Marëdhënie me
Publikun**

Udhëheqës: Lulzim Sahiti
Tel: 044/201-984

E-mail: lulzimsahiti@hotmail.com

Zyra e Auditorit të Brendshëm

Auditori: Fatmir Emini
Tel: 044/205-686

E-mail: fatmir_58@hotmail.com

Zyra e Personelit

Udhëheqës: Aziz Sylejmani
Tel: 044/981-387

E-mail: aziz_sylejmani@hotmail.com

Njësi për të Drejtat e Njeriut

Udhëheqës: Reshat Gashi
Tel: 044/149-646

E-mail: reshat.gashi@rks-gov.net

Stacioni i Policisë – Shtime

Udhëheqës: Enver Avdyli
Tel: 0290/389-008
044/308-975

E-mail: enver.avdyli@kosovopolic.com

Shënime me rëndësi



Arsim

Sistemi arsimor në komunën e Shtimes funksionon nga niveli parafillor deri në nivelin e mesëm të lartë. Në procesin e edukimit parashkollor janë gjithsej 39 fëmijë, të cilët kanë në dispozicion Institucionin Parashkollor "Albiona Asllani" në Shtime, ndërkaq arsimin parafillor e ndjekin 381 fëmijë në 18 paralele, kurse nga arsimit fillor deri në shkollimin e mesëm të

lartë, mësimet i ndjekin 5909 nxënës, të cilët kanë në dispozicion shtatë shkolla fillore dhe të mesme të ulëta me 10 paralele të ndara, një gjimnaz si dhe një shkollë të mesme profesionale. Komuna e Shtimes, krahas arsimit të rregullt ka në funksion edhe Shkollën Speciale "Shpresa", ku mësimet i vijnë 14 nxënës të moshave të ndryshme.

Kultura

Për zhvillimin e jetës kulturore komuna e Shtimes posedon Shtëpinë e Kulturës pastaj Muzeun Historik të Shtimes dhe Bibliotekën e Qytetit. Jetën muzikore, të cilën e g dallojnë në Shtime, do veçar Ansambli i Këngëve dhe Valleve "Dita" dhe herë pas here Shoqëria Kulturore – Artistike "Shkëndija". Në kuadër të trashëgimisë kulturore duhet përmendur edhe një varg objektsh tjera të rëndësishme kulturore, të cilat janë me rëndësi për t'u vizituar: Kulla e familjes Fejzullahu në Vojnovc (1906), Muzeu Historik i Shtimes, Xhamia e vjetër e Shtimes (1824), Rrënojat e kishës në Reçak (mesjetare), Shtëpia e Përshpirtshme (1923), Tyrbja e Shtimes, Xhamia e Carraleve (1895), Vojnovcit

(1913), Reçakut (1934) dhe Pjetërshiticës (1906). Mullinjtë me ujë në: Mollopoc, Carraleve dhe Llanishtë, Kompleksi Përkujtimor në Reçak, Varrezat e Dëshmorëve në Shtime dhe Mollopoc. Ndërkaq, në kuadër të trashëgimisë natyrore mund të vizitohen Shpella e Pjetërshiticës, Shpella e Imer Devetakut, Lisi i Alushit në Rashincë, Pishat e Shtimes e tjera.

Punësimi

Numri i të punësuarve në Komunën e Shtimes është rreth 2841 të punësuar, ku rol të rëndësishëm ka luajtur sektori privat me rreth 1902 të punësuar dhe sektori publik me 939 nëpunës.

Sporti dhe Rinia

Aktualisht kemi klubet sportive dhe shoqatat rekreative-sportive që janë shumë aktive siç janë: Klubi i Hendbollit "Vjosa" (M dhe F) në Ligën e Parë të Kosovës, Klubi i Futbollit "Vjosa" në Ligën e Dytë B të Kosovës, Klubi i Futbollit "Blindona", Klubi i Boksit "Vjosa", Klubi i Shahut "Shtimja", Shoqata e Peshkatarëve Sportivë-Rekreativë "Salmoni", Shoqata e Bjeshkatarëve Alpinist "Guri i Shtrenjtë" dhe Shoqata e Pedagogëve të Kulturës Fizike e Sportit Shkollor.

...



Shëndetësia

Shërbimi shëndetësor në komunën e Shtimes është i organizuar në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) "Dr. Vezir Bajrami", me seli në Shtime. Kjo qendër ka katër njësi organizative në terren, të cilat funksionojnë si Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe atë në fshatrat: Petrovë, Muzeqinë, Godanc dhe Pjetërshiticë.. Ndërkaq, mbrojtja shëndetësore sekondare, bëhet përmes poliklinikave specialiste të organizuara në sektorin privat, ku në komunën tonë funksionojnë 16 poliklinika specialiste nga të cilat: dy kirurgji, dy gjinekologji, dy pediatri, një neuropsikiatri, një internistik, një praktikë e përgjithshme, një fizioterapi dhe gjashtë stomatologji.



Turizmi

Pikat më të vizituara dhe turistike në komunën Shtime janë : Gryka e Carralevës, Mollopolcit dhe të Topillës, malet e Carralevës ku përfshihet Ranca , Topilla, Llanishti, Devetaku , shpella e Pjetërshticës është një tjetër xhevahir turistik i komunës së Shtimes, e cila ndodhet rreth 1 km, larg nga rruga regjionale Carralevë – Komoran, vend atraktiv për vizitorë është edhe Kodra e Shtimes .



Transporti

Transporti publik është i organizuar mjaftë mirë nëpërmjet autobusëve urban, ndërrurban (5 autobus), taxi-vetura (30 vetura) dhe automjete tjera të transportit. Shikuar nga numri i banorëve që kanë transport publik nga gjithsejtë 23 vendbanime sa ka komuna e Shtimes, 17 prej tyre kanë qasje në transport publik, përderisa vetëm 7 vendbanime nuk kanë qasje në transport publik, meqë fshatrat:

Dugë, Devetak dhe Topillë nuk kanë asnjë banorë, kurse fshatrat: Rancë, Llanishtë, Karaqicë janë të lidhur me rrugë të asfaltuara por numri i banorëve është i vogël. Komuna e Shtimes nuk posedon Stacion të Autobusëve, mirëpo janë 4 vendndalje për autobus në rrugën "Tahir Sinani", 2 vendndalje në rrugën "Komandant Kumanova" dhe 2 vendndalje në rrugën "Adem Jashari". Gjithashtu largësia e Aeroportit Ndërkombëtar "Adem Jashari" në Sllatinë është 29 km.



Komuna e Shtërpçës






Komuna e Shtërpcës



<http://kk.rks-gov.net/shterpce/>



Informata të përgjithshme

Popullsia

13,630

Serb
Shqiptarë
Romë

9100
4500
30

[Komuna Shtërpçë shtrihet në pjesën jug-lindore të Kosovës. Kjo Komunë zë një sipërfaqe prej rreth 247km², ku përfshin qytetin e Shtërpçës dhe 16 fshatra. Numri total i popullsisë është rreth 7,000.]



Ekonomia

Ekonomia e komunës së Shtërpçës mbështetet në bujqësi (kryesisht prodhimi i mjedrës), turizmi dhe biznese të vogla. Janë rreth 170 biznese të regjistruara private në këtë komunë.





Struktura organizative

DEPARTAMENTET

1. Buxhet dhe financa
2. Zhvillim Ekonomik
3. Gjeodezi, Kadastër and Pronë
4. Shërbime Publike dhe Emergjencia
5. Edukim, Sport and Kulturë
6. Administratë
7. Urbanizëm

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

**Kryetari i
Komunës**

Nënkryetari

**Nënkryetari për
komunitete**

KUVENDI I KOMUNËS

Kuvendi komunal ka 15 vende të shpërndara në mesin e 5 subjekteve politike; prej tyre 11 anëtarë janë serb dhe 4 janë shqiptarë. 5 anëtarë të Kuvendit janë femra. Kryetari i Kuvendit komunal është Predrag Grbić (FS).

Shëndetësia

Kujdesi shëndetësor primar tani për tani përfshin 1 qendër shëndetësore komunale në Shtërpcë dhe 7 shtëpi shëndeti në fshatrat serb dhe shqiptarë. Sektori i shëndetësisë ka 22 punonjës, 1) femër dhe 12 meshkuj, duke përfshirë mjekë, infermiere dhe anëtarë të personelit mbështetës që punojnë nën qeverisjen Kosovare. Rreth 200 punëtor të paguar nga Ministria e Shëndetësisë në Serbi punojnë në qendra shëndetësore komunale dhe shtëpi shëndeti që ndodhen në fshatrat e ndryshme të komunës së Shtërpcës. Serb të Kosovës dhe shqiptarë të Kosovës kanë qasje në kujdes shëndetësor dhe shërbimet shëndetësore pavarësisht sistemit nën të cilin veprojnë.

Spitali i ri në Shtërpcë i themeluar nga qeveria e Kosovës ka qenë i ndërtuar në 2012 (puna filloi në pranverë të viti 2010). Qeveria e Kosovës miratoi fondet për personelin, megjithatë, më shumë fonde janë të nevojshme për të pajisur spitalin (drejtoria komunale e shëndetit dhe mirëqenies sociale).

Infrastruktura

Statusi i përgjithshëm i infrastrukturës në komunën e Shtërpcës vlerësohet si i mirë. Me përkrahjen nga institucionet e nivelit qendror dhe partnerët ndërkombëtarë, qeverisja komunale ka punuar në përmisimin e

infrastrukturës (asfaltimi i rrugëve dhe trotualet, vendosja e sistemit të ujësjellës, ndriçimi i rrugëve, ndërtimi i kanaleve për ujitje, hapja e parkingjeve publike, ndërtimi i tregut të gjelbër, ndërtimi dhe rindërtimi i hapësirave publike që shfrytëzohen për lojëra). Të gjitha rrugët kryesore që

lidhin fshatrat e mëdha me qendrat urbane janë të asfaltuarat. Furnizimi me ujë dhe sistemi i kanalizimit janë të lidhura me shumicën e fshatrave. Prej Gushtit të vitit 2009 furnizimi me rrymë është përmirësuar, pasi që banorët filluan ti paguajnë faturat e rrymës.

Arsimi

Janë 6 shkolla fillore dhe 2 shkolla të mesme me 2,500

nxënës dhe 244 mësimdhënës. 3 shkolla fillore dhe 1 e mesme vijojë shkollimin sipas kurrikulave

serbe. Ndërsa, 3 shkolla fillore dhe 1 e mesme që vijojnë shkollimin sipas kurrikulës në gjuhën shqipe.

OBJEKTET FETARE DHE KULTURORE

Komuna e Shtërpcës ka 16 kisha ortodokse serbe dhe 5 xhamia, të gjitha në përdorim. Shumica e kishave janë rinovuar menjëherë pas luftës.





Komuna e Suharekës





Komuna e Suharekës



Rr. "Brigada 123", Suharekë



<http://kk.rks-gov.net/suhareke/>



029/271-282



komunaesuharekes@gmail.com

www.facebook.com/KomunaSuhareke

Misioni i Komunës së Suharekës është zhvillimi rural, përmirësimi i infrastrukturës, rritja dhe cilësia e prodhimeve bujqësore dhe zhvillimi i përgjithshëm ekonomik – lokal. Mjedisi në të ardhmen mendohet të jetë i pastër dhe të ketë menaxhim të qëndrueshëm të pasurive natyrore. Programet që sigurojnë prosperitet për rininë, do të zbatohen ndërsa vende të reja të punës do të krijohen duke siguruar të ardhura më të larta dhe kushte më të mira të jetesës.



Informata të përgjithshme

Dita e komunës

13 Qershori
Dita e Çlirimit

Popullsia

59,722

Shqiptarë
RAE
Të tjerë

59,076
539
58

Grupmoshat

GM: 0-18 (19)
GM: 18-65

23,875
31,743

Sipërfaqja

361 km²

Vendbanime
Zona Urbane

41
1

Përshkrimi i komunës

Suhareka filloi të fitojë elemente të një qyteze nga intervali kohor midis dy luftërave botërore, d.m.th. më 14 dhjetor 1928, kur zyrtarisht shpallet qytezë. Ajo ka qenë edhe në të kaluarën stacion i rëndësishëm në rrugën e vjetër Shkodër – Kosovë. Kështu që në sajë të kësaj, ka pasur edhe në të kaluarën funksion të qendrës ekonomike dhe administrative të Podgudit të Prizrenit. Është qendër e rëndësishme meqenëse gjendet në rrugën që lidhë Prishtinën, Prizrenin, Ferizajn dhe Rahovecin. Popullata kryesisht në fillim ishte e ndarë në lagje. Ndërsa, në vitet e fundit janë vendosur edhe shumë familje të fshatrave të ndryshme të kësaj komune, kështu që popullata tani është e përzier dhe e vendosur kryesisht në pjesët periferike. Komunën e Suharekës, aktualisht e udhëheq Lidhja Demokratike e Kosovës.

Profil



Komuna e Suharekës gjendet në pjesën jugore të Kosovës. Kufizohet me komunën e Prizrenit, Rahovecit, Malishevës, Lipjanit, Shtimes, Ferizajit dhe Shtërpçës. Komuna e Suharekës është e rrethuar me male të larta, në veri-perëndim me malet e Pagarushes dhe të Temeqinës. Nëpër territorin e kësaj komune, me një pozitë të mirë gjeografike, kalojnë rrugë shumë të rëndësishme që e lidhin kryeqendrën, Prishtinën, me qendrën regjionale Prizrenin dhe kalojnë më tej në Shqipëri. Vetë qyteti i Suharekës gjendet në lartësi mbidetare prej 400 m, me një klimë të përshtatshme kontinentale të butë, që ofron kushte të favorshme për zhvillimin ekonomik e social të komunës së Suharekës.



Planet dhe Strategjitë Komunale

1. Plan i zhvillimor komunal
2. Plan i rregullativ i komunës
3. Plan i urban komunal
4. Strategjia e zhvillimit ekonomik Lokal
5. Plan i veprimit për transparencën



Degët kryesore të ekonomisë lokale

Me gjithë faktin se komuna e Suharekës ka qenë e njohur si një komunë industriale në Kosovë, ajo në aspektin ekonomik ka një zhvillim mesatar. Të gjitha ndërmarrjet kanë qenë në pronësi shoqërore dhe i përkisnin industrisë kimike, ushqimore dhe asaj të tekstilit. Në komunë pjesa dërmuese ushtrojnë veprimtari tregtare, në industrinë përpunuese, në ndërtimtari, në transport, në komunikacion dhe në shërbime (hotele, restorante, etj). Përparësitë kryesore konkurruese të Suharekës janë: vreshtat dhe kapacitet e prodhimit të verës.



**Shërbimi i Zjarrfikësve****Udhëheqës:** Vehbi Krasniqi**Tel:** 029/271-119**Ndërmarrja Publike që funksionon në kuadër të Hidroregjionit Jugor në Prizren****Drejtori:** Ismet Kurtishaj**Tel:** + 381 029/271- 770**N.P.L Stacioni Autobusëve****Drejtor Ekzekutiv:** Halit Elshani**Tel:** 029/271-160**Ndërmarrja Publike e Mbeturinave N.P.SH.K "KOMUNALJA"****Drejtori:** Tahir Kolgeci**Tel:** + 381 029/271- 688**Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare****Drejtor:** Milit Elshani**Tel:** + 381 029/271- 031**Policia****Tel:** 029/271-024**Kryqi i kuq****Tel:** 029/271-273**KEK****Tel:** 029/271-083**Prona komunale**

Komuna e Suharekës, ka një sipërfaqe të pronës komunale prej 1009 Ha (hektarë) me 1.290 parcela, prej të cilave rreth 200 Ha (hektarë) janë të shfrytëzuara për dy Zona Industriale. Zona Industriale në Shirokë ka 162 hektarë dhe është mundësi e mirë për investime dhe zhvillim të ekonomisë. Është afër Autostradës së kombit Merdare – Morinë, përmes së cilës lidhet me portin e Durrësit. Kurse Zona tjetër Agrozona në Samadraxhë, jap mundësi të mira për zhvillimin e bujqësisë dhe prodhimeve bujqësore, si dhe mundësi e mirë për zhvillimin e tregtisë.

Buxheti**Buxheti vjetor****Të hyrat vetanake**

Buxheti i realizuar 2014	12,594,079.0	1,917,102.0
Buxheti aktual 2015	13,561,333.0	2,117,200.0
Buxheti i Projektuar 2016	13, 297,920.0	1,917,000.0
Buxheti i Projektuar 2017	13,413,002.0	1,967,500.0
Buxheti i Parashikuar 2018	13,578,767.0	2,017,000.0

Struktura organizative

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

Kryetari i Komunës

029 271 267

Nënkryetari

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit
381 029/271- 662

Shërbimi i Kuvendit

Anëtarët e Kuvendit: 31 anëtarë

DREJTORITË KOMUNALE

1. Drejtoria e Administratës
2. Drejtoria për Ekonomi dhe Financa
3. Drejtoria për Planifikim, Zhvillim, Bujqësi dhe Pylltari
4. Drejtoria për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë
5. Drejtoria për Arsime
6. Drejtoria e Inspeksionit
7. Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë
8. Drejtoria e Shërbimeve Pronësore-Juridike dhe Kadastër
9. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
10. Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis

SEKTORËT DHE NJËSITË

Zyra Ligjore**Udhëheqës:** Avni Bytyçi**Tel:** 044/ 259-450**E-mail:** avni.h.bytyçi@rks-gov.net**Zyra e Personelit****Udhëheqës:** Adem HOXHA**Tel:** 044/ 256-982**E-mail:** adem.hoxha@rks-gov.net**Zyra për marrëdhënie me publikun****Udhëheqës:** Reshat RESHITAJ**Tel:** 029/271-282**E-mail:** reshatreshitaj@hotmail.com**Njësia për auditim të brendshëm****Udhëheqës:** Ragip KABASHI**Tel:** 044/ 241-846**E-mail:** ragip.g.kabashi@rks-gov.net**Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut****Udhëheqës:** Habibe Bytyçi**Tel:** 044/ 922 - 324**E-mail:** habibe.q.bytyqi@rks-gov.net**Zyra për komunitete****Udhëheqës:** Xhelajdin Sadikaj**Tel:** 044/922 - 322**E-mail:** xhelajdinsadikaj@hotmail.com**Zyra për Çështje Gjinore****Udhëheqës:** Habibe Bytyçi**Tel:** 044 152 714**E-mail:** habibe.q.bytyqi@rks-gov.net**Zyra për Kthim****Udhëheqës:** Xhelajdin Sadikaj**Tel:** 044/922 - 322**E-mail:**

xhelajdinsadikaj@hotmail.com

Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi (KKSB)**Kordinatori:** Avni Bytyçi**Tel:** 044/ 259-450**E-mail:** avni.h.bytyçi@rks-gov.net

Shënime me rëndësi



Arsim

Drejtoria Komunale e Arsimit në Suharekës mbulon fushën e arsimit para-fillor, fillor, të mesëm të ulët, të mesëm të lartë. Procesi edukativo - arsimor në komunën e Suharekës zhvillohet në 3 shkolla të mesme me 3,159 nxënës, 28 shkolla fillore dhe të mesme të ulët dhe 14 paralele të ndara me 10.065 nxënës si dhe 1 çerdhe të fëmijëve.



Kultura

Komuna e Suharekës ka gjithsejtë 8 institucione kulturore, 3 shtëpi kulturore, 1 qendër rinore, 3 biblioteka, 1 muze edukativ dhe 1 arkiv publik i qytetit. Përpunimi i rrushit dhe verës është karakteristikë e vjetër e regjionit dhe "Festari" përkon me harenë e vjeljes së rrushit dhe përpunimit të verës. Ngjarje të rëndësishme: "Festari" është festë zyrtare e rinisë dhe e të gjithë qytetarëve të komunës së

Suharekës, "Diafesti" është festë zbavitëse kulturore tradicionale, e cila ndodh në korrik dhe gusht dhe i dedikohet diasporës, pastaj janë edhe festat tjera si: "13 qershori", "Sportisti i vitit", "Ditët e mërgatës", etj.

Punësimi

Në Komunën e Suharekës, janë të punësuar 1,309 persona në sektorin publik.



Sporti dhe Rinia

Aktivitetet rinore dhe sportive në Komunën e Suharekës zhvillohen përmes sektorëve siç janë: a) Sektori i kulturores b) Sektori i rinisë c) Sektori i sportit d) Sektori i Bibliotekave e) Sektori i Trashëgimisë. Këto aktivitete organizohen në objektet kulturo-sportive si Palestra e sporteve "13 Qershori", Shtëpia e Kulturës "Ukë Bytyçi", Qendra e rinisë "Shtëpia e Felbahut", Stadiumi i qytetit, Biblioteka e Qytetit, Muzeu edukativ etj. Sportet që janë aktive në këtë komunë janë: Futbolli, Basketbolli, Volejboli, Mundje, Shah-u, Karate, Ping Pong etj. Janë gjithsejtë 17 klube apo grupe sportive që zhvillojnë gara në kategori të ndryshme.

...



Shëndetësia

Në komunën e Suharekës kujdesi primar shëndetësor organizohet nëpërmjet Qendrës Komunale të Mjekësisë Familjare (QKMF). Në komunë janë 6 qendra të tjera të mjekësisë familjare (QMF) si dhe 9 ambulanta (AMF). Të gjitha komunitetet kanë qasje të barabartë në shërbime shëndetësore.



Turizmi

Komuna e Suharekës ka zona mjaft të përshtatshme dhe interesante për zhvillimin e turizmit që ndodhen në kompleksin e masivit të malit Sharr, i cili shtrihet në pjesën Verilindore dhe Juglindore të Mushtishtit, si dhe në zonën e bjeshkëve të Caralevës.

Pikat referuese për vizitë turistike: Kulla e Pashës në Mushtisht, Shtëpia e Ramë Bllacës në Bllacë, Kulla e Jonuz Tafollit në Qadrak, Mullinjtë e Breshancit, Mulliri i Dragaqinës, Mali Sharr, Guri i Dellocit, Kalaja e Kasterrcit etj.



Transporti

Qyteti i Suharekës gjendet në kilometrin e 18 të magjistrales Prishtinë-Prizren. Komuna ka qasje të mirë rrugore edhe me

komunat përreth. Autostrada e përshkon komunën në të gjithë sipërfaqen e saj nga Prizreni drejt Prishtinës. Kycja në Autostradë është 2 km nga qendra e qytetit. Aeroporti

më i afërt është ai i Prishtinës (52 km). Në komunën e Suharekës rrugë të asfaltuara janë 342.5 km, 26 km magjistrale, rreth 35 km rrugë regjionale dhe 281.5 km rrugë lokale.



Komuna e Ferizajt





Komuna e Ferizajt



Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj/>



038/ 200/ 46-076



<http://kk.rks-gov.net/Ferizaj>



Informata të përgjithshme

Dita e komunës

12 Qershori
Dita e Çlirimit

Popullsia

108,610

Shqiptarë	104,152
RAE	3,857
Boshnjak	83
Goran	64
Të tjerë	189

Grupmoshat

GM: 0-18 (19)	42,551
GM: 20-65	59,502

Sipërfaqja

345 km²

Vendbanime	45
Zona Urbane	1

Përshkrimi i komunës

Qyteti i Ferizajt është një ndër qendrat më të reja të Kosovës, andaj ekonomia e këtij qyteti është zhvilluar në vitet e vonshme. Një ndër faktorët më të rëndësishëm nga e kaluara historike për formimin e qytetit të Ferizajt dhe të zhvillimit ekonomik të tij, është padyshim ndërtimi i vijës hekurudhore (1873) dhe stacionit hekurudhorë, linjë kjo shumë e rëndësishme për transportimin e udhëtarëve dhe të mallrave, që njëkohësisht ndikoi shumë në ndryshimin e fizionomisë së vendbanimit duke shndërruar atë në qytet. Zanafilla e ekonomisë së qytetit fillon me disa veprimtari, kryesisht zejtare dhe tregtare. Kështu në vitin 1900, Ferizaj nga 400 shtëpi sa kishte në atë kohë, 200 prej tyre ishin dyqane. Përveç fabrikës së tjegullave, të gjitha ndërmarrjet tjera që ekzistojnë në Ferizaj, janë themeluar pas luftës së dytë botërore. Qeverisja e tanishme komunale e Ferizajt udhëhiqet nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)



Profili

Ferizaj shtrihet në jug të pjesës qendrore të Kosovës. Paraqet një udhëkryq të rëndësishëm, sepse nëpër Ferizaj kalojnë të gjitha rrugët e rëndësishme që e përshkojnë Kosovën nga veriu në jug dhe nga lindja në perëndim. Këto rrugë pastaj vazhdojnë edhe në shtetet fqinje dhe në rajon. Komuna e Ferizajt ka 720km², ka gjithsejtë 44 fshatra, në të cilat jetojnë gjysma e popullatës së kësaj komune.

Dy fshatrat më mëdha janë Gremja dhe Komogllava, në të cilat jetojnë nga 6,000 banorë.

Planet dhe Strategjitë Komunale

1. Plani Zhvillimor Komunal;
2. Planit Zhvillimor Urban i Qytetit të Ferizajt;
3. Strategjia e Zhvillimit Lokal Ekonomik;
4. Strategjia e Zhvillimit Afatmesëm e komunës së Ferizajt 2014-2017
5. Plani rregullues urban i hollësishëm për 3 zona;
6. Plani komunal për emergjenca;
7. Plani për Mbrojtjen e Mjedisit;



Degët kryesore të ekonomisë lokale

Ferizaj sot është shndërruar në qendër të rëndësishme ekonomike. Sot ende funksionojnë fabrikat dhe ndërmarrjet e dikurshme, të cilat ishin bazë për zhvillimin ekonomik të komunës, siç janë Fabrika e Tubave të Çelikut, Fabrika e Vajit, Kombinati i Drurit, Fabrika për Përpunimin e Frutave Ekzotike, Fabrika e Tullave, etj. Komuna kishte gjithsejtë 19 ndërmarrje shoqërore. Sot, ekonomia private paraqet bartësen kryesore të zhvillimit ekonomik të komunës. Në komunën e Ferizajt janë të regjistruara rreth 4,000 biznese, ndërsa numri i të punësuarve në ekonominë private është mbi 7,000.





SEKTORËT DHE NJËSITË

Spektori Emergjencave

Udhëheqës: Ismajl Mehmeti

E-mail: ismajl.mehmeti@rks-gov.net

Zyra për Marrëdhënie me Publikun

Udhëheqës: Shyqre Topalli

Tel: 049/491/900

E-mail: lelipress@hotmail.com

Njësia për Komunitete dhe Kthim

Udhëheqës: Rexhep Bajrami

Tel: 049/921/274

E-mail: rexhep.bajrami@rks-gov.net

Njësia e Inspektoratit

Udhëheqës: Ismet Vranovci

Tel: 049/921/453

E-mail: ismet.vranovci@rks-gov.net

Zyra për të Drejtat e Njeriut

Udhëheqës: Vjollca Krasniqi

E-mail: vjollca.krasniqi@rks-gov.net

Tel: 044/ 219/ 352

Qendra për Punë Sociale

Udhëheqës: Shyqri Mehmeti

Tel: 049/921-393

E-mail: shyqri.mehmeti@rks-gov.net

Buxheti

Buxheti vjetor

Të hyrat vetanake

Buxheti i realizuar 2014	23,256,296.00	3,575,000.00
Buxheti aktual 2015	25,248,783.00	4,204,689.00
Buxheti i Projektuar 2016	25,285,097.00	41,603,320.00
Buxheti i Projektuar 2017	25,304,564.00	41,161,000.00
Buxheti i Parashikuar 2018	25,492.220.00	4,172,530.00

Struktura organizative

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

Kryetari i Komunës

Tel: 0290/ 327-000

Nënkryetari

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit

Tel: 0290/321-111

Shërbimi i Kuvendit

Anëtarët e Kuvendit: 41 anëtarë

DREJTORITË KOMUNALE

1. Drejtoria e Administratës
2. Drejtoria e Financave
3. Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit
4. Drejtoria e Sëmbimeve Publike dhe Emergjencave
5. Drejtoria e Infrastrukturës
6. Drejtoria e Arsimit
7. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
8. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
9. Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë
10. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit
11. Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë
12. Udhëheqës i Personelit

Prona komunale

Komuna e Ferizajt ka në pronësi të saj komunale 77.09.88 Ha tokë në total, të ndarë në 46 parcela apo Ngastra kadastrale të ndryshme nëpër vendbanime apo në 12 Zona të veçanta kadastrale. Pjesa më e madhe e këtyre tokave është në zonat rurale. Parcelat me sipërfaqen më të madhe të pronës komunale gjendet në ZK Komogllavë me 8.84.19 Ha, ndërsa parcela me sipërfaqen më të vogël gjendet në ZK Nerodime e Poshtme me 0.18 Ha.

INDEKSI I KOMUNËS

Shërbimi i Zjarrfikësve

Udhëheqës: Halil Osmani

Tel: 049/921/395

Ndërmarrja Publike e Ujit

K.R.U. "Bifurkacioni" NJO

Ferizaj

Drejtori: Faton Frangu

Tel: 044/172/573

N.P.L. Stacioni Autobusëve

Drejtor Ekzekutiv: Ekrem

Mustafa

Tel: 049/669/300

Ndërmarrja Publike e Mbeturinave

K.R.M. "Pastërtia" NJO

Ferizaj

Udhëheqës: Dukagjin

Etemi

Tel: 044/506/812

Stacioni i Trenit

Shef i Stacionit: Remzi

Delolli

Tel: 044/224/404

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

Drejtor Dr. Asllan Bajrami



Shënime me rëndësi



Arsim

Komuna e Ferizajt numëron 38 shkolla fillore të ndara në 14 paralele fizike me mbi 20,000 nxënës dhe 8 shkolla të mesme me mbi 8,000 nxënës si dhe Universiteti i Shkencave Teknike Aplikative me afro 280 studentë të që gjithsej janë mbi 30,000 nxënës. Sot, në Ferizaj janë hapur dhe funksionojnë edhe disa shkolla dhe kolegje universitare private, në të cilat ndjekin mësimet dhe studimet një numër i konsiderueshëm i të rinjve të kësaj ane.

Kultura

Ferizaj ka Teatrin Profesional "Adriana Abdullahu". Veprimtaria teatrore zë fill që nga viti 1943 dhe deri më sot janë dhënë afro 143 Premiera teatrore. Gjithashtu, në Ferizaj ka mbi tridhjetë vite që funksionon grupi letrar "Jeronim de Rada", i cili ka zhvilluar një aktivitet të dendur letrar. Janë botuar shumë vepra, panorama poezish etj. dhe herë pas herë është nxjerr revista për letërsi, kulturë, e arte "ZGJIMI".

Kjo komunë tash ka vetëm 5 biblioteka me gjithsejtë 26,352 libra. Dy bibliotekat në Nerodime dhe Babush dhe 34,213 libra kanë qenë shkatërruar.

Ngjarje të rëndësishme: Festivali "Kosovarja këndon" muaji nëntor, festivali i teatrove të Kosovës në muajin tetor, java e kulturës në muajin qershor, ditët e diasporës korrik-gusht, si dhe festivali i filmit "fer-film" në muajin qershor.



Punësimi

Numri i të punësuarve në Komunën e Ferizajt është 299 punonjës, në sektorin e arsimit 1,813, ndërkah në shëndetësi janë 309 punonjës.

Sporti dhe Rinia

Ferizaj tradicionalisht ka qenë qytet i sportit. Ekipet e tij, sidomos në hendboll, kanë garuar me sukses në Kosovë dhe jashtë saj. Në këtë komunë është e zhvilluar gjithashtu edhe futboli, volejboli, basketboli, ping pongu, karateja, boksi, çiklizmi etj. Në Ferizaj e rrethinë janë rreth 1,400 sportistë aktivë, të cilët i zhvillojnë garat në 45 klube në rang lokal, rajonal dhe nacional. Shumica e aktiviteteve sportive zhvillohen në pallatin e sporteve "Bill Clinton", (rreth 1.2km nga qendra e qytetit përgjatë rrugës Ferizaj-Shtime, i cili ka vend për 1,832 shikues dhe në stadiumin e qytetit "Ismet Shabani". Objektet sportive janë të hapura çdo ditë pune për veprimtari sportive.

...



Shëndetësia

Kujdesi Primar Shëndetësor në Ferizaj funksionon mbi konceptin e Mjekësisë Familjare dhe funksionimin e vet e mbështet në menaxhimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, e cila disponon me punonjës të ndryshëm të sistemuar në disa njësi në nivel Qendrash Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe punkte shëndetësore në nivel fshatrash. Ofrohen shërbime shëndetësore për 24 orë rresht qofshin ato trajtuese, diagnostifikuese, rehabilituese apo preventive, promovuese dhe emergjente.



Turizmi

Ferizaj, edhe si komunë por edhe si qytet, ka potenciale mjaft të mëdha për zhvillimin e turizmit si të atij kulturor, ashtu edhe të atij natyror dhe rekreativ. Ndër potencialet e zhvillimit të turizmit lokal janë malet e bukura të Sharrit, lugina e lumit Nerodime, bifurkacioni, bashkimi i dy lumenjve si dhe shpatijet e Jezercit etj.



Transporti

Rregullimin dhe organizimin e transportit rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave në territorin e Komunës së Ferizajt e bënë Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë. Transporti rrugor në territorin e Komunës së Ferizajt është i organizuar në bazë të Rregullores për Transportin Rrugor si dhe akteve administrative të cilat janë të harmonizuara me Ligjin e

Transportit Rrugor Nr.04/L-179. Transporti rrugor i udhëtarëve në Komunën e Ferizajt ushtrohet si: transporti publik i udhëtarëve me autobus, transporti taksi i udhëtarëve dhe si transport i veçantë i udhëtarëve. Në kuadër të transportit publik të udhëtarëve me autobus bënë pjesë transporti urban – periferik, ku prej 44 fshatrave që përfshin territori i Komunës së Ferizajt, 42 fshatra janë të përfshira me transport.





Komuna e Vitisë





Komuna e Vitisë



Rruga 28 Nëntori, Viti



<http://kk.rks-gov.net/viti/Home.aspx>



0280/381-647



<http://kk.rks-gov.net/viti/City-guide/Important-Phone.aspx>



Misioni i Komunës të Vitisë është përmirësimi i jetës së qytetarëve të saj, ofrimin e shërbimeve sa më efikase në mënyrë sa më transparente, shërbime të shpejta administrative e shëndetësore dhe zbatueshmëri të rregulloreve konform ligjeve në fuqi, mirëqenie për të gjithë banorët e saj, rregullimin infrastrukturorë, zhvillim të gjithmbarshëm ekonomik, rritje të punësimit dhe përkrahje të kategorive sociale.



Informata të përgjithshme

Dita e komunës

14 Qershori
Dita e Çlirimit

Popullsia

46,987

Shqiptarë 46,669
Serb 113
Të tjerë 153

Grupmoshat

GM: 0-18 (19) 19.298
GM: 18-65 24.664

Sipërfaqja

270 km²

Vendbanime 39
Zona Urbane 1

Përshkrimi i komunës

Koha e saktë e themelimit të Vitisë, nuk mund të vërtetohet, por sipas disa të dhënave të shkruara dhe ato materiale duhet të jetë e vjetër së paku nga koha e mesme. Një kohë, territori i komunës së Vitisë ishte nën pushtimin serbo-sllavë, ndërsa në vitin 1389 sikur edhe pjesa tjetër e Kosovës pushtohet nga osmanët. Në regjistrimin osman të vitit 1455, Vitia si vendbanim kishte 104 bashkësi (shtëpi familjare) me një obligim tatimorë prej 18801 akçe të ardhurave vjetore. Drejtues i Nahisë së Moravës, ishte Çaudar Ahmedi i Guliam Begut. Në vitin 1912, sikurse dhe pjesët tjera të Kosovës, edhe Vitia okupohet nga Serbia. Gjatë luftës së Dytë Botërore, ishte pjesë e zonës së okupuar nga Bullgaria, ndërsa në nëntor të vitit 1944, ripushtohet nga Jugosllavia komuniste. Në pikëpamje administrative, Vitia me 1912 ishte shpallur komunë, ndërsa gjatë mbretërisë jugosllave, ishte pjesë përbërëse e Banonisë së Vardarit me qendër në Shkup. Në vitin 1952, në qarkun e Gjilanit formohen tri rrethe: Gjilani, Dardana dhe Vitia, ndërsa në vitin 1959 transformohen rrethet. Edhe Vitia, shndërrohet në komunë më vete, siç është deri më sot.

Profil



Vitia ka një sipërfaqe relativisht të rrafshet, një tokë mjaftë pjellore, sipërfaqe të konsiderueshme pyjore (si pjesa e Karadakut të Shkupit, me majën e Kopilaçës me një lartësi prej 1490m, male këto që formojnë edhe kufirin natyror mes Kosovës dhe Maqedonisë), por edhe rrjedha të mjaftueshme të lumenjve (Morava e Binçës, Letnica etj.) Gjithashtu Vitia ka një sasi të ujërave mineral dhe jo metale. Kjo komunë, me një sipërfaqe prej rreth 300 km², shtrihet në juglindje të Republikës së Kosovës. Në verilindje kufizohet me komunën e Gjilanit, në perëndim me komunën e Ferizajit, në jugperëndim më komunën e Kaçanikut dhe krejtësisht në juglindje kufizohet me Republikën e Maqedonisë.

Planet dhe Strategjitë Komunale

1. Strategjia për PAK 2015-2018;
2. Plani i Veprimit për transparenc;
3. Plani për mbrojtje nga zjarri për komunën e Vitisë;
4. Plani rregullues urban në zonat: qendra jugore dhe lumi qyteti i Vitisë
5. Plani Rregullues Urban "Zona Veriore";
6. Plani zhvillimor i komunës së Vitisë dhe Kllokotit 2010-2020;
7. Plani zhvillimor urban i Vitisë 2010-2015;



Degët kryesore të ekonomisë lokale

Vitia e vendosur në një rrafshinë shumë pjellore, ka mundësinë e kultivimit të të gjitha bimëve bujqësore. Kjo është edhe arsyeja që sektori i bujqësisë është njëri ndër sektorët kryesor të zhvillimit ekonomik të komunës së Vitisë.





SEKTORËT DHE NJËSITË

Sektori Emergjencave

Udhëheqës: Naser Haziri

Tel: 0280 382-021

E-mail: naserhaziri_viti@hotmail.com

Njësia për të Drejtat e Njeriut

Koordinator: Ibadete Hyseni

Tel: 0280/381-612

E-mail: Ibadete.hyseni@rks-gov.net

Zyra për informim

Agron Abazi

Mustaf Mehmeti

Tel: 0280/381-647

E-mail:

mustaf.mehmeti@rks-gov.net

agron.abazi@rks-gov.net

Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi

Koordinatori: Nexhmedin Jakupi

E-mail:

nexhmedin.jakupi@rks-gov.net

Tel: 0280/381-572

INDEKSI I KOMUNËS

Shërbimi i Zjarrfikësve

Drejtori: Hetem Jakupi

Tel: 093

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

Drejtori: Xhemajl Arapi

Tel: 0280 381-366

Prona komunale

Komuna e Vitisë ka në pronësi të saj komunale 26993.59 ha tokë në total, e cila është e ndarë në tokë të punëshme bujqësore pa kufi ndërtimor më 9928 ha, kultura lavëtarë më 9725.37ha, Kullosa më 3911.60 ha, Pemë më 37.82 ha, Perim-kulturë më 274.63ha, Djerrinë më 175 ha, ndërsa sipërfaqja tjetër është 2941.17ha.

Buxheti

Buxheti vjetor

Të hyrat vetanake

Buxheti i realizuar 2014
Buxheti aktual 2015
Buxheti i Projektuar 2016
Buxheti i Projektuar 2017
Buxheti i Parashikuar 2018

9,019,345
9,961,987
9,487,984
9,572,617
9,674,526

913,500
1,008,847
939,500
959,500
984,500

Struktura organizative

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

Kryetari i Komunës

Tel: 0280/381/626

Nënkryetari

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit

Tel: 038/200-47-408

Shërbimi i Kuvendit

Anëtarët e Kuvendit: 27 anëtarë

DREJTORITË KOMUNALE

1. Drejtoria e Administratës
2. Drejtoria për Financa, ekonomi dhe Zhvillim
3. Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
4. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
5. Drejtoria e Arsimit
6. Drejtoria për Shërbime Publike dhe

Emergjencë

7. Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit
8. Drejtoria e Shëndetësisë dhe punë sociale
9. Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë
10. Drejtoria e Inspeksionit



Shënime me rëndësi



Arsim



Procesi edukativo arsimor në komunën e Vitisë zhvillohet në nivelet, prej atij para fillor, e deri tek ai i mesëm dhe i lartë, në gjuhën shqipe dhe serbe. Institucionet arsimore në këtë komunë janë 20 Paralele para fillore me 923 fëmijë, 16 Shkolla fillore me 10344 nxënës dhe 3 shkolla të mesme me 2864 nxënës. Në këto institucione, në të gjitha nivelet arsimore janë të punësuar rreth 857 punëtorë. Po ashtu komuna ka 1 Çerdhe, ku janë të vendosur 55 fëmijë dhe janë të punësuar 8 edukatore dhe motra, si dhe 14 punëtorë tjerë administrativ dhe teknik.

Kultura

Në komunën e Vitisë manifestimi kulturor, letrar e sportiv "Flakadani i Karadakut" (që mbahet në muajin mars) është manifestimi kryesor që organizohet nga drejtoria për kulturë, rini dhe sport. Ndërkaq manifestimi kulturor, letrar e shkencor "Takimet e Dom Mikelit" është një manifestim tradicional me përmasa gjithëkombëtare i cili organizohet nga Shoqata Kulturore e Shkencore "Dom Mikel Tarabulluzi" me qendër në fshatin Stubëll. Po ashtu në kuadër të aktiviteteve komunale organizohet edhe këto festa

Punësimi

Në komunën e Vitisë në sektorin privat janë të punësuar 1900, ndërsa në sektorin publik janë 1150, në gjykata 37 punonjës ndërsa në polici janë të punësuar 100.

si: Ditët e Zojës-Letnicë, 1 Gushti- Dita e Mërgimtarëve të Vitisë, 28 Shtator- Ekspozita "Gursel Sylejmani", 2 Tetor- Ekspozita mbarëkombëtare e Fotografisë "Pimi Photography 1+24", 14 Qershor-Gjysmë-maratona etj.

Sporti dhe Rinia

Në komunën e Vitisë funksionojnë këto klube sportive: Klubi i futbollit "Vllaznia" (Garues në Ligen e Pare të Futbollit), Klubi i futbollit "Vitia" (Garues në Ligen e Pare të Futbollit), Klubi i Shahut "Vitia", Klubi i Ping-Pong, Klubi i Shenjëtarisë "Jeton Ramaj" (Pjesëmarrës në Lojrat Olimprike Evropiane Baku 2015), Shoqata e Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sporteve Shkollore (pjesëmarrës në garat komunale, regjionale dhe republikane), Klubi i voleybollit "Vllaznia"(f), Shkolla e Futbollit "Presing", Klubi i shigjetarisë "Shenjestra", Klubi i Karatesë "Vitia", Klubi i Aeronautikës "Shqiponjat e Lira", Klubi i Basketbollit "Vitia". Klubi i Voleybollit "Vitia" (m).

...



Shëndetësia

Në komunën e Vitisë, rrjeti shëndetësorë është e organizuar mirë për të iu ofruar qytetarëve shërbime efikase mjekësore. Përpas qendrave dhe ambulancave nëpër lokalitete, për të marrë ndihmë dhe shërbimet e tjera shëndetësore, qytetarët mund të ju drejtohen QKMF-së Nëna Terezë në Viti e cila është 24 orë në shërbim. Në kuadër të QKMF-së, funksionojnë edhe 4 qendra të mjekësisë familjare si dhe 7 punkte, të cilat janë shpërndarë nëpër fshatrat e ndryshme.



Turizmi

Vende turisitike për t'u vizituar në komunën e Vitisë janë: Muzeu i shkollës së parë shqipe në Kosovë-Stubëll, shkolla e vjetër në Pozhoran, kisha e Letnicës dhe e Bincës, kalatë në Terpezë, xhamitë në Sllatinë të epërme e Gërmovë, varrezat e dëshmorëve në Viti, Sllatinë, Skifteraj, Tërpezë e Sadovinë e Jerlive.



Transporti

Në komunën e Vitisë operojnë nëntë kompani të transportit publik, të cilat mbulojnë të gjithë territorin e komunës së Vitisë. Transporti publik me

autobus, organizohet në disa forma dhe atë: transport ndërkombëtar, transport ndër urban dhe transport urbano-periferik. Këto kategori janë të ndara edhe sipas menaxhmentit, ku transporti

ndërkombëtar dhe ndër urban menaxhohet nga Ministria e Infrastrukturës, kurse transporti urbano-periferik menaxhohet nga komuna e Vitisë. Sa i përket linjave ndërkombëtare nga Vitia, në funksion janë linja të rregullta

me qytetin e Shkupit dhe linjat transite me Nishin dhe Beogradin, si dhe linjat sezonale për bregdetin shqiptarë. Nga magjistralja Prishtinë – Shkup, Vitinë e ndajnë vetëm 13 km rrugë.



Komuna e Vushtrrisë





Komuna e Vushtrrisë



Rr "Adem Jashari" nr1



<http://kk.rks-gov.net/vushtrri/Home.aspx>



028 571 524
028 571 408



<http://kk.rks-gov.net/vushtrri/City-guide/Important-Phone.aspx>



Misioni: Komuna e Vushtrrisë ka për mision të ngritë mirëqenien ekonomike, sociale, kulturore dhe fizike, të sigurojë një jetë me të mirë për të gjithë qytetarët e saj. Të siguroj zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, avancim të arsimit dhe edukimit, përmirësim të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, zhvillim të infrastrukturës dhe ruajtjes së ambientit, promovim të turizmit, kulturës dhe sportit, rritje të efikasitetit të administratës publike.



Informata të përgjithshme

Dita e komunës

17 Qershori
Dita e Çlirimit

Popullsia

69,870

Shqiptarë	68,840
Serb	300
Turk	278
RAE	212
Të tjerë	103

Grupmoshat

GM: 0-18 (19)	26.719
GM: 20-64	38.643

Sipërfaqja

345 km²

Vendbanime	67
Zona Urbane	1

Përshkrimi i komunës

Komuna e Vushtrrisë (Vicianumi) siç është quajtur përpara sipas emrit të vjetër ilir, është lokalitet antik, që daton qysh nga mesjeta, edhe para Perandorisë Romake, përkatësisht që nga koha e dardanëve. Viciani në fund të shekullit të I para I.K. pushtohet nga Perandoria Romake. Gjatë periudhës së pushtimit romak (I–V) Viciani kishte arritur një zhvillim të konsiderueshëm ekonomik dhe kulturor. Pas shkatërrimit të Perandorisë Romake, Viciani mbeti në kuadër të Bizantit. Pas ndarjes së krishterimit më 1054 në katolicizëm dhe ortodoksizëm, pjesa më e madhe e popullatës së Vicianës ishte katolike. Në shekullin XIV Perandoria Osmane filloi ta pushtojë Ballkanin dhe me këtë edhe Vushtrrinë. Gjatë shekujve XV–XVIII, Vushtrria ishte ndër qytetet më të mëdha në Ballkan, në Perandorinë Osmane dhe qendër e sanxhakut më të rëndësishëm të Perandorisë Osmane. Gjatë Luftës së Parë Botërore, përkatësisht gjatë viteve 1915–1918, Vushtrria u pushtua nga Austro-Hungaria.

Profil



Komuna e Vushtrrisë shtrihet në pjesën veriore të Kosovës. Në veri kufizohet me Mitrovicën, në lindje me Podujevën, në jug me Obiliqin, në jugperëndim me Drenasin dhe në perëndim me Skenderajin. Komuna e Vushtrrisë shtrihet ndërmjet dy qendrave të mëdha urbane Prishtinës dhe Mitrovicës. Relievi i komunës është i ulët fushor dhe kodrinor të cilat janë pjesë përbërëse e masës malore të Kopaonikut dhe Qyqavicës. Klima e komunës është e butë dhe kontinentale. Lumi Sitnica, si lum më i madh, e përshkon tejprtej territorin e Komunës, e Lumi Llap përshkon një territor më të shkurtër të Vushtrrisë, deri në derdhjen e tij në lumin Sitnicë në fshatin Lumëmadh ndërsa dy lumenj më të vegjël: Tërstena dhe Studimja, kalojnë nëpër qytetin e Vushtrrisë. Kushtet natyrore kanë ndikuar në krijimin e tokave pjellore që janë karakteristikë e komunës. Komuna e Vushtrrisë është mjaft e pasur me pasuri natyrore.

Planet dhe Strategjitë Komunale:

1. Strategjia e Zhvillimit Ekonomik e Komunës së Vushtrrisë 2013-2018.
2. Plani Lokal i veprimtimit për integrimin e komuniteteve rom dhe ashkali në komunën e Vushtrrisë 2015-2018;
3. Strategjia për informim, komunikim dhe pjesëmarrje të publikut në vendimmarrje 2013-2016
4. Plani lokal i veprimtimit në mjedis 2014-2019
5. Plani komunal për efikasitet të energjisë 2014-2020;
6. Plani i Gatishmërisë Emergjente dhe civile për komunën e Vushtrrisë 2013.
7. Rregullore për shërbimin e transportit me merimangë për territorin e Komunës së Vushtrrisë;
8. Rregullore për përcaktimin e kriterëve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për ndihmë momentale entiteteve publike dhe jo publike;
9. Rregullore për rregullimin, sigurimin dhe mirëmbajtjen e varrezave në territorin e Komunës së Vushtrrisë;



Degët kryesore të ekonomisë lokale

Komuna e Vushtrrisë është qendër me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, si dhe falë tokës pjellore e cila ofron kushte të volitshme për kultivimin e të gjitha kulturave bujqësore. Komuna e Vushtrrisë prinë në prodhimin dhe përpunimin e patates. Në komunën e Vushtrrisë po ashtu edhe sektori privat është bartësi i zhvillimit ekonomik. Sektorët më të zhvilluar janë: Bujqësia (ekstensive), blegtoria me numër relativisht të madh të gjedheve, zeytaria, industria e përpunimit të drurit dhe industria përpunuese.





Prona komunale

Komuna e Vushtrrisë posedon rreth 600 hektarë në pronësi komunale, tokë bujqësore, kullosa dhe livadhe.

SEKTORËT DHE NJËSITË

Zyra e personelit

Udhëheqës: Bislim Dushi

E-mail: bislim.dushi@rks-gov.net

Tel: 028 572 416;

Zyra për Informim dhe

Komunikim me Publikun

Udhëheqës: Blerim Zhabari

E-mail: blerim.zhabari@rks-gov.net

Tel: 028 572 171/ 038 200 42 455

Zyra për komunitet dhe kthim

Udhëheqës: Branislav

Vuksanovic

E-mail: branisla.vuksanovic@rks-gov.net

Zyra ligjore

Udhëheqës: Idriz Muzaqi

E-mail: idriz.muzaqi@rks-gov.net

Tel: 028 571 363

Muzeu historik-etnografik

Tel: 028 573 650

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

Koordinatori: Hadika

Abdurrahmani

E-mail: hadika.abdurrahmani@rks-gov.net

Tel: 038 200 42 438

Buxheti

Buxheti vjetor

Të hyrat vetanake

Buxheti i realizuar 2014	13,419,233	1,652,000
Buxheti aktual 2015	14,625,418	1,675,327
Buxheti i Projektuar 2016	14,587,091	1,703,418
Buxheti i Projektuar 2017	14,628,812	1,703,418
Buxheti i Parashikuar 2018	14,823,295	1,780,000

Struktura organizative

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

Kryetari i Komunës

Tel: 028 571 601

Nënkryetari

DREJTORITË KOMUNALE

1. Drejtoria e Administratës
2. Drejtoria për Buxhet dhe Financa
3. Drejtoria e Arsimit
4. Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
5. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
6. Drejtoria për Prokurim Publik

7. Drejtoria për Urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit
8. Drejtoria për Shërbime Publike
9. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim
10. Drejtoria e Shëndetësisë
11. Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë
12. Drejtoria për Inspektim

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit
038/200/42419

Shërbimi i Kuvendit

Anëtarët e Kuvendit: 35 anëtarë



INDEKSI I KOMUNËS

Shërbimi i Zjarrëfikësve

Udhëheqës: Fadil Hyseni
Tel: 028 571 016

Shërbimi i menaxhimit të mbeturinave "Uniteti", Shoqëri aksionare Vushtri

Udhëheqës: Ragip Mikushnica
Tel: 028 571 084

Kompania e Ujësllësit

Rajonal: Mitrovica
Njësia në Vushtri
Menaxher: Driton Abazi
Tel: 044 196 799

Shënime me rëndësi



Shëndetësia

Sistemi i kujdesit shëndetësor parësor përfshin: një spital, dy qendra kryesore familjare komunale shëndetësore, shtatë objektet të mjekësisë familjare dhe tetë stacione të kujdesit parësor. Sektori i shëndetësisë komunale, duke përfshirë spitalin, ka 205 të punësuar prej të cilave 144 janë femra, duke përfshirë mjekë, infermierë dhe personel mbështetës..



Transport

Vushtrria gjendet në mes të dy qendrave kryesore Prishtinë dhe Mitrovicë, andaj rrugët ndërlidhëse dhe hekurudhat janë mundësi e mirë që zhvillojnë lëvizjen e shpejtë të qytetarëve dhe mallrave. Komuna gjendet në udhëkryqin e rrugës kryesore ndërkombëtare dhe regjionale dhe në udhëkryqin e arterieve hekurudhore (Adriatikut dhe Ibrit).



Arsim

Në komunën e Vushtrrisë sistemi edukativo-arsimor është i organizuar në këto nivele: Arsimi parafillor, fillor dhe i mesëm. Komuna e Vushtrrisë ka 52 shkolla fillore me 12,291 nxënës dhe 861 mësues, tre shkolla të mesme me 4,234 nxënës dhe 220 mësues, dhe një çerdhe publike me 158 fëmijë dhe 29 mësuese. Në komunë funksionojnë edhe 8 Biblioteka 2 në qytet, 6 në fshatra.

Punësimi

Në komunën e Vushtrrisë në sektorin publik janë të punësuar gjithsejtë 1572, në administratën komunale janë të punësuar 259, arsim 1108, shëndetësi dhe mirëqenie sociale janë të punësuar 205. Ndërsa në sektorin privat numri i të punësuarave gjithsejtë është 5695, punëtor të paraqitur në biznes 3646, të vetëpunësuar në bizneset individuale janë të punësuar 2049.



Kulturë

Përgjegjëse për kulturën në komunën e Vushtrrisë është drejtorja për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport. Në kuadër të kësaj drejtorie bëhen politika për organizmin e aktiviteteve të ndryshme kulturore me rastin e manifestimeve të ndryshme. Po ashtu në këtë komuna veprojnë edhe Shtëpia e Kulturës në qytet, një Qendër kulturore në Fshatin Shtitaricë.



Turizmi

Vende atraktive për t'u vizituar në komunën e Vushtrrisë janë :Ura e Vjetër e Gurit, Kalaja e Qytetit, Hamami i Qytetit, Kompleksi Azem Bejtë Galica në Galicë.





Komuna e Zubin Potokut





Komuna e Zubin Potokut



Komuna e Zubin Potokut shtrihet në pjesën veriore të Kosovës. Kjo Komunë zë një sipërfaqe prej rreth 333km², ku përfshinë qytetin e Zubin Potokut dhe 63 fshatra. Sipas kreut të administratës së përgjithshme, totali i popullsisë është vlerësuar në 15,200 banorë.

Informata të përgjithshme

1. Serbët: përafërsisht 13,900 banorë banojnë në qytet dhe fshatrat përreth.
2. Shqiptarët: përafërsisht 1,300 banorë jetojnë në fshatin Çabër/Čabra.



EKONOMIA

Ekonomia e komunës së Zubin Potokut kryesisht mbështetet në sektorin publik, me aktivitetin ekonomik të pranishëm në fushën e bujqësisë dhe biznese të vogla tregtare.

Struktura organizative

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

Kryetari i Komunës

Nënkryetari

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit

Anëtarët e Kuvendit:

19 anëtarë



Shënim:

- 64 zyrtarë policorë
- 135 mësimdhënës, në 1 të mesme, 4 shkolla fillore dhe 1 çerdhe.



SHËNDETËSIA

Kujdesi shëndetësor primar përfshin 1 qendër shëndetësore dhe 7 shtëpi shëndeti. Sektori i shëndetësisë ka 77 punonjës duke përfshirë mjekë, infermiere dhe anëtarë të personelit mbështetës. Fshati Çabër/Čabra ka 1 shtëpi shëndeti me 3 punëtor. Të gjitha komunitetet kanë qasje në kujdesin shëndetësor dhe të gjitha shërbime shëndetësore në zonat ku jetojnë.

INFRASTRUKTURA

Statusi i përgjithshëm i infrastrukturës në komunën e Zubin Potokut vlerësohet si i mirë. Të gjitha rrugët kryesore që lidhin fshatrat e mëdha me qytet janë të asfaltuara. Qyteti dhe fshatrat e Zubin Potokut janë të kyçura në sistemet e ujësjellësit dhe kanalizimit. Furnizimi me rrymë është problematik, veçanërisht në fshatra të largëta.

ARSIMI

Janë 3 shkolla fillore me 510 nxënës dhe 51 mësimdhënës; 1 shkollë e mesme me 256 nxënës dhe 46 mësimdhënës; dhe 1 çerdhe me 250 fëmijë dhe 25 mësimdhënës. Në fshatin Çabër/Čabra është 1 shkollë fillore me 136 nxënës dhe 13 mësimdhënës.

OBJEKTET FETARE DHE KULTURORE

Zubin Potok ka 16 kisha ortodokse serbe kryesisht nga shekullin 14-të dhe 15-të dhe 1 manastir ortodoks serb nga shekulli i 14-të i cili ishte renovuar në vitin 2003. Fshati Çabër/Čabra ka 1 xhami e cila ka qenë e djegur gjatë konfliktit të vitit 1999 dhe rindërtuar në vitin 2003.





Komuna e Zveçanit





Komuna e Zveçanit



Komuna e Zveçanit shtrihet në pjesën veriore të Kosovës. Kjo Komunë zë një sipërfaqe prej rreth 122km², ku përfshin qytetin e Zveçanit dhe 35 fshatrat. Sipas ueb faqes komunale, totali i popullsisë është vlerësuar në 16,650 banorë.

Informata të përgjithshme

1. Serbët: mbi 16,000 banorë jetonin në qytet dhe në 32 fshatra
2. Shqiptarët: përafërsisht 500 banorë jetojnë në fshatra Boletin/Boljetin, Lipë/Lipa dhe Zhazhë/Zaža
3. Boshnjakët, Romët, Goranët: përafërsisht 300 banorë jetojnë në qytet dhe fshatra.



EKONOMIA

Ekonomia e komunës së Zveçanit kryesisht ka për bazë sektorin publik dhe ndihmat e ngjashme, prodhimin dhe riciklimin e baterive, bujqësi dhe biznese të vogla tregtare. Janë 62 biznese të regjistruara private që veprojnë në këtë komunë.



INFRASTRUKTURA

Statusi i përgjithshëm i infrastrukturës në komunën e Zveçanit vlerësohet si i mirë. Shumica e rrugëve kryesore që lidhin fshatrat e mëdha me qendrat urbane janë të asfaltuara. Qyteti i Zveçanit dhe 3 nga 35 fshatra janë të lidhura me ujësjellësin rajonal të Mitrovicës po ashtu me kanalizimin. Ndërsa, fshatrat e tjera kanë sistemin e vet të ujësjellësit dhe kanalizimit. Të gjitha fshatra janë të lidhura me sistemin e furnizimit me rrymë. Furnizimi me rrymë është i qëndrueshëm.



PËR TË DITUR

103 - zyrtarë policorë.

131- Mësimdhënës në 5 shkolla fillore dhe 1 të mesme



SHËNDETËSI

Kujdesi shëndetësor primar përfshin 1 qendër shëndetësore dhe 4 shtëpi shëndeti. Sektori i shëndetësisë ka 167 punëtor duke përfshirë mjekë, infermiere dhe anëtarë të personelit mbështetës.

Përveç kësaj, 2 shtëpi shëndeti të financuara nga Qeveria e Kosovës, për momentin janë duke operuar në dy fshatra me shumicë shqiptare, me dy punëtor. Të gjitha komunitetet kanë qasje në kujdesin shëndetësor dhe të gjitha shërbimet shëndetësore në zonat ku jetojnë.

Struktura organizative

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

Kryetari i Komunës Nënkryetari

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit

Anëtarët e Kuvendit:

19 anëtarë



ARSIMI

Janë 3 shkolla fillore me 801 nxënës dhe 76 mësimdhënës; 1 shkollë e mesme me 254 nxënës dhe 38 mësimdhënës; dhe 1 çerdhe me 240 fëmijë që e vijnë plan programin në gjuhën serbe. Veç kësaj, janë 3 shkolla fillore me 63 nxënës shqiptarë dhe 17 mësimdhënës që e vijnë plan programin në gjuhën shqipe.

OBJEKTET FETARE DHE KULTURORE

Kalaja mesjetare e Zveçanit dhe manastiri ortodoks serb i Banjskës janë të klasifikuara si Zonat e Veçanta të Mbrojtura. Veç kësaj, brenda territorit të komunës ekziston një zonë e përbashkët për mbrojtje të veçantë, e klasifikuar në këtë mënyrë për shkaqe territoriale, përbëhet nga manastiri ortodoks serb i Sokolicës dhe trashëgimi shqiptare kompleksi memorial i Isa Boletinit.





Komuna e Malishevës





Komuna e Malishevës



Rr: "Gjergj Kastrioti
Skënderbeu"



<http://kk.rks-gov.net/malisheve/>



029/269-043



komuna.malisheve@rks-gov.net



Misioni: "Ofrimi i shërbimeve sa më të mira për qytetarët e saj, rritjen e mirëqenies sociale dhe ekonomike për të gjithë qytetarët e komunës përmes investimit në infrastrukturën e përgjithshme. Ofrimin e kushteve për arsimim sa më cilësor, për parashkollor, fillor dhe arsimin e mesëm të lartë, si dhe shërbime tjera, të cilat janë lënë në ingerencë , sipas Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.



Informata të përgjithshme

Dita e komunës

16 Qershori
Dita e Çlirimit

Popullsia

54,613

Shqiptarë	54,501
Boshnjak	15
RAE	26
Të tjerë	35

Grupmoshat

GM: 0-18 (19)	24,961
GM: 20-64	26,658

Sipërfaqja

306 km²

Vendbanime	44
Zona Urbane	1

Përshkrimi i komunës

Llapushë është nocioni tjetër me të cilin është i njohur territori i komunës së Malishevës. Lashtësia e Malishevës si vendbanim dëshmohet edhe me prezencën e tumës ilire në vetë qendrën e Malishevës, dëshmi kjo që jep të kuptohet se Malisheva ka qenë vendbanim i hershëm ilir bashkë me vendbanimet tjera në komunë, që janë shtrirë përgjatë lumit Mirusha. Historikisht, qendra administrative politike ka ndryshuar edhe në aspektin e emërimit edhe në aspektin e selisë. Pas Luftës së Dytë Botërore, pushteti lokal fillimisht u organizua në fshatin Banjë dhe në fshatin Kijevë, për tu transferuar pastaj me 1960 në Malishevë. Në këtë mënyrë Malisheva për herë të parë bëhet qendër administrative-politike.

Profil



Komuna e Malishevës kufizohet: në veri me komunën e Klinës dhe të Drenasit, në lindje me komunën e Lipjanit dhe të Therandës, në jug me komunën e Therandës dhe të Rahovecit, dhe në perëndim me komunën e Rahovecit dhe të Klinës. Meqenëse ka largësi përafërsisht të njëjtë nga të gjitha qendrat tjera regjionale, mund të thuhet se ajo shtrihet në pjesën qendrore të saj.

Territori i komunës është kryesisht kodrinor-malor. Format më të shpeshta të hasura në relievin e saj janë hurdat dhe shpellat. Atë e përshkon pellgu i lumit Mirusha, me toka të rrafshëta e pjellore në të dy brigjet e saj. Komuna rrethohet edhe me masivin malor të Drenicës, me pikën më të lartë mbidetare të saj prej 1,057 m tek Maja e Kosmaqit dhe 1,006 m tek maja e Koznikut. Në territorin e komunës së Malishevës dominon klima e mesme kontinentale, që karakterizohet me dimër të ftohtë dhe verë të nxehtë

Planet dhe Strategjitë Komunale:

1. Plani zhvillimor komunal ;
2. Plani rregullativ i komunës ;
3. Plani urban komunal ;
4. Strategjia e zhvillimit ekonomik Lokal



Degët kryesore të ekonomisë lokale

Bujqësia paraqet potencialin kryesor të zhvillimit ekonomik të komunës, ndërsa nuk është trashëguar ndonjë industri nga perioda e para luftës. Malisheva ka kushte të mira edhe për zhvillimin e industrisë ekstraktuese, ndërtimit, industrisë së ushqimit dhe përpunimit, që do të mund të ishin shtysë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik të komunës. Potencialet për zhvillim ekonomik nuk janë shfrytëzuar plotësisht deri më tani. Burimi kryesor i gjenerimit të të hyrave të qytetarëve të komunës së Malishevës janë prodhimtaria e vogël, bujqësia (ekonomitë familjare) dhe tregtia. Në përgjithësi, mjedisi për zhvillimin e ndërmarrjeve ende mbetet i pafavorshëm dhe me mbështetje të pamjaftueshme.





Prona komunale

Komuna e Malishevës ka 1688,48.73 Ha sipërfaqe të pronës komunale. Kushtet e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale për investime përcaktohen nga Kuvendi i Komunës përkatësisht ashtu siç vendosin anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Punësimi

Në Komunën e Malishevës, janë të punësuar përafërsisht 8000 persona. Në sektorin publik, janë të punësuar mbi 1729 punëtor. Sa i përket sektorit privat numri i të punësuarve është shumë më i madh. Sipas vlerësimeve, në biznese, tregti dhe prodhim, vlerësohet të jenë të punësuar 1214 punëtor, ndërsa të vetëpunësuar, kryesisht në bujqësi, blegtori, pemëtarë dhe të tjera, supozohet të jenë të punësuar rreth 7000 persona.

INDEKSI I KOMUNËS

Shërbimi i Zjarrfikësve dhe Shpëtimit - SHZSH
Drejtori : Ahmet Morina
Tel: 029/269-096

Ndërmarrja Publike e Ujit
Drejtori: Njazi Bytyqi
Tel: 044 391926

Stacioni i Autobusëve
Drejtori: Luan Morina
Tel: 044 341042

Ndërmarrja Publike e Mbeturinjave
Drejtori: Nuh Shala
Tel: 044 204885

Stacioni policor në Malishevë
Komandant: Kapiten Halil Morina
Tel: 029/269-007

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare – QKMF
Drejtori: Besim Zogaj
Tel: 029/269-006

Buxheti

Buxheti i realizuar 2014
 Buxheti aktual 2015
 Buxheti i Projektuar 2016
 Buxheti i Projektuar 2017
 Buxheti i Parashikuar 2018

Buxheti vjetor

11,614,623.0
 11,868,943.0
 12,337,508.0
 12,422,344.0
 12,541,393.0

Të hyrat vetanake

787,500.0
 755,908.0
 1,010,000.0
 1,020,000.0
 1,050,000.0

Struktura organizative

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

Kryetari i Komunës

Kontakti: 029 269 008

Nënkryetari

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit

Shërbimi i Kuvendit

Anëtarët e Kuvendit: 15 anëtarë

DREJTORITË KOMUNALE

1. Drejtoria e Administratës
2. Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik
3. Drejtoria e Arsimit dhe Edukimit
4. Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë
5. Drejtoria e Mbrojtjes dhe Shpëtimit
6. Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastër

7. Drejtoria e Inspektoriatit
8. Drejtoria e Kulturës Rinis dhe Sportit
9. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
10. Drejtoria e Shërbimeve Publike
11. Drejtoria e Urbanizimit

SEKTORËT DHE NJËSITË

Emergjencia në QKMF "Shpëtim Robaj"
Udhëheqës: Afrim Krasniqi
Tel: 029/269-216

Zyra për Informim Publik
Udhëheqës: Pranverë Kastrati
Tel: 029 269043
E-mail: pranvera.d.kastrati@rks-gov.net

Njësia për Komunitete dhe Kthim
Udhëheqës: Edona Krasniqi
Tel: 045 651526
E-mail: Krasniqi.edona@hotmail.com

Njësia e Inspektoratit
Udhëheqës: Sejdi Paçarizi
Tel: 045 985216
E-mail: s.paqarizi@hotmail.com

Zyra për Barazi Gjinore
Udhëheqës: Vera Bytyqi
Tel: 044 407973
E-mail: verabytyqi@hotmail.com

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
Kordinator: Halit Mazreku
Tel: 045 985166
Email: halit.mazreku@live.com

Shënime me rëndësi



Arsim

Procesi arsimor realizohet në këto nivele: para fillor, fillor, i mesëm i ulët, i mesëm i lartë dhe arsim special. Të gjitha këto janë të organizuara në kuadër të arsimit publik. Në komunë nuk ekziston asnjë

shkollë private. Ekzistojnë 36 shkolla fillore me tri paralele të ndara, tri shkolla të mesme dhe dy paralele për mësim special. Në bazë të Ligjit të ri për Arsimin, të gjitha shkollat fillore janë shkolla nëntëvjeçare.

Kulturë

Në Malishevë është e ndërtuar Shtëpia e Kulturës "Tahir Sinani", ku artistët lokal, kanë mundësi të mjaftueshme për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve kulturore dhe artistike. Po ashtu, në Malishevë, gjendet edhe muzeu i qytetit "Jahir Mazreku", ku janë të ekspozuara disa nga gjetjet arkeologjike në trevën tonë. Në Malishevë, po ashtu organizohen edhe disa aktivitete tradicionale, si Festivali Folklorik "Oda e Llapushës", pastaj panairi tradicional artizanal, ndërsa nuk mungojnë as aktivitetet tjera, koncerte dhe ekspozita. Po ashtu në komunën e Malishevës,



funksionojnë disa shoqëri kulturore dhe artistike, grupe të ndryshme të artistëve, në të gjitha fushat e artit dhe kulturës.

Sporti dhe Rinia

Në Malishevë, janë të formuara disa klube sportive dhe rinore. Sportet më të zhvilluara në komunën e Malishevës janë : Klubi i Notit "BESA" në Banjë, hendboll, basketboll, volejbol, gjimnastikë, atletikë dhe të tjera. Po ashtu nuk mungojnë edhe klubet e sporteve atraktive, si aerodinamikë, peshkimi sportiv dhe të tjera. Në Malishevë ekziston Qendra Rinore Publike dhe disa organizata tjera rinore. Aktiviteti kryesor i organizatave rinore është shënimi i Ditës së Rinisë (12 Gushtë) dhe aktivitete të tjera, si: fushata vetëdijesuese, promovim të vullnetarizmit, fushata lobuese dhe aksione të ndryshme.

...

Shëndetësia

Ekziston vetëm një shtëpi shëndeti në qytezën e Malishevës me gjashtë njësi organizative në fshatrat Kijevë, Bellanicë, Tërpezë, Pagarushë, Panorc dhe Llashka Drenoc dhe 10 ambulanca në fshatrat tjera. Gjithashtu janë 8 klinika private që merren me stomatologji, gjinekologji, ortopedi etj.

...

Transporti

Autostrada "Ibrahim Rugova" kalon nëpër Komunën e Malishevës, me një gjatësi prej 12.6 km. Në Komunën e Malishevës, janë të asfaltuara rreth 90% e rrugëve. Stacioni kryesor, është stacioni i autobusëve në qytet. Shtrirja e rrjetit rrugor në territorin e Malishevës si dhe përmbajtja e të gjitha niveleve të hierarkisë rrugore shtetërore dhe komunale, mundësojnë lidhje të mira brenda Kosovës si dhe në nivel ndërshtetëror regional. Në pjesën lindore të komunës së Malishevës shtrihet autostrada Durrës-Merdarë ndërsa në pjesën veriore të komunës shtrihet magjistralla Prishtinë- Pejë. Po ashtu në komunën e Malishevës shtrihen dy rrugë regjionale - rruga Kijevë-Malishevë-Duhle (që lidhë me Suharekë) dhe rruga Arllat-Malishevë-Rahovec. Këto rrugë regjionale paraqesin arteriet kryesore të qarkullimit brenda komunës.



Turizmi

Pikat referuese për vizitë turistike janë: Hapësira përgjatë rrjedhës së lumit Mirusha , Shpella e fladit në fshatin Panorc e cila gjendet në afërsi të lumit Mirusha, në fshatin Nguncat ekziston edhe një shpellë tjetër e pa hulumtuar ende nga shpellologët, për të cilën mendohet se do të jetë atraksion tjetër i madh për turistët , në fshatin Bajë gjendet burimi i ujit termal me kapacitet 250-300 l/sec si dhe vizitë tjetër turistike janë edhe Malet e Berishës .



Komuna e Junikut





Komuna e Junikut



Sheshi "Edmond Hoxha"

<http://kk.rks-gov.net/junik>

0390 / 370 -114

www.facebook.com/KomunaJunik

Misioni: "Ofrimi i shërbimeve efikase dhe të cilësisë së lartë, që i përgjigjen nevojave të qytetarëve me prioritet të veçantë në shëndetësi, edukim, sport dhe aktivitete kulturore, zhvillimi dhe rindërtimi i infrastrukturës lokale, përmirësimi i ambientit dhe kushteve të jetesës, përmirësimi i shëndetit të qytetarëve, mbështetja e njerëzve me nevoja në komunitetin tonë, promovimi dhe zhvillimi i talenteve dhe aftësive të biznesit të qytetarëve tanë.



Informata të përgjithshme

Dita e komunës

13 Qershori
Dita e Çlirimit

Popullsia

6,084

Shqiptarë
Të tjerë

6,069
6

Grupmoshat

GM: 0-18 (19) 2253
GM: 18-65 4011

Sipërfaqja

77,769.931 ha

Vendbanime 3
Zona Urbane 1

Përshkrimi i komunës

Gjatë viteve 1918–1924 Juniku ka qenë Zonë Neutrale. Në vitet 1941–1945 Juniku ka qenë Komunë në Prefekturën e Pejës, ndërsa gjatë viteve 1945–1960 Juniku ekziston si Komunë. Më 22 korrik 2005, nënshkruhet Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut Nr. 2005/11 për themelimin e pesë Pilot Njësie Komunale përfshirë edhe Junikun. Ndërsa certifikohet si Komunë me 13 Gusht 2008. Trashëgimia kulturore e Junikut lidhet shumë me zhvillimin historik të tij. Dëshmi të kësaj janë materialet arkeologjike të zbuluara tek vendbanimi ilir i quajtur "Gradina", vendbanim ky që ndodhet në gryken e Erenikut, në grykën e majës së Gjeravicës, gjurmë të cilit ekzistojnë edhe sot. Në periudhën e feudalizmit, Juniku paraqitet si një qendër e rëndësishme e pazarit. Në atë periudhë ndërtohet Xhamia e Qokut dhe Xhamia në lagjen Tregovishtë që edhe sot paraqesin objekte me vlera të rëndësishme kulturo-historike.

Profil



Pozita gjeografike e Junikut, karakteristikat topografike dhe veçoritë natyrore përveç që e lidhin komunën e Junikut me ato fqinje, paraqesin njëherit edhe fusha me interes të përbashkët dhe mundësi për bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkufitar.

Juniku ndodhet në pjesën perëndimore të Kosovës, pranë Alpeve Shqiptare. Ka territor me sipërfaqe prej 77.77km² dhe shtrihet deri në veri-perëndim të fushës së Dukagjinit, përballë grykës së lumit Erenik, i cili buron nga Liqejtë e Gjervaicës dhe rrjedh nëpër luginat e Alpeve Shqiptare. Territori i komunës së Junikut shtrihet deri në veriperëndim të fushës së Dukagjinit, dhe kufizohet me komunën e Deçanit, komunën e Gjakovës, Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Malit të Zi. Ka klimë kontinentale por me disa tipare mesdhetare. Kjo klimë është e përshtatshme për kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore. Lumenjtë dhe sipërfaqet ujore: Lumi Erenik është më i madhi dhe më i rëndësishmi i rajonit, i cili shërben gjithashtu si burim uji edhe për ujitjen e fushës së Junikut. Ereniku buron nga liqeje të Gjeravicës. Ujërat që rrjedhin përkatësisht vijnë nga kurorat e maleve, nga gropa e Erenikut dhe nga Bjeshkët e Nemuna, që formojnë rrjedhat sipërfaqësore të ujërave. Zona të veçanta në komunën e Junikut janë: Kullat e Dukagjinit dhe kalimet kufitare (Prush e Qafë Morinë).

Planet dhe Strategjitë Komunale:

1. Plan i Zhvillimor Komunal (PZHK),
2. Plan i Zhvillimor Urban (PZHU),
3. Planet Rregulluese Urbane (PRRU),
4. Plan i Zhvillimor për Konservimin e Trashëgimisë Kulturore,
5. Strategjia e Zhvillimit Lokal,
6. Plan i Veprimt në Mjedis (PVM),
7. Plan i Integruar i Komunës së Juniku,
8. Plan për menaxhimin e mbeturinave për Komunën e Junikut 2014 – 2019.



Degët kryesore të ekonomisë lokale

Degë e rëndësishme e Junikut është zhvillimi i Turizmit dhe zhvillimi i Bujqësisë - e cila zë një sipërfaqe prej 4.439 Ha tokë bujqësore e që paraqet 57.08% të sipërfaqes së përgjithshme. Aktivitetet bujqësore në Junik zhvillohen qoftë në zonën urbane (për shkak të tipologjisë së banimit me oborre të mëdha) po ashtu edhe atë rurale. Kulturat më të zhvilluara bujqësore janë: gruri, misri, fasulja, thekra, pastaj perimet si specat, domate lakrat dhe qepët. Në masë mesatare kultivohen kulturat e pemëtarisë si: molla, dardha, vishnja dhe dredhëza. Blegtoria po ashtu paraqet një drejtim tjetër strategjik të zhvillimit ekonomik të Komunës së Junikut.

Sipërfaqja e madhe me livadhe e kullota, brenda territorit të komunës si dhe nga tradita e zhvillimi të kësaj lëmie janë faktorë favorizues për zhvillimin e blegtorisë.

Ekziston një kompani e cila merret me përpunimin e asfaltit dhe zhavorit. Punësimi në këtë kompani bëhet në bazë të nevojave dhe është kryesisht sezonal.



SEKTORËT DHE NJËSITË

Zyra për Informim Publik

Zyrtare: Leonita Jasiqi
E-mail: leonita.jasiqi@rks-gov.net
Tel: +386 (0) 49 760 254

Zyra për Marrëdhënie me Publikun

Zyrtare: Leonita Jasiqi
E-mail: leonita.jasiqi@rks-gov.net
Tel: +386 (0) 49 760 254

Zyra e Drejtave të Njeriut

Zyrtare: Leonita Jasiqi
E-mail: leonita.jasiqi@rks-gov.net
Tel: +386 (0) 49 760 254

Zyra për të drejta të fëmijëve

Zyrtar: Gëzim Geci
E-mail: gezimgeci@AOL.com
Tel: +377 (0) 44 921 008

Zyra për Barazi Gjinore

Zyrtare: Saranda Isufaj
E-mail: saraa_085@hotmail.com
Tel: +377 (0) 45 379 004

Zyra për komunitete dhe kthim

Zyrtare: Leonita Jasiqi
E-mail: leonita.jasiqi@rks-gov.net
Tel: +386 (0) 49 760 254

Indeksi i komunës

Shërbimi i Zjarrfikësve

Shef i SHZ: Shkelzen Shehu
E-mail: Shehu_9@hotmail.com
Tel: +386 (0) 49 760 267

Hidrodrini

Menaxher Njësie: Tafë Gaxherri
E-mail: tafe-g@live.com
Tel: +377 (0) 44 253 370

Shtëpia e Shëndetit

Kryeshef i QKMF: Ali Kuqi
E-mail: dr_alikuqi@yahoo.com
Tel: +377 (0) 44 253 228

Stacioni Policor në Junik

Drejtor: Rasim Sylja
E-mail: rasim.sylja@kosovoploice.com
Tel: +377 (0) 44 236 963

Posta – Junik

Drejtor: Ibish Hulaj
e-mail: ibish.hulaj@ptkonline.com
Tel: +377 (0) 44 165 608

Buxheti**Buxheti vjetor****Të hyrat vetanake**

Buxheti i realizuar 2014	1,181,325.00	89,250.00
Buxheti aktual 2015	1,285,347.08	91,567.00
Buxheti i Projektuar 2016	1,170,878.00	91,000.00
Buxheti i Projektuar 2017	1,180,280.00	91,500.00
Buxheti i Parashikuar 2018	1,191,374.00	92,000.00

Struktura organizative

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

Kryetari i Komunës

Kontakti: 039 / 431 080

Nënkryetari

039-370 415

DREJTORITË KOMUNALE

1. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
2. Drejtoria për Buxhet dhe Financa
3. Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis
4. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit

Shërbimi i Kuvendit
Tel: 039 370 987

Anëtarët e Kuvendit: 15 anëtarë

5. Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
6. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
7. Drejtoria për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim



Shënime me rëndësi



Arsim

Procesi edukativo – arsimor në Komunën e Junikut zhvillohet në këto nivele: Niveli parashkollor përfshirë edhe fëmijët me nevoja të veçanta, fillor (klasat 1- 5), shkollat e mesme e ulët (6- 9) dhe arsimi i mesëm i lartë. Në nivelin

parashkollor janë 56 nxënës dhe 1 mësimdhënës. Në nivelin fillor dhe të mesëm të ulët kemi 607 nxënës dhe 37 mësimdhënës, ndërsa në arsimin e mesëm të lartë kemi 230 nxënës dhe 13 mësimdhënës.

Kultura

Komuna e Junikut ka bibliotekë dhe muze. Që të dyja këto janë të vendosura dhe e zhvillojnë aktivitetin e tyre në Kullën Bibliotekë dhe në Kullën Muze. Juniku ka edhe hapësira për sport, rekreacion, hapësira publike, si dhe parqe si: Palestrën Sportive dhe dy fusha sportive në Shkollën Filllore dhe të Mesme të Ulët "Edmond Hoxha", një fushë sportive në Shkollën e Mesme "Kuvendi i Junikut", një fushë sportive në Lagjen Miroc, një Sallë Sportive dhe fushë për futboll të madh në lagjen Qestaj, Qendrën Rinore, Qendrën për Ngritje Profesionale, Qendrën Rajonale të Turizmit, amfiteatrin natyror, shtigjet për ecje, shtigjet për biçiklistë, parkun Moronica dhe parkun përgjatë brigjeve të shtratit të lumit Erenik. Në Junik gjenden 12 objekte kulti, të cilat janë të shpërndara në gjithë territorin. Ndër to bëjnë pjesë



edhe dy xhami prej të cilave Xhamia më e vjetër është ajo që gjendet në lagjen Çoku, e cila daton prej vitit 1570. Ndërsa Xhamia tjetër është "Xhamia e Qendrës". Aktualisht në Junik ekziston edhe Teqja e Shejh Xhaferit e cila quhet "Teqja e Madhe Amë e Tarikatit Alijjei – Halvetie – Xhaferi në Junik. Kjo teqe u dedikohet besimtarëve halvetinj.

Sporti dhe Rinia

Aktualisht nevojat e banorëve për sport dhe rekreacion në Komunën e Junikut përmbushin hapësirat për sport dhe rekreacion që gjenden në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët "Edmond Hoxha" (këtu gjenden Palestra Sportive dhe dy fusha sportive), fusha sportive në Shkollën e Mesme "Kuvendi i Junikut", fusha sportive në lagjen Miroc, Salla Sportive "Ereniku" në lagjen Qestaj dhe një park i lodrave për fëmijë me 120 m². Mungon një Sallë Sportive në Shkollën e Mesme "Kuvendi i Junikut", që vazhdon të mbetet sfidë. Juniku ka boksierët më të spikatur që janë Luan Krasniqi dhe Haxhi Krasniqi që po arrijnë suksese të shumta në arenën ndërkombëtare. Përpos Klubit të atletikës "Juniku", i cili ka arritur suksese të shumta duke fituar trofe dhe medalje të shumta në të gjitha disiplinat dhe Klubit të Futsallit "Juniku", që po arrit suksese shumë të mira. Juniku ka edhe Klubin e Futbollit, Klubin e Shenjëtarisë dhe shigjetarisë, Shoqatën bjeshkatore alpiniste, Shoqatën e fermerëve, Shoqatën e pylltarëve, OJQ Lokale dhe KVRL-ja (Këshilli i Veprimit Rinor Lokal).

Shëndetësia

Shërbimet shëndetësore parësore ofrohen nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), e cilagjendet në qytezën e Junikut dhe numëron 23 (+ 3 punëtorë të sistematizuar nga Ministria e Shëndetësisë) që gjithsej i bie 26 punëtorë të sistemuar në dy turne punësimi. Nga ky numër, 7 janë mjekë, 2 stomatologë dhe pjesa tjetër staf i mesëm dhe staf ndihmës. QKMF ofron të gjitha shërbimet e kujdesit parësor shëndetësor si dhe shërbime Stomatologjike.



Turizmi

Turizmi në komunën e Junikut është shtylla kryesore e zhvillimit ekonomik. Potenciali turistik i Komunës së Junikut është ngushtë i lidhur me pozitën gjeografike dhe vlerat kulturore, arkeologjike dhe natyrore të kësaj komune, të cilat paraqesin një potencial të madh për zhvillimin e turizmit. Shikuar në aspektin e zhvillimit turistik, Komuna ndahet në tri zona turistike: Zona turistike e qytetit të Junikut me rrethinë, Zona turistike - Gryka e Junikut, Zona turistike - Gryka e Batushës. Aktualisht komplekset, zonat më të vizituara nga turistët janë: Maja e Gjeravicës me dy liqeje natyror, lumi Erenik, Moronica, Kullat, Teqet, Xhamia, etj. Sektori i turizmit është ngushtë i lidhur edhe me zhvillimin e hotelierisë.



Transporti

Komuna e Junikut ka përafërsisht 80% të rrugëve të asfaltuara. Ka një stacion të autobusëve. Lidhje të drejtpërdrejta dhe të shpejta janë të orientuara drejt Deçanit e Pejës. Gjakova mund të arrihet më shpejtë duke pasur parasysh që shërbimet për në

Deçan edhe më tutje veprojnë përmes rrugës magjistrale ku udhëtarët mund të lidhen me shërbimet e rregullta që udhëtojnë në drejtimin mes Pejës dhe Gjakovës.

Stacioni më i afërt i trenit ndodhet në qytetin e Pejës dhe të Klinës. Lidhja e Lokalitetit të Junikut përmes rrugëve ajrore kryhet zakonisht përmes Aeroportit

të Prishtinës. Gjatësia e rrugës prej Junikut deri në Aeroport është 100km, e cila kalohet përmes Gjakovës apo Pejës, ku distanca përafërsisht është e njëjtë.

Lidhje tjetër alternative është edhe Aeroporti i Shkupit (Maqedoni), ku rruga prej Junikut është e gjatë rreth 250km. Në Junik janë të regjistruar 8 vetura taksi.



Komuna e Mamushës





Komuna e Mamushës



20540 Mamushë

<http://kk.rks-gov.net/mamushe/>

029/273260

mamusabelediyesi@hotmail.com

Misioni: Mamusha e mbështetur në bujqësi, zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, mjedis të gjelbërt, ruajtje të trashëgimisë natyrore e kulturore, me infrastrukturë dhe eko-turizëm të avancuar



Informata të përgjithshme

Dita e komunës

13 Qershori
Dita e Çlirimit

Popullsia

5,507

Turk
Shqiptarë
RAE
Boshnjak

5,128
327
51
1

Grupmoshat

GM: 0-18 (19)
GM: 20-64

2,348
2,890

Sipërfaqja

32 km²

Vendbanime
Zona Urbane

1
1

Përshkrimi i komunës

Mamusha është njësi administrative në pjesën jug-perëndimore të Kosovës. Në vitin 2008 Mamusha u shndërrua në Komunë dhe është ndër komunat më të vogla në Kosovë. Shëndrrimi i saj në komunë u bë në kohen e decentralizimit. Mamusha është vendi i vetëm në Kosovë me shumicë Turke 93.1%. Ka florë dhe faunë relativisht të pasur. Banorët e Mamushës i takojnë besimit Islam. Komuna e Mamushës shtrihet në lartësi 450-500m mbi nivelin e detit, me klimë kryesisht kontinentale. Vërehen ndikimet orientale në jetën e banorëve të Mamushës. Vendi ka një infrastrukturë të dobët dhe buxhet të plogësht.

Profili



Komuna e Mamushës shtrihet në pjesën jugore të Kosovës. Mamusha është në lartësi mbidetare prej 360m. Ajo shtrihet në gjerësinë gjeografike 42,19° në perëndim dhe gjerësinë gjeografi ke 20,43° në jug. Komuna e Mamushës në juglindje kufizohet me Komunën e Prizrenit, në verilindje me Komunën e Suharekës dhe në veriperëndim me Komunën e Rahovecit. Mamusha shtrihet në Rrafshin e Dukagjinit i cili mbulon pjesën jug-perëndimore të Kosovës. Ky rajon përbëhet nga një tokë e pjellshme, tokë e punueshme bujqësore që është e përshtatshme për kultivim bujqësor. Pika më e lartë e komunës është bregu i Golubradës, në lartësi mbidetare prej 405m ku kryesisht ka pyje dhe vreshta.

Planet dhe Strategjitë Komunale:

1. Plani zhvillimor komunal
2. Plani rregullativ i komunës
3. Planet urbane komunale
4. Strategjia e zhvillimit ekonomik Lokal



Degët kryesore të ekonomisë lokale

Një prej institucioneve shumë të rëndësishme që vepron në komunë është zyra për zhvillim ekonomik dhe bujqësi. Zyra është e pajisur me një kuadër të trajnuar dhe proaktiv, i cili ofron mbështetje të plotë zhvillimit të biznesit dhe atij ekonomik në komunë, duke filluar nga shërbimet për regjistrim të biznesit deri në mbështetje të plotë të investitorëve. Komuna e Mamushës krenohet me potencialin e madh që e ka në Agrobiznes dhe përpunim të ushqimit. Këta sektorë tradicionalisht janë një nga sektorët më të fortë të ekonomisë së Kosovës në përgjithësi. Përparësi të shumta konkurruese të sektorit përfshijnë një kombinim të veçantë të klimës kontinentale dhe nën-mesdhetare, praktikat ekologjikisht miqësore të prodhimit, teknologji të shëndoshë të përpunimit të ushqimit, të punës shumë të kualifikuar në dispozicion në të gjithë zonat rurale, qasje shumë të mirë në tregjet rajonale dhe një reputacion për produkte ushqimore të cilësisë.



Prona komunale

Komuna e Mamushës edhe pse është Komunë e re është mjaft e zhvilluar, mirëpo nuk posedon shume pronë komunale për dhënie në shfrytëzim sepse një pjesë e mirë e saj menaxhohet nga agjencia kosovare e privatizimit.

INDEKSI I KOMUNËS

Shërbimi i Zjarrfikësve

Drejtor: Rrahman Morina

Tel: 03820045223

Ndërmarrja Publike e Ujit

Lloji i shërbimit: Menaxhimi i sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimeve në komunë

N.P.L. Stacioni Autobusëve

Lloji i shërbimit: Është kompani publike lokale e cila është përgjegjëse për organizimin dhe mbarrëvajtjen e vijave publike të transportit publik të autobusëve dhe kombi-busëve.

Ndërmarrja Publike e Mbeturinave

Lloji i shërbimit: Është ndërmarrje publike e cila bën grumbullimin e mbeturinave nëpër ekonomi familjare, biznese dhe institucione.

Qendra Kryesore e Mjekësisë

Familjare

Drejtor: Ridvan Mazrek

Tel: 03820045222

Stacioni Policor

Drejtor: Enis Orqusha

Tel: 029/273453

Buxheti

Buxheti vjetor

Të hyrat vetanake

Buxheti i realizuar 2014	1,272,609.00	63,000.00
Buxheti aktual 2015	1,403,570.00	64,869.00
Buxheti i Projektuar 2016	1,473,046.00	64,900.00
Buxheti i Projektuar 2017	1,486,457.00	65,900.00
Buxheti i Parashikuar 2018	1,502,026.00	66,700.00

Struktura organizative

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

Kryetari i Komunës

Kontakti: 03820045200

Nënkryetari

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit
039 / 471 - 335

Shërbimi i Kuvendit

Anëtarët e Kuvendit: 15 anëtarë

DREJTORITË KOMUNALE

1. Drejtoria e Administratës dhe Personelit
2. Drejtoria Shëndetësisë dhe M. sociale
3. Drejtoria e Financave dhe Ekonomisë

4. Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
5. Drejtoria Urbanizmit, Kad. dhe M. së Mjedisit
6. Drejtoria Shërbimeve Publike dhe E. Civile



Punësimi

Gjithsej të punësuar në komunën e Mamushës janë 1,216 persona.

SEKTORËT DHE NJËSITË

Zyra Për Integritet Evropiane

Udhëheqës: Ibrahim MORINA

Tel: 03820045217

Zyra Për Komunitete dhe Kthim

Udhëheqës: Ajet SADIKI

Tel: 038200452017

Shënime me rëndësi

Arsim

Në Mamushë ka institucione parashkollore. Ndërsa ka 1 shkollë fillore "Anadolu" me 891 nxënës dhe 47 mësimdhënës dhe teknik; një shkollë të mesme me 165 studentë dhe 18 mësimdhënës. Mësimi në shkollën fillore "Anadolu" bëhet në dy gjuhë: Në gjuhën turke dhe shqipe. Shumica e nxënësve janë turq. Ndërsa në shkollën e mesme të Mamushës mësimi zhvillohet vetëm në gjuhën turke. Nxënësit shqiptarë shkollën e mesme e vijnë në shkollat e mesme të Prizrenit ose në vendet fqinje dhe një pjesë vijojnë mësimet në Mamushë në gjuhën turke.

Turizmi

Në Mamushë vlen të vizitohet Sahat Kulla si dhe bukuritë e ndryshme natyrore, gjithësesi nuk duhen lënë pa marrë pjesë në Festivalin e Domateve që mbahet çdo vit me 23 Korrik.



Sporti dhe Rinia

Kohet e fundit ka disa aktivitete sportive dhe rinore që kanë filluar të angazhohet.

...

Shëndetësia

Në Komunën e Mamushës është një institucion shëndetësor, (1 – QKMF).

...

Kulturë

Jeta kulturore në Mamushë mbulohet nga një shtëpi e kulturës e cila është funksionale.



Transporti

Komuna e Mamushës është e lokalizuar në trekëndëshin Prizren – Suharekë – Rahovec. Distanca për në Komunën e Prizrenit është 20km; Suhareka 10km, ndërsa nga Rahoveci 15km. Mamusha lidh Suharekën me Tiranën respektivisht magjistralen Prizren- Gjakovë dhe Pejë dhe anasjelltas në drejtimin Prizren – Prishtinë dhe Shkup. Po ashtu qasja në Autostradë është vetëm 10km dhe ka një qasje shumë të lehtë si në Prishtinë e po ashtu edhe në Tiranë dhe Podgoricë. Zona ku do të mundësohet hapja e lokacioneve të reja për biznes është me të vërtet shumë lehtë e arritshme sepse përgjatë saj kalon autostrada.



Duke pas parasysh se Komuna e Mamushës ka traditë të madhe në kultivimin e domates si njëra ndër perimet më të kërkuara në sektorin ushqimor. Andaj në shenjë të respektimit të kultivimit të kësaj perimeje është bërë tashmë Festivali i Domateve, i cili festival mbahet me 23 Korrik të çdo viti. Shtytja e fermerëve për produktivitet si dhe rritje të cilësisë së domates është dhe mbetet njëri nga qëllimet e këtij festivali. Po ashtu me këtë festival kontribuojmë edhe në ofrimin e njerëzve dhe krijimin e miqësive të reja si brenda Kosovës e po ashtu edhe me vendet e ndryshme.



Komuna Hani i Elezit





Komuna Hani i Elezit



Rr. "Nuri Bushi" p.n. 71 000
Hani Elezit



<http://kk.rrks-gov.net/hanielezit/>



0290/385-112
038/200/46-570



<https://www.facebook.com/Komuna-Hani-i-Elezit>



Misioni: Qytet me shërbime efikase e cilësore të cilat janë në funksion të mirëqenies së përgjithshme të qytetarëve të saj. Qytet me planifikim urban e hapësinor të mirëfilltë, i cili e bën kryeqytetin qendër të sigurt për një jetë të begatshme socio-ekonomike, kulturore, arsimore, sportive dhe duke siguruar mirëqenie dhe cilësi të jetës për qytetarët e saj.



Informata të përgjithshme

Dita e komunës

11 Qershori
Dita e Çlirimit

Popullsia

9,403

Shqiptarë
Boshnjak
Të tjerë

9,357
42
2

Grupmoshat

GM: 0-18 (19) 3,678
GM: 20-64 5,201

Sipërfaqja

83 km²

Vendbanime 11
Zona Urbane 1

Përshkrimi i komunës

Gjatë shekullit të fundit (që nga viti 1960) Hani i Elezit dhe fshatrat e tij i takonin komunës së Kaçanikut. Në mes të vitit 2005 Hani i Elezit u promovua në një Pilot Njësi Komunale. Në kuadër të procesit të decentralizimit, Hani Elezit fitoi statusin e komunës pas mbajtjes së zgjedhjeve lokale të vitit 2007, ndërsa përfundimisht me shkresën njoftuese nr. 02-527, Ministria e APL më 13 gusht 2009 njoftoi se Komuna e Hanit të Elezit është certifikuar në të njëjtin nivel të kompetencave dhe përgjegjësi si edhe komunat tjera në Republikën e Kosovës. Hani i Elezit i sotëm si vendbanim daton nga shekulli XVI. Në hartat e vjetra, deri vonë figuronte vendbanim SAR(Sharr), i cili ka të bëjë me Hanin e Elezit të sotëm, për çka ka edhe dëshmi tjera historike. Me ardhjen e Turqve dhe me ndërtimin e bujtinës (hanit) edhe ky vendbanim quhet sipas pronarit të kësaj bujtine (Hani i Elezit). Pra Komuna e Hanit të Elezit daton që nga viti 1913. Hani Elezit është komuna e vetme në Kosovë e cila udhëhiqet nga një kryetar i pavarur i cili nuk i përket asnjë partie politike.



Profil

Hani i Elezit ndodhet në pjesën jug-lindore të Kosovës afër kufirit me Maqedoninë. Gjendet në mes të Bjeshkëve të Sharrit në perëndim si bjeshkë të reja të formuara përmes orogjenezës alpine (kenozoike) dhe Bjeshkëve të Karadakut (Bjeshkët Rodope -1218m). Vendbanimi i Hanit të Elezit është në një vend ideal gjeografik pasi që prek rrugën kryesore nga Prishtina në Shkup. Është pikë kufitare dhe industria është shumë e zhvilluar dhe e njohur jo vetëm në Kosovë por edhe jashtë vendit. Në pjesën jugore të Hanit të Elezit gjendet pika kufitare që ndan territorin e Kosovës me Maqedoninë. Kjo është një pikë kyçe për rajonin dhe Kosovën, pasi që shumica e transportit të mallrave, kryhet nëpërmjet kësaj pike kufitare. Prania e bjeshkëve në lindje dhe perëndim të komunës do të thotë se lidhjet kryesore me rajonet tjera janë realizuar nëpërmjet luginës së Lepencit. Lumi Lepenc kalon përmes maleve duke formuar Grykën e Kaçanikut. Rruga Magjistrale Prishtinë-Shkup rreth 12km e gjatë në territorin e Hanit të Elezit, që kalon përmes Grykës së Kaçanikut, lidh Hanin e Elezit me komunën veriore të Kaçanikut dhe më tej. Më në Jug të Luginës së Lepencit është pika kufitare që lidh Kosovën me shtetet tjera të Ballkanit dhe Evropës.

Planet dhe strategjitë

Planet dhe Strategjitë Komunale:

Plani Zhvillimor Komunal;

Plani Zhvillimor Urban;

Plani Rregullues Urban – Hani Elezit I

Plani tre vjetarë i banimit;

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis;

Plani për Administrimin e Mbeturinave dhe

Vlerësimi Strategjik Mjedisor;



Degët kryesore të ekonomisë lokale

Hani Elezit kryesisht është vend industrial, mirëpo ekzistojnë kushte të volitshme për zhvillimin e blegtorisë, bletarisë dhe pemëtarisë. Komuna e Hanit të Elezit ka resurse të mëdha natyrore e sidomos mineraleve të ndryshme siç është vërtetuar prania e shumë të argjilës së çimentos në vlerë prej 70 milion tonë të këtij lloji të argjilës.

Një komunë me një zhvillim solid ekonomik, në veçanti në fushën e prodhimit/industrisë, si me ndërmarrje private ashtu edhe shoqërore. Ekonomia e Hanit të Elezit është e bazuar kryesisht në 3 kompanitë/ndërmarrjet: 1. Kompania Sharr Holding për prodhimin e çimentos, 2. Kompania private për prodhimin e stiroporti Kosovaplast, 3. Kompania private Sharr Sallonit – që ka prodhuar artikuj nga asbest çimentoja, por aktualisht ambientet e saj janë duke u përdorur si terminal doganor. Këto kompani janë shtylla kryesore e zhvillimit ekonomik të komunës dhe përfaqësojnë burimet kryesore për gjenerimin e fondeve për të kënaqur nevojat e banorëve.



SEKTORËT DHE NJËSITË

Sektori Emergjencave

Udhëheqës: Kujtim Dernjani
E-mail: Kujtim.Dernjani@rks-gov.net
Tel: 038/200/46-565

Zyra për Marrëdhënie me Publikun

Udhëheqës: Bashkim Sopa
E-mail: bashkim.sopa@rks-gov.net
Tel: 0290/385-112;

Njësia për Komunitete dhe Kthim

Udhëheqës: Isa Shkreta

E-mail: isa.shkreta@rks-gov.net

Njësia e Inspektoratit

Kordinator: Fahri Shkreta
E-mail: fari.shkreta@rks-gov.net
Tel: 038/ 200/ 46-565

Zyra për Barazi Gjimore

Udhëheqës: Ajete.berisha@rks-gov.net
Tel: 03820046562

Qendra për Punë Sociale

Udhëheqës: Amir Bushi
Tel: 038 200 46 566

INDEKSI I KOMUNËS

Shërbimi i Zjarrfikësve

Udhëheqës: Nexhmedin Fida
Tel: 0290/385-030;

Stacioni i Trenit

Lloji i shërbimit: Është stacion i udhëtarëve të transportit hekurudhor që lidh vijat kryesore me Prishtinën dhe Shkupin në anën tjetër.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

Drejtor: Dr.Besim Luri
Tel: 0290/385-109

Buxheti

Buxheti vjetor

Të hyrat vetanake

Buxheti i realizuar 2014	1,832,039.00	350,000.00
Buxheti aktual 2015	2,151,844.00	256,258.00
Buxheti i Projektuar 2016	2,019,989.00	259,678.00
Buxheti i Projektuar 2017	2,044,746.00	263,808.00
Buxheti i Parashikuar 2018	2,115,611.00	300,000.00

Struktura organizative

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

Kryetari i Komunës

Kontakti: 0290/385-100

Nënkryetari

45551

DREJTORITË KOMUNALE

1. Drejtoria e Administratës
2. Drejtoria e Buxhetit dhe Financave
3. Drejtoria e Urbanizmit dhe Kadastrit
4. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit
Tel: 038/ 200/ 46-552

Shërbimi i Kuvendit
Tel: 46563

Anëtarët e Kuvendit: 15 anëtarë

5. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
6. Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit
7. Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë
8. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik

Punësimi

Sipas sondazhit në terren dhe të dhënave nga ndërmarrjet në Hanin e Elezit, përqindja e papunësisë është 67%. Ka një numër të vogël të të punësuarve në sektorin jo formal ekonomik. Megjithatë, nuk ka të dhëna të sakta pasi që të punësuarit në bizneset jo formale nuk janë të regjistruar

Prona Komunale

Numri i pronave komunale në qendër të qytetit është relativisht i vogël. Këto prona zakonisht gjenden në të dy anët e rrugës në qytetin e Hanit të Elezit, aty ku janë ndërtuar ndërtesat e vjetra të banimit kolektiv. Sipërfaqja e përgjithshme e pronës komunale të Hani Elezit është 3.50.00Ha.



Shënime me rëndësi



Arsim

Në komunën e Hanit të Elezit funksionon arsimi parashkollor, fillor dhe i mesëm i cili mbahet në 3 shkolla fillore dhe 1 të mesme. Arsimi parashkollor për nxënës prej 3- 6 vjeç mbahet në 6 klasë

ndërsa nuk ka asnjë çerdhe të fëmijëve. Numri i nxënësve është si vijon: 1,707 nxënës janë të shkollës fillore, në parashkollor janë 119 nxënës, si dhe 368 nxënës janë në shkollim të mesëm.

Kulturë

Hani i Elezit ka një shtëpi të kulturës, katër xhami të vjetra, mbetje të kishave, monumente epigrafike dhe një obelisk. Inventari i monumenteve kulturore të Kosovës (1999) nuk përfshin monumentet e mbrojtura me ligj nga komuna e Hanit të Elezit. Ngjarje të rëndësishme: Java Kulturore " Hani i Elezit"

Transporti

Në Han të Elezit ekzistojnë dy linja të rëndësishme. E para dhe më me rëndësi për Kosovën dhe sidomos për Hanin e Elezit është rruga magjistrale Prishtinë-Shkup. Linja tjetër është hekurudha Fushë Kosovë-Shkup. Këto dy rrugë kanë një rëndësi të madhe dhe e bëjnë Hanin e Elezit një vend kyç që lidh Kosovën dhe Maqedoninë. Rruga që lidh Hanin e Elezit dhe Gllaboçicën (Gorancë-Gllaboçic ende e paasfaltuar) është gjithashtu me rëndësi të madhe, dhe pasi që ajo lidh dy vendkalimet kryesore kufitare midis Kosovës dhe Maqedonisë, është vlerësuar si një rrugë shumë e rëndësishme për lidhjen rajonale.



Sporti dhe Rinia

Sporti në komunën e Hani Elezit karakterizohet me Klubin e Mundjes "Shari" nga Hani i Elezit e cila në vitet e fundit ka arritur rezultate kulminante si në gara vendore por edhe në gara ndërkombëtare.

...



Shëndetësia

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare e Hanit të Elezit aktualisht menaxhohet nga 32 të punësuar. Qendra ka dhjetë dhoma në të cilën ka një reception/njësi për menaxhim, dy ordinanca (njëra përdoret vetëm për dokumente), një dentist, një njësi të kujdesit emergjent e cila punon nga ora 16:00 - 08:00 të mëngjesit, një dhomë për infuzion me gjashtë krevate, një njësi për vaksinim, një njësi për kujdesin e lëndimeve dhe një kuzhinë të vogël për stafin. E vetmja ambulancë në dispozicion (Gorancë) është duke punuar pesë ditë në javë. Në kuadër të QKMF-së është njësia e laboratorit si dhe RTG-diagnostika

...

Turizmi

Pikat referuese për vizitë turistike: Kompleksi i Varrezave të Dëshmorëve në Pustenik.



Komuna e Graçanicës





Komuna e Graçanicës



Graçanicë


<http://kk.rks-gov.net/gracanice/Home.aspx>


038/776-562


<https://www.facebook.com/opstinagracanica>;
[Twitter: https://twitter.com/opgracanica](https://twitter.com/opgracanica),

Misioni: Komuna e Graçanicës është e pasur me thesarin antik të shekullit të mesëm dhe bukuritë natyrore – një rrethim modern me ekonomi dhe infrastrukturë të zhvilluar, ku të gjithë banorët gëzojnë të drejta dhe liri të barabarta



Informata të përgjithshme

Dita e komunës

21 Shator

Popullsia

10,675

Shqiptarë	2,474
Serb	7,209
Turq	15
RAE	852
Boshnjak	15
Të tjerë	110

Grupmoshat

GM: 0-18 (19)	3,526
GM: 20-65	6,156

Sipërfaqja

131 km²

Vendbanime	17
Zona Urbane	1

Përshkrimi i komunës

Komuna e Graçanicës është themeluar në bazë të Ligjit për kufijtë administrativë të komunave të datës 20 shkurt 2008, pas mbajtjes së zgjedhjeve të para lokale më 15 nëntor 2009. Zyrtarisht Komuna e Graçanicës themelohet më 29 dhjetor 2009 kur është mbajtur mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës së Graçanicës. Komuna e Graçanicës shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, është krijuar në llogari të territorit të komunës së Prishtinës dhe të Lipjanit. Kufizohet në jug me komunën e Lipjanit, kurse në perëndim me Komunën e Fushë Kosovës. Në zgjedhjet lokale të 15 nëntorit të vitit 2009 në komunën e Graçanicës fitoi partia SLS, kurse nga zgjedhjet e më vonshme të vitit 2013 kjo komunë udhëhiqet nga partia "Lista Sërpska".

Profil



Graçanica është komunë e re në Kosovë, 8km në juglindje nga Prishtina, në pjesën lindore të luginës së Kosovës, ku butësisht ngrihen shpatet e malit Veletin dhe ato më të pjerrëta të malit Strazhevc, nga lumi Graçanka dhe në perëndim deri te lumi Graçanka. Ajo ndodhet në lartësinë mbidetare rreth 570m dhe është pjesë e një pellgu tektonik Veletin. Në afërsi të fshatit gjendet liqeni artificial Badovc. Graçanica është e njohur me një nga manastiret më të bukura mesjetare, manastiri i Graçanicës. Manastiri i Graçanicës është një nga monumentet më të bukura të kulturës mesjetare nga shekulli XIV.

Planet dhe Strategjitë Komunale

1. Plan i komunal i punës për KKS;B;
2. Plan i zhvillimor komunal;
3. Plan i rregullues urbanistik;
4. Plan i përmbrojtjen e mjedisit;
5. Vlerësimi strategjik i ndikimit të mjedisit;
6. Programi rezidencial trevjeçar.



Degët kryesore të ekonomisë lokale

Komuna e Graçanicës shtrihet në Zonën Ekonomike Qendër "zona e kaltër", është zonë për zhvillim ekonomik. Prishtina, si kryeqytet dhe qendër administrativë, kulturore dhe ekonomike e Kosovës, gjendet në këtë zonë. Afërsia me Prishtinën, magjistralla dhe hekurudha, autostrada Mërdar-Vërmicë dhe afërsia me Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, paraqesin përparësi të mëdha për zhvillim ekonomik dhe begati të komunës. Të gjitha këto përparësi janë të integruara në "Trekëndëshin e zhvillimit ekonomik të Kosovës". Sipërfaqe të mëdha të tokës cilësore bujqësore gjithashtu paraqesin një potencial për zhvillim të bujqësisë. Sipas të dhënave nga zyrtarët komunalë "Numri i objekteve biznesore është në zhvillim e sipër dhe punohet në zhvillimin e zonës së biznesit: Zhvillimi i zonave të biznesit dhe zvogëlimi i papunësisë"



Prona Komunale

Komuna e Graçanicës është e pasur me resurse natyrore. Më e rëndësishmja është toka bujqësore e klasës I dhe II që mbulon rreth 100km² apo 70% të territorit të komunës. Rrjedhat ujore dhe të lumenjve janë gjithashtu burime të rëndësishme. Në territorin e komunës rrjedhin 4 lumenj: Graçanka, Sitnica, Prishtevka dhe Janjevka, si dhe 2 përroska: Straznica dhe përroska e Zhegovës. Uji nga liqeni artificial shfrytëzohet për ujitjen e 2,260 ha tokë agrare në zonën e Graçanicës, Çagllavicës dhe Lapllasellës. Liqeni ka kapacitet prej 26 miliona metra kub ujë, është rreth 4km i gjatë dhe 500m i gjerë dhe pos asaj është i begatshëm me disa lloje të peshkut siç janë: krap, mustak, merluc, etj. Komuna e Graçanicës është e pasur me minerale siç janë plumbi dhe zinku.

INDEKSI I KOMUNËS

Shërbimi i Zjarrfikësve

Udhëheqës: Stacioni i zjarrfikësve L. Selo
Tel: 0049/785-112

Kompania Rajonale e Mbeturinave

"Pastrimi" Prishtina

Ndihma e Shpejtë

Tel: 038/81943
049/719-192

KEK - Shërbimi ndaj konsumatorëve

Tel: 038/791-000

Buxheti

Buxheti vjetor

Të hyrat vetanake

Buxheti i realizuar 2014	5,557,376.00	1,150,000.00
Buxheti aktual 2015	6,083,185.00	1,501,093.00
Buxheti i Projektuar 2016	5,976,502.00	1,200,000.00
Buxheti i Projektuar 2017	6,013,469.00	1,210,000.00
Buxheti i Parashikuar 2018	6,055,577.00	1,220,000.00

Struktura organizative

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

Kryetari i Komunës : **Nënkryetari**

DREJTORITË KOMUNALE

1. Departamenti Administrativ
2. Departamenti për Financa dhe Zhvillim Ekonomik
3. Departamenti për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit
4. Departamenti për Shërbime Komunale dhe Urgjencë
5. Departamenti për Arsime, Kulturë, Rini dhe Sport
6. Departamenti i Inspeksionit
7. Departamenti për Shëndetësi, Sigurim Social dhe Familje.

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit

Anëtarët e Kuvendit: 19 anëtarë

Shërbimi i Kuvendit



SEKTORËT DHE NJËSITË

Zyra për Komunikim dhe Informim

Udhëheqës: Nebojša Čirković
Tel: 049/436-017
E-mail: ciradj@gmail.com

Zyra e Personelit

Udhëheqëse: Jelena Illic
Tel: 049/776-581
E-mail: jekailic@gmail.com

Spektori për Rini

Udhëheqës: Goran Spasić
Tel: 049/773-282
E-mail: spasicgoran@yahoo.com

Zyra për Çështje Gjinore

Udhëheqës: Marija Stojanović
Tel: 049/764-960
marija.stojanovic038@gmail.com

Zyra për Komunitete

Udhëheqës: Sebastijan Šerifović
Tel: 049/357-800
E-mail: sebastijan.serifovic@gmail.com

Këshilli Komunal të Sigurisë në Bashkësi (KKSBB)

Koordinator: Agron Karadolami
Tel: 049/785-120
E-mail: agron_1974@hotmail.com

Shënime me rëndësi

Arsim

Në komunën e Graçanicës funksionojnë 4 shkolla parashkollore dhe çerdhe për fëmijë, 9 shkolla fillore dhe 8 shkolla të mesme të ulëta. Në këtë komunë vetëm 2% nuk kanë arsimim formal, 13% kanë përfunduar arsimin fillor, 74% kanë

përfunduar arsimin e mesëm, 3% kanë përfunduar arsimin profesional, dhe 4% kanë një diplomë universitare. Femrat e moshës së rritur që banojnë në Graçanicë, kanë nivel më të ulët arsimor se sa meshkujt.



Kultura

Komuna e Graçanicës, përveç trashëgimisë së pasur fetare dhe kulturore, mjedisit të pastër dhe të shëndoshë, mund të ofrojë organizime të pasura kulturore dhe sportive. "Bashkimi i poetëve për Vidovdan" me art, letërsi, festival folklori dhe paradë të "vajzës së Kosovës" dhe "argëtimi kulturor veror" me koncerte muzikore dhe paradën "Misi i Kosovës" janë ngjarjet më të rëndësishme tradicionale. Koncertet e shumta muzikore, organizimet letrare, punëtoritë e artit dhe shumë ngjarje sportive në komunë flasin për aktivitetin dhe dëshirën e komunitetit për organizim dhe pjesëmarrje në ngjarje të komunitetit. Komuna ka një total prej 17-18 objekteve të cilat përfshijnë qendrat rinore dhe

Shtëpinë e Kulturës. Biblioteka komunale e cila gjendet në komunën e Graçanicës ka degën e saj në Graçanicë dhe në Lapje Selo. Po ashtu, në komunën e Graçanicës funksionin "Teatri Kombëtar" i Prishtinës, pastaj ekziston edhe Manastiri i Graçanicës dhe Ulpiana që është nën mbrojtjen e veçantë të monumenteve.

Punësimi

Përqindja e të papunëve është 29%, numri i atyre që janë jashtë tregut të punës është (22%) të cilët janë të papunë, ata që nuk kërkojnë punë janë (2%), ose janë në studime; me aftësi të kufizuara; amvise ose pensionistë. Një përqindje më e ulët e femrave në Graçanicë janë deklaruar se janë të punësuar 32%, në krahasim me meshkujt 55.



Shëndetësia

Komuna e Graçanicës ka 2 spitale, 4 shtëpi të shëndetit, 19 klinika, 7 spitale private, 9 barnatore dhe 1 një fabrikë për përpunimin e gazit mjekësor

...

Sporti dhe Rinia

Komuna ka rindërtuar terrenet sportive ekzistuese dhe ka ndërtuar komplekset e reja sportive për shumë qëllime dhe sallën e tenisit në Llapnasell. Zbatimi aktual i projektit për objektin sportiv shumë qëllimesh afër rrugës Llapnasell-Livadje përfshinë një sall të madhe, terrene të hapura sportive, objekte dytësore dhe furnizimin e tyre të plotë. Përveç terreneve sportive për shumë qëllime është e nevojshëm të ndërtohen objekte më të vogla sportive apo fusha të lojërave për aktivitetet e përditshme dhe për rekreacion në të gjitha fshatrat, si dhe të rindërtohen fushë-lojërat e shkollave dhe sallat për aktivitetet sportive".



Turizmi

Një nga potencialet më të rëndësishme për zhvillimin e komunës së Graçanicës është turizmi. Trashëgimia e pasur fetare dhe kulturore dhe manastiri i Graçanicës, i cili gjendet në listën botërore të trashëgimisë së UNESCO-së, paraqesin lokacione të rëndësishme për turizëm. Ulpiana është lokacion arkeologjik i cili gjithashtu mund të jetë destinacion turizmi. Mjedis i pastër dhe i shëndoshë siguron mundësi për turizëm rural, rekreacional, sportiv dhe për gjueti. Me qëllim të zhvillimit dhe promovimit të turizmit, komuna e Graçanicës ka krijuar "Organizatën turistike të Graçanicës", e cila udhëheq zhvillimin ekonomik dhe të turizmit në komunë.



Transporti

Nëpër territorin e komunës së Graçanicës kalojnë tri magjistrale: Rruga ndërkombëtare Prishtinë-Shkup (12.3km gjatësi brenda komunës); Magjistralla Prishtinë-Gjilan (5.5km gjatësi brenda komunës); Magjistralla Prishtinë-Prizren (3.45km gjatësi brenda komunës).

Rrjeti i rrugëve lokale që lidhin vendbanimet brenda komunës është i gjatë 120km. Të

gjitha rrugët lokale janë të shtruara dhe të rindërtuara që nga themelimi i komunës së Graçanicës, që do të thotë se infrastruktura rrugore është e mirë. Në territorin e komunës së Graçanicës kalojnë dy drejtime të hekurudhës: Hekurudha ndërkombëtare Prishtinë-Shkup-Athinë dhe Hekurudha lokale Fushë Kosovë-Kishnicë.

Në të gjitha vendbanimet e Komunës së Graçanicës ekziston rrjeti elektrik, mirëmbajtja, furnizimi i tensionit të lartë që bëhet nga ana e KEK-ut. Në komunë



ekzistojnë edhe dy rrjete të telefonisë, ka qasje në internet dhe shërbime tjera.



Komuna e Ranillugut





Komuna e Ranillugut



<http://kk.rks-gov.net/ranillug/>



Misioni i Komunës së Ranillugut është sigurimi i shërbimeve efikase dhe efektive për funksionim sa më të mirë të Komunës dhe administratës komunale, përmes analizës dhe pasqyrës së punës së organeve komunale, përdorimi dhe motivimi i organizimit të punës me qëllim të rritjes së produktivitetit të punës dhe kualitetit të administratës komunale që ajo të jetë më transparente dhe efikase.



Informata të përgjithshme

Dita e komunës

28 Qershori

Popullsia

3,866

Serb	3,692
Shqiptarë	164
Rom	1
Të tjerë	9

Grupmoshat

GM: 0-18 (19)	963
GM: 20-65	2,231

Sipërfaqja

77.62 km²

Vendbanime	13
Zona Urbane	1

Komuna e re e Ranillugut është themeluar me 05.01.2010 me Planin e Ahtisarit për decentralizim te Kosovës. Komuna e Ranillugut gjendet në pjesën kodrinore –malore ku rrjedh lumi Morava e Binçës. Përfshinë 13 zona kadastrale Ranillug, Bozhevc, Ropotovë e Madhe, Glllogovc, Kormjan i Epërm, Domorodc, Kormjan i Poshtëm, Drenovc, Ropotovë e Vogël, Hodovc, Pançelë, Rajanovc dhe Tomancë . Është krijuar nga 15% i territorit të komunës së Kamenicës”. Aktualisht në këtë komunë udhëheq partia Lista Sërpska.



Profili

Territori i Komunës së Ranillugut gjendet në pjesën lindore të Kosovës. Gjendet në koordinatat 42.29° të gjerësisë veriore gjeografike dhe 21.35° të gjerësisë lindore gjeografike, me një lartësi mbidetare prej 428m deri në 880m (lartësia mesatare mbidetare prej 603m). Kufizohet me

Komunat (Kamenicë, Novobërdës, Gjilanit dhe Bujanocit). Ranillugu është Komunë e cila gjendet në lartësi mbidetare 603 m në kontakt me rrafshinën e Moravës dhe rrënjëz malit të zi të Preshevës, maja më e lartë e malit Ostrovica 1166 l. m.d., në meritorin e Komunës Ranillug kalon lumi Morava e Binaçës.



Planet dhe Strategjitë Komunale:

- Plani lokal për rininë 2014 -2015;
- Plani ekologjik lokal të veprimit për mbrojtjen e mjedisit në komunën e Ranillugut
- Plani urbanistik zhvillimor i Ranillugut dhe plani komunal zhvillimor
- Plani i veprimit për përmirësimin e shërbimeve të ndriçimit publikë në Komunën e Ranillugut

Zhvillimi Ekonomik dhe degët kryesore të ekonomisë lokale

Bujqësia është njëra ndër degët kryesore të zhvillimit ekonomik në Planin zhvillimor komunal, që është në fazën përfundimtare të hartimit.



Prona Komunale

Numri i parcelave komunale është 105, gjithsej (77617) m²



Punësimi

Përqindja e të rriturve të punësuar (të moshës 18 vjeç ose më të vjetër) në Ranillug 28%, përqindja e të papunëve është 34%, kurse 38% janë jashtë tregut të punës si të papunë që nuk kërkojnë punë (12%), ose janë studentë, me aftësi të kufizuara, amvisë ose të pensionuar Përqindja e femrave që janë jashtë tregut të punës (56%) është më e lartë se ajo e meshkujve (34%), kurse përqindja e femrave të punësuar (15%) është më pak se gjysma e përqindjes së meshkujve të punësuar (35%)



Buxheti

Buxheti vjetor

Të hyrat vetanake

Buxheti i realizuar 2014	1,142,061.00	84,000.00
Buxheti aktual 2015	1,268,203.00	92,768.00
Buxheti i Projektuar 2016	1,425,026.00	120,000.00
Buxheti i Projektuar 2017	1,444,329.00	130,000.00
Buxheti i Parashikuar 2018	1,465,400.00	140,000.00

Struktura organizative

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

Kryetari i Komunës

Nënkryetari

Kontakti: Tel: 0390/330-183

DREJTORITË KOMUNALE

1. Drejtoria e Administratës dhe Personelit
2. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies
3. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Inspeksionit
4. Drejtoria e Shërbimeve Publike
5. Drejtoria e Urbanizmit
6. Drejtoria e Kadastrit dhe Gjeodezisë
7. Drejtoria për Buxhet dhe Financa
8. Drejtoria për Arsimit

Zyra për Komunikim dhe Informim

Udhëheqës: Aleksandar Nedeljković

E-mail: nedeljkovic 83@yahoo.com

Sektori për Rini

Udhëheqës: Igor Naskovic

Tel: 0280/375

E-mail: igor.naskovic@hotmail.com

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit

Anëtarët e Kuvendit:

15 anëtarë

Shërbimi i Zjarrfikësve

Lloji i shërbimit: Është njësi e zjarrfikësve dhe ndërhyrjes emergjente në komunë.

Tel: 029 622 093

Kompania Rajonale e Ujësjetillësit -

Hidromorava Lloji i shërbimit:

Furnizimi me ujë

Drejtori: Muhamed Suliqi

Muhamed-siliqi@hotmail.com

www.hidromorava.com

Stacioni Policor

Tel: 049/787-700

Kompania Rajonale e Mbeturinave -

Lloji i shërbimit: Mbledhje e mbeturinave në amvisërit

Udhëheqës: Ivan Janicijevic

Tel: 0280/375-432

Shënime me rëndësi

Arsim

Në komunën e Ranillugu 4% e banoreve nuk kanë arsim formal, 23% kanë përfunduar arsimin fillor, 56% kanë përfunduar arsimin e mesëm, 11% kanë përfunduar arsimin profesional, dhe 3% kanë diplomë universitare. Femrat që banojnë në Ranillug kanë nivel më të ulët arsimor se sa meshkujt. 6% e tyre në krahasim me 1% të meshkujve nuk kanë arsim formal. Po ashtu, kjo komunë ka 2 shkolla fillore, 2 shkolla të mesme dhe 1 kopsht për fëmijë.



Kultura

Komuna e Ranillugut përmban karakteristikat e përbashkëta të Anamoravës së Kosovës, por është unike sa u përket vlerave të saj kulturore, historike dhe fetare, gjë që pasqyron jetën e banorëve të saj. Në territorin e komunës gjendet një numër i madh i kishave ortodokse serbe. Komuna i kushton kujdes të madh trashëgimisë kulturore dhe fetare.

Sporti dhe Rinia

Në Ranillug ka shumë mundësi për organizimin e ngjarjeve të ndryshme kulturore dhe sportive, ku sidomos marrin pjesë të rinjtë. Midis tyre janë dy më të rëndësishme, që kanë për synim mbledhjen e rinisë, miqësimin, sportin dhe artin konkurrues. Fshati Ranillug ndërmjet 1-3 maj të çdo viti tradicionalisht organizohet manifestimi kulturor dhe sportiv "Morava rrjedh në këngë", derisa në fshatin Ropotovë e madhe nga 18 deri 28 qershor, tradicionalisht organizohet manifestimi kulturor dhe sportiv "lojërat e Vidovdanit".

...



Shëndetësia

Sistemi i kujdesit shëndetësor parësor aktualisht përfshin një Qendër komunale shëndetësore familjare dhe pesë (5) shtëpi të shëndetit, ku punojnë 33 të punësuar: 21 femra dhe 12 meshkuj".

...

Transporti

Statusi i përgjithshëm i infrastrukturës në komunën e Ranillugut është vlerësuar si i mirë. Shumica e kryesore rrugëve që lidhin fshatrat me qendrën urbane janë asfaltuar. Po ashtu, në kuadër të Komunës së Ranillugut, prezent është vetëm një lloj i transportit dhe atë transporti rrugor.



Komuna e Parteshit





Komuna e Parteshit



<http://kk.rks-gov.net/Partesh/>



Informata të përgjithshme

Popullsia 1,787

Serbë
Të tjerë

1,785
2

Note: Sipas zyrës komunale për komunitete dhe kthim, janë rreth 5,300 serb që banojnë në këtë komunë.

Komuna Partesh shtrihet në pjesën lindore të Kosovës. Kjo Komunë zë një sipërfaqe prej rreth 18.3 km², ku përfshin qytetin e Partesh dhe dy fshatra. Numri total i popullsisë është rreth 1,800.



Komuna Partesh është themeluar më 19 gusht 2010, kur është mbajtur edhe mbledhja e parë themeluese. Më parë ishte pjesë e territorit të Komunës së Gjilanit.

ARSIMI

Janë dy (2) shkolla fillore me 411 nxënës dhe 62 mësimdhënës dhe pesë (5) shkolla të mesme me 330 nxënës dhe 56 mësimdhënës. Ndërtimi i çerdhës në qytetin e Partashit është përfunduar, por ndërtesa ende nuk është në përdorim (marrë nga: Drejtoria e arsimit, shëndetësisë, mirëqenies sociale, kulturës, rinisë dhe sportit).

OBJEKTET FETARE DHE KULTURORE

Komuna Partesh ka 4 kisha ortodokse serbe ku të gjitha janë në përdorim. Kisha në Budrigë e Poshtme/Donja Budriga është hequr në vitin 2009, ndërsa kisha në Parteš/Partesh është nën renovim. Ekzistojnë edhe rrënojat fetare që datojnë qysh nga periudha e mesjetës që vizitohen nga serbët ortodoks. Kishat Ortodokse Serbe nuk kanë qenë të dëmtuara gjatë ose pas konfliktit të vitit 1999.





Struktura organizative

DREJTORITË

Janë 6 drejtori: administratë dhe personel (GIS); buxhet dhe financa (GIS); plani urbanistik, kadastër dhe gjeodezi (GIS); arsimim, shëndetsi, shërbime sociale, rini, kulturë dhe sport (GIS); shërbime publike, siguri dhe emergjenca (GIS); dhe bujqësi, pylltari dhe zhvillimi rural (GIS). Një drejtoreshë është femër.

EKZEKUTIVI

**Kryetari i
Komunës**

Nënkryetari

KUVENDI I KOMUNËS

Kuvendi komunal ka 15 vende të shpërndara në mesin e 6 subjekteve politike; Të gjithë anëtarë janë serb të Kosovës, 5 janë femra.



STRUKTURAT QEVERISËSE DHE PIKËPAMJET POLITIKE

Numri total i votuesve në Partesh të regjistruar në zgjedhjet e fundit komunale të mbajtura në nëntor të vitit 2013 ka

qenë 4,342, duke përfshirë edhe votues jashtë vendit. Pjesëmarrja në votime ishte 63.8 %/ 2,770 votues.

INFRASTRUKTURA

Statusi i përgjithshëm i infrastrukturës në komunën e Parteshit vlerësohet si i mirë. Shumica e rrugëve që lidhin fshatrat me qendrat urbane janë të asfaltuara por nuk janë të mirëmbajtura. Partesh/Parteš, Pasjan/Pasjane dhe Budrigë e Poshtme/Donja Budriga të gjitha këto fshatra janë të lidhura në sistemin e kanalizimit. Ndërsa, punimet në sistemin e ujësjellësit në këto fshatra janë duke u përfunduar.

...

SHËNDETËSIA

Kujdesi shëndetësor primar përfshin 1 qendër të mjekësisë familjare në fshatin Pasjan/Pasjane dhe 3 shtëpi shëndeti. Sektori i shëndetësisë ka gjithsej 8; 4 femra dhe 4 meshkuj, duke përfshirë infermiere dhe anëtarë të personelit mbështetës.



Ekonomia

Ekonomia e komunës së Parteshit kryesisht mbështetet nga produktet e qumështit (qumësht dhe djathë) dhe biznese të vogla tregtare. Janë rreth 40 biznese të regjistruara private që veprojnë në këtë komunë.



Komuna e Kllokotit





Komuna e Klokotit



Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.



<http://kk.rks-gov.net/klokoti/home.aspx>



0280/385-635



kojicdragisa@yahoo.com



Komuna e Klokotit për mision të saj ka zhvillimin e turizmit dhe sektorit të bujqësisë dhe investimi në infrastrukturë, me të cilin do të tregojë fytyrën reale të një vendi turistik, me të cilën tenton të ngritë standardin jetësor në të gjitha sferat e jetës.



Informata të përgjithshme

Dita e komunës

8 Janari

Popullsia

2,556

Serb	1,177
Shqiptarë	1,362
Rom	9
Të tjerë	6

Grupmoshat

GM: 0-18 (19)	980
GM: 20-65	1,172

Sipërfaqja

23 km²

Vendbanime	4
Zona Urbane	1

Komuna e Klllokotit hyn në mesin e komunave të themeluara sipas Planit të Ahtisarit. Kjo komunë ka filluar së funksionari nga janari 2010, pas zgjedhjeve lokale të vitit 2009. Aktualisht komuna e Klllokotit udhëhiqet nga partia Lista Serpska. Komuna Klllokot-Vrbovac është e njoftuar me basenin natyral të ujit mineral dhe ujit të shërueshëm, me fontanën termale dhe me fabrikë e cila prodhon ujin mineral "UJI I KLLOKOTIT". Pos asaj edhe bukuritë tjera natyrore të cilët janë: Mali i Sharrit dhe Lumi Morava që kalon nëpër Klllokot e cila është e pasur me ujë, e testuar dhe e cilësuar si ujë me karakteristikat shëruese. Banorët e kësaj Komune të vogël dhe rurale në përgjithësi merren me bujqësi (peme dhe perime).



Zhvillimi Ekonomik dhe degët kryesore të ekonomisë lokale

Komuna e Klllokotit gjendet në një rajon kryesisht kodrinor dhe bujqësor, me popullsi me shumicë serbe. Sa i përket zhvillimit ekonomik, kjo komunë kryesisht është e bazuar në burime natyrore (ujit mineral), pastaj turizmit, bujqësisë dhe bizneseve të vogla. Në këtë komunë janë të regjistruar 29 biznese private të cilat operojnë".

Profil

Komuna e Klllokotit në gjirin e saj ka Banjën e Klllokotit e cila është e lidhur me qendrat tjera siç janë: Ferizaj dhe Gjilani. Ekzistojnë disa ndërtesa kolektive të banimit për nevojat e punëtorëve të qendrës shëndetësore, ndërtesat me hotele dhe dispanzere, pishina e hapur, dhoma e gazit, restoranti dhe dy dispanzerë të rinj. Klllokoti gjithashtu ka një klimë kontinentale, e cila rezulton në një dimër relativisht të shkurtër dhe verëra të gjatë.

Planet dhe Strategjitë Komunale:

- Plani i veprimit për përmirësimin dhe avancimin e ndriçimit rrugor;
- Strategjia integruese për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik;
- Strategjia për zhvillimin e NVM-ve;
- Plani i veprimit për përmirësimin e shërbimeve të mbledhjes dhe deponimit të mbeturinave;
- Plani i veprimit për transparencë dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e buxhet bërjes së komunës;
- Planet dhe Strategjitë Komunale:
- Plani i veprimit për përmirësimin dhe avancimin e ndriçimit rrugor;
- Strategjia integruese për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik;
- Strategjia për zhvillimin e NVM-ve;
- Plani i veprimit për përmirësimin e shërbimeve të mbledhjes dhe deponimit të mbeturinave;
- Plani i veprimit për transparencë dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e buxhet bërjes së komunës;
- Plani i punës komunal për KKS-b-të;
- Plani urbanistik zhvillimor për zonën kadastrale Klllokot;
- Plani i ndërtimit të kapaciteteve në Komunë;
- Plani i veprimit për ngritjen e shërbimeve komunale në shëndetin primar.
- Plani i punës komunal për KKS-b-të;
- Plani urbanistik zhvillimor për zonën kadastrale Klllokot;
- Plani i ndërtimit të kapaciteteve në Komunë;
- Plani i veprimit për ngritjen e shërbimeve komunale në shëndetin primar.



Prona Komunale

Komuna e Klllokotit ka në pronësi të saj komunale 13.65.23 Ha tokë, të ndarë në 42 parcela të ndryshme nëpër vendbanime dhe zona të veçanta.



Punësimi

Përqindja e të punësuarve (të moshës 18-64) në Klllokot është 19%, përqindja e të papunëve është 57%, kurse rreth 24% janë jashtë tregut të punës si të papunë të cilët nuk kërkojnë punë, ose janë në studime, me aftësi të kufizuara, amvise ose janë pensionuar. Përqindja e atyre që janë jashtë tregut të punës është më e lartë tek femrat (42%) në krahasim me meshkujt (20%). Duhet theksuar gjithashtu se përqindja e femrave të punësuar në Klllokot (9%) është dukshëm më e ulët se përqindja e meshkujve të punësuar (27%) dhe nën mesataren e Kosovës (12%).

Nga gjithsejtë stafi politik dhe civil që e përbejnë një numër prej 55 të punësuarve sipas buxhetit Komunal, përkatësisht me organogramin e Administratës Komunale

Buxheti

Buxheti i realizuar 2014
Buxheti aktual 2015
Buxheti i Projektuar 2016
Buxheti i Projektuar 2017
Buxheti i Parashikuar 2018

Buxheti vjetor

872,195.00
854,979.00
850,699.00
865,177.00
880,508.00

Të hyrat vetanake

80,000.00
86,849.00
120,000.00
130,000.00
140,000.00

Struktura organizative

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

Kryetari i Komunës

Nënkryetari

Nënkryetari për komunitete

DREJTORITË KOMUNALE

1. Drejtoria e Administratës
2. Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik
3. Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit
4. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
5. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
6. Departamenti për bujqësi, pylltari dhe administrim të ujerave

Zyra për Komunikim dhe Informim

Udhëheqëse: Dragisa Kojic

Tel: 049/920-482

E-mail: kojicdragisa@yahoo.com

Zyra e Personelit

Udhëheqës: Skender Hoda

Tel: 044/393717

E-mail: skenderhoda@hormail.com

Zyra Ligjore

Udhëheqëse: Lirije Zeqiri Halabaku

Tel: 049/920-464

E-mail: leta-84-1 @hormail.com

Zyra e Avokaturës Publike

Spektori për Kulturë, Rini dhe Sport

Udhëheqëse: Strahinja Spasic

Zyra për Çështje Gjinore

Koordinatorë: Dejana Stojanovic

Tel: 049/920-840

E-mail: stojanovic-dejana@yahoo.com

Zyra për Komunitete

Udhëheqës: Zëvendës Kryetari i Komunës, Hasan Rashiti

Tel: 049/920-845

E-mail: rashithasan@gmail.com

Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi (KKSB)

Koordinator: Nebojsa Vesic

Tel: 049/723-380

E-mail: nesakolokot@yahoo.com

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit

Anëtarët e Kuvendit:

15 anëtarë



INDEKSI I KOMUNËS

N.P.L Stacioni Autobusëve

Lloji i shërbimit: Transporti privat dhe transporti me taxi.

Kompania Rajonale për menaxhimin e mbeturinave

Lloji i shërbimit: Bëhet deponimi i mbeturinave në deponi dhe hartimi i listës për pagesat mujore

Udhëheqës: Hidajet Ahmeti

Tel: 044/679-624

E-mail: hidajet.ahmeti@gmail.com

Stacioni Policor

Komanduesi i stacionit policor është Stevan Todorovic

Tel: 044/740-155

Shënime me rëndësi



Sporti dhe Rinia

Ekzistojnë klube të peregjistruar të futbollit, FK "Mineralac" dhe FK "Moravac". OJQ TOVK (organizata turistike viva Klokot) është regjistruar në territorin e Komunës dhe pranë sistemit të OJQ-ve. Në proces është ndërtimi i "Objektit Multi-funksional" ku OJQ-të dhe disa organizata do të kenë zyrat ku do të ushtrojnë aktivitetet e tyre në kuadër të Komunës.

...



Arsim

Në komunën e Kllokotit 15% e të rriturve nuk kanë arsimim formal, 24% kanë përfunduar arsimin fillor, 45% kanë përfunduar arsimin e mesëm, 11% kanë përfunduar arsimin profesional, dhe 2% kanë një diplomë universiteti. Femrat që banojnë në Kllokot kanë nivel më të ulët arsimor se sa meshkujt. Po ashtu, në komunën e Kllokotit janë 3 shkolla fillor, 1 shkollë e mesme dhe 1 institucion parashkollor"



Shëndetësia

Sipas të dhënave në komunën e Kllokotit ekziston sistemi shëndetësor, ku është 1 QMF, pastaj 1 shtëpi e shëndetit. Sektori i shëndetësisë ka 12 të punësuar (7 femra dhe 5 meshkuj) që përfshijnë mjekë, motra dhe staf mbështetës dhe një mjek i përgjithshëm . Po ashtu, sipas zyrtarëve të komunës së Kllokotit, Në komunën Kllokot-Vrbovac nuk ekziston Qendra e shëndetësisë, vetëm bëhet kontrollimi ambulator në Klokot, Vrbovcu dhe Mogil. Problem qëndron tek mjekët e rinj të cilët janë pa punë dhe nuk kanë mundësi të punësohen, prandaj migrojnë nga kjo komunë".

Kultura

Në komunën e Kllokotit ekziston shtëpia e kulturës, por edhe biblioteka e komunës e cila është jashtë funksionit. Po ashtu, kjo komunë ka themeluar shoqatën kulturore – artistike. Kjo komunë në gjirin e saj ka Manifestimet e 1 majit: "Morava zhytet në këngë" në Kllokot dhe "Lojërat e Vidovdanit".



Tansporti

Transporti është faktor përmbajtjesor për zhvillimin ekonomik, social dhe hapësinorë por edhe si pasojë e këtyre rrjedhave, luan një rol me rëndësi në relacionet hapësinore ndërmjet hapësirës dhe destinimeve të tyre. Transporti në Klokot kryesisht zhvillohet me anë të transportit rrugor. Ky aspekt i trafikut me kapacitetin e vet kryesisht përmbush kërkesat për transport, por është në një nivel të ulët të shërbimit të transportit dhe të trafikut". Rruga Klokot-Ferizaj-Gjilan është rruga kryesore, ndërsa rruga Klokot-Viti është rruga dytësore. Me anë të rrugës magjistrale Klokoti lidhet me Bujanovcin dhe me këtë rast akumulon komunikacionin e brendshëm në të gjitha destinacionet.



Turizmi

Momentalisht në Klokot, zhvillohet turizmi shëndetësor dhe ai rekreativ në kompleksin e Banjës „Nëna Naile“. Ky kompleks ofron shërbime dhe ujëra cilësore. Balta dhe parafina kanë cilësi shëruese për shumë sëmundje reumatike dhe sëmundje tjera. Banja e Klokotit është një ndër resurset kryesore për zhvillimin e turizmit, dhe ndërtimi i një SPA qendre do të





Komuna e Mitrovicës Veriore





Komuna e Mitrovicës Veriore



Komuna e Mitrovicës së veriut gjendet në veri të Kosovës, në jug të lumit Ibër. Përfshin qytetin e Mitrovicës së Veriut dhe 40 fshatra



Ekonomia e komunës së Mitrovicës veriore kryesisht mbështetet në bujqësi dhe biznese të vogla. Kompleksi i minierave të Trepçës, duke funksionuar me kapacitet të kufizuar, mbetet punëdhënsi më i madhë në këtë komunë. Janë rreth 2,631 biznese të regjistruara private që veprojnë në këtë komunë.



INFRASTRUCTURE

Statusi i përgjithshëm i infrastrukturës vlerësohet si i mirë. Të gjitha rrugët kryesore që lidhin fshatrat e mëdha me qendrat urbane janë të asfaltuara. Qyteti dhe 26 fshatrat e Mitrovicës së Jugut/Južna Mitrovica janë të kyçura në sistemet e ujësjellësit dhe kanalizimit.



**Shënim:**

212 policë

SHËNDETËSIA

Kujdesi shëndetësor përfshin: 1 spital rajonal; 1 qendër të mjekësisë familjare dhe 22 shtëpi shëndeti.

Sektori shëndetësor ka gjithsej 603 punonjës, 380 janë femra dhe 223 janë meshkuj, duke përfshirë mjekët, infermieret dhe anëtarë të personelit. Të gjitha komunitetet kanë qasje në kujdesin shëndetësor.

Ekziston një shtëpi shëndeti në lagjen Roma Mahalla e banuara kryesisht me romë, ashkali dhe egjiptian. Banorët e kësaj lagje po ashtu kanë qasje në shërbimet e kujdesit shëndetësor të Mitrovicës së Veriut/Severna Kosovska Mitrovica.

Struktura organizative**EKZEKUTIVI I KOMUNËS****Kryetari i Komunës****Kontakti:** Tel: 0390/330-183**Nënkryetari****KUVENDI I KOMUNËS****Kryesuesi i Kuvendit****Anëtarët e Kuvendit:**

19 anëtarë

ARSIMI

Në Komunën e Mitrovicës Veriore ka 11 shkolla fillore me 2,754 nxënës dhe katër (4) shkolla të mesme me 1,740 nxënës dhe 587 të punësuar, duke përfshirë mësuesit, personelit ndihmës dhe administratën e shkollës, një (1) kopësht me 600 fëmijë dhe 58 të punësuarit, dhe shkolla të tjera të veçanta.

Shumica e studentëve janë serbë të Kosovës, me një numër të vogël të boshnjakëve të Kosovës.

Studentët shqiptarë shkojnë në shkolla të



vendosura në pjesën jugore të Mitrovicës. Ka vetëm dy klasa me 23 nxënës, klasat 1-9, të cilët janë në fshatin Mikronaselje,

**OBJEKTET FETARE DHE KULTURORE**

Mitrovica e Jugut/Juzna Mitrovica ka gjithsej 15 xhamia; 4 kanë qenë të djegur gjatë konfliktit të vitit 1999, ndërsa 2 janë rinovuar. Ekziston 1 Kishë

Ortodokse Serbe e cila ishte dëmtuar në trazirat e Marsit 2004 dhe ka qenë pjesërisht e rinovuar më vonë por nuk është në përdorim aktiv. Megjithatë, ekziston 1 kishë Katolike në Mitrovicën e jugut/Juzna Mitrovica e cila është në përdorim.